

ETIKA

A nuk ka ardhur Koha

**që zemrat të zbuten
me përmendjen e Allahut
dhe me të Vërtetën?!"**


(Hadid, 16)



SIGURIA DHE QETËSIA
OSMAN NURI TOPBASH



EDUKATA PARA MËSIMIT
NUREDIN NAZARKO



**MUHAMED EL-GAZALI
RRETH PROFETIT (A.S.)**



**AISHE TUBA BAKILER
E DASHUR SI NËNA!**




**ENKLID PELARI
KJO BOTË ËSHTË E JONA**



**M.SC. ARTAN M. MEHMETI
KURANI DHE SHKENCA**

Arsyeja dhe Filozofia

IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË
RËNË



Maj 2015

VITI: IX

NUMRI: 86

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Artur Tagani

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 607 8484

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.revistaetika.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Maqedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përktimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrove të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Nuk e di se sa e ndjeni faktin se secili prej ajeteve të Kuranit është fjala e Zotit që ju drejtohet personalisht drejtpërdrejt juve.

Nuk e di se sa i kuptoni faktet se Allahu është Zoti juaj, se çfarë është Ai në vetvete, se cila është shprehja e madhësisë dhe lidhjes që keni ju me Të, më saktë, se sa të ndërgjegjshëm jemi se ekzistenca jonë varet nga begatia dhe vullneti Hyjnor.

Nuk e di se sa i kuptoni këto të vërteta, sa i mbani parasysht ato dhe në cilën masë e formësoni botën tuaj në varësi të tyre.

Unë them me bindje se sa më shumë që t'i njohim ato të vërteta, aq më shumë e ndryshojmë vetveten.

Unë them me bindje se sa më shumë që t'i njohim ato të vërteta, do ta lexonim Kuranin më ndryshe dhe do ta pajisnim jetën tonë me të edhe më ndryshe.

Unë them me bindje se sa më shumë që t'i njohim ato të vërteta, aq më të ndryshëm do të bëheshim.

Si mundet njeriu ta përjashtojë veten e tij nga zona së cilës i drejtohet kumti hyjnor, teksa lexon ajetin e mëposhtëm të sures Hadid?

"A nuk ka ardhur koha që zemrat e besimtarëve të zbuten me përmendjen e Allahut dhe fjalëve të vërteta që shpallen prej Tij dhe kështu ato zemra të ringjallen nga respektimi i Zotit?.."

Myslimanët duhet të kenë kujdes që të mos bëhen si popujt e mëparshëm, të cilëve iu shpallën librat hyjnorë!

Popujt e mëparshëm nisën të mësohen me idenë e njohjes së plotë të librave hyjnorë që u ishin shpallur atyre, duke e konsideruar kohën mes shpalljes dhe momentit të tyre të jetës si një kohë tepër të gjatë dhe në fund fare zemrat e tyre u bënë të pandjeshme ndaj mësimave hyjnore.

Si rezultat i këtij fakti pjesa më e madhe e tyre dolën nga rruga e drejtë.

Pra mes tyre dhe ajeteve të Zotit u krijua një distancë. Humbi gjallëria e tyre në marrëdhëniet me ajetet. Megjithëse ajetet e Allahut, në rast se përthithen me kuptimin e tyre të vërtetë kanë një karakter "rigjallërues", ndodh që njeriu nga neglizhenca e humbet aftësinë e tij prej marrësi. Zemra shkëputet nga përmendja e Zotit. Zemra shkëputet nga ajetet. Në fund fare zemra ngurtësohet. Përmendja e Zotit është uji i jetës për zemrën. Nëse ajetet e Zotit janë harta e udhës drejt përjetësisë për njeriun, marrëdhënia e tij me këtë udhë nis të dobësohet atëherë kur ai largohet nga përmendja e Zotit dhe mes tij dhe ajeteve të Zotit krijohet një distancë deri sa ai del nga rruga e vërtetë.

Prandaj nuk duhet të krijohet ndonjë distancë mes besimtarit dhe përmendjes së Zotit, nuk duhet të përjetohet një gjendje largimi nga ajetet e Allahut, nuk duhet të shuhet gjallëria e zemrave, duhen lexuar përditë ajetet e Zotit, në mënyrë që zemrat të jenë përherë me përmendjen e Zotit...Kjo gjendje kërkon një gjallëri të vazhdueshme."

Përmbajtja



8

Pema e hurmave e Ebu Xhehlit në xhenet
Ali Riza Temel



34

Siguria dhe qetësia
Osman Nuri Topbash



11

24



Kurani dhe shkencë
M.sc. Artan S. Mehmeti

5 Pyetja...

Ahmet Tashgetiren

11 Rreth Profetit (a.s.)

Muhamed El-Gazali

12 Dhikri dhe vitaliteti me Kuranin

Prof. dr. Sadik Këllëç

17 Në kërkim të njerëzores

Ela Muça

18 Fjala e kulluar

Xhafer Durmush

22 Shpresa tek Zoti

Ilhan Armutçuoğlu

27 Rëndësia e sistemit të vakëfit

dhe inkorporimi i programeve

të vakëfit në jetën bashkëkohore

Taxhudin Hamidi

30 Mrekullitë e Kuranit



51

Një Ajet - Një Hadith 32

"Dyzet Hadithet" e Imam Neveviut, një vepër e shumëpritur
në mesin e myslimanëve shiptarë

Imam Muhamed Sytari

T'i mbështetesh Zotit dhe t'i shërbesh njerëzimit 42

Mustafa Erish

Sakrifica: Prologu i udhës drejt lumturisë 48

A. Jasin Demirxhi

Kjo botë është e jona 50

Enklid Pelari

Receta pa efekte anësore 51

Dr. Ali Akben

Mënyra e lartësimit në robërinë ndaj Allahut 52

M. Sami Ramazanoglu

Edukimi i një brezi fetar 53

Sadik Dana

Qëllimi i asketizmit 54

Prof. dr. Sulejman Derin



E dashur si nëna!

Aishe Tuba Bakiler

44

Sistemi është kaos dhe kaosi është sistem
Edison Çeraj

46



Ahmet Tashgetiren

Nuk e di se sa e ndjeni faktin se secili prej ajeteve të Kuranit është fjala e Zotit që ju drejtohet personalisht drejtpërdrejt juve.

Nuk e di se sa i kuptoni faktet se Allahu është Zoti juaj, se çfarë është Ai në vetvete, se cila është shprehja e madhësisë dhe lidhjes që keni ju me Të, më saktë, se sa të ndërgjegjshëm jemi se ekzistenca jonë varet nga begatia dhe vullneti Hyjnor.

Nuk e di se sa i kuptoni këto të vërteta, sa i mbani parasysh ato dhe në cilën masë e formësoni botën tuaj në varësi të tyre.

Unë them me bindje se sa më shumë që t'i njohim ato të vërteta, aq më shumë e ndryshojmë vetveten.

Unë them me bindje se sa më shumë që t'i njohim ato të vërteta, do ta lexonim Kuranin më ndryshe dhe do ta pajisim jetën tonë me të edhe më ndryshe.

Unë them me bindje se sa më shumë që t'i njohim ato të vërteta, aq më të ndryshëm do të bëheshim.

Si mundet njeriu ta përjashtojë veten e tij nga zona së cilës i drejtohet kumti hyjnor, teksa lexon ajetin e mëposhtëm të sures Hadid?

"A nuk ka ardhur koha që zemrat e besimtarëve të zbuten me përmendjen e Allahut dhe fjalëve të vërteta që shpallen prej Tij dhe kështu ato zemra të ringjallen nga respektimi i Zotit?.."

Myslimanët duhet të kenë kujdes që të mos bëhen si popujt e mëparshëm, të cilëve iu shpallën librat hyjnorë!

Popujt e mëparshëm nisën të mësohen me idenë e njohjes së plotë të librave hyjnorë që u ishin shpallur atyre, duke e konsideruar kohën mes shpalljes dhe momentit të tyre të jetës si një kohë tepër të gjatë dhe në fund fare zemrat e tyre u bënë të pandjeshme ndaj mësimëve hyjnorë.

Si rezultat i këtij fakti pjesa më e madhe e tyre dolën nga rruga e drejtë.

Mendoni thellë se si Allahu e ringjall tokën pasi ajo ka vdekur nga thatësia.

“Dijeni, se Allahu e ngjall tokën pas vdekjes së saj! Ne ju sqarojmë shpalljet, në mënyrë që ju të kuptoni.” (Hadid, 16, 17)

Le t'i trajtojmë këto dy ajete fjalë për fjalë...

Ajeti flet për “Besimtarët...” Elhamdulillah unë jam besimtar mysliman. Pra ky kumt i Zotit më drejtohet edhe mua...

Pastaj bëhet fjalë për zemrat....

A më punon zemra?

Po, zemra ime punon.

Pastaj përmendet dhikrullahu, pra përmendja e Zotit.

Cila është marrëdhënia jonë me dhikrullahun?

Pastaj vijnë “Të vërtetat që zbresin prej Tij”.

Kjo do të thotë se përmendja e Zotit janë të vërtetat që zbresin nga Zoti dhe zemra... Këto të dyja janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Çfarë lloj lidhjeje është kjo?

Zoti na tregon se në atë lidhje ka “qetësi shpirtërore, butësi dhe ringjallje përmes respektit”...

Pas gjithë këtyre lidhjeve vjen pyetja: “A nuk erdhi koha?”

Nuk duhet të harrojmë pyetësin, ndërkohë që shohim, lexojmë dhe dëgjojmë këtë pyetje që na bëhet.

Ajo pyetje vjen nga Krijuesi.

Ajo pyetje i vjen robit nga Krijuesi i Tij.

Në rast se ia vini veshin, keni për të dëgjuar që me dorën e parë thirrjen: “A nuk erdhi koha, robim?”

Kjo pyetje tregon se në zemrën tonë ekziston një problem. Meqë nga zemra jonë kërkohet “të zbutet, të ringjallet me anë të respektit dhe të qetësisë shpirtërore”, atëherë kjo do të thotë se “zemra jonë nuk është e butë, e mangët në respekt, e paqetë, madje deri diku e vdekur”.

Pyetja na tregon se kemi mbetur pas në konstantmin e këtyre gjendjeve të zemrës.

Pyetja na tregon se këto probleme nuk gjenden në një njeri dosido, por pikërisht tek vetë besimtarët. Tek ata persona që në parim duhet t'i kishin zgjidhur këto gjendje pasi të kishin pranuar të besonin...

Në pyetje ekziston edhe një ton hatërmbetjeje, por nuk ka qortim.

Prandaj tek pyetja ka butësi dhe dhembshuri hyjnore.

Aty ndjen tingëllimin e fjalëve: “Ti mundesh dhe duhesh ta kalosh këtë gjendje!”

Pyetja është: “A nuk ke mbetur vonë?”

Thirrja është: “Mos prit më, por shpejto ta kalosh këtë gjendje.”

Kjo pjesë e ajetit sikur tregon se njeriu nuk është i ndërgjegjshëm për zemrën e tij. Nënkuptohej që, në qoftë se ai do të kishte qenë i vetëdijshëm për zemrën e tij, nuk do ta kishte lënë atë në atë gjendje, sepse atmosfera origjinale e zemrës është prehje shpirtërore.

Edhe në ajetin e Kuranit ku Allahu na meson: **“Kini kujdes se, zemrat lumturohen vetëm duke e përmendur Allahun.”** (Rad, 28) ajeti fillon me pjesën “Ela”. Kjo është një pjesëz thirrrore në gjuhën arabe, që ka kuptimin “Kini kujdes se”. Ajo pjesëz është thirrje për vetëdije. Prandaj në të gjendet edhe një shenjë drejtuar dobësisë njerëzore.

Edhe në hadithin e të Dërguarit të Allahut, ku thuhet: **“Në trupin e njeriut gjendet një copëz e vogël mishi...”** hadithi përfundon me fjalët “Ela ve hijel-kalb” që do të përkthehej: “Kini kujdes se ajo pjesëz mishi është zemra.” (Buhari, Iman, 39) Me këtë formë të tërheqjes së vëmendjes i kërkohet njeriut të jetë i ndërgjegjshëm se zemra është qendra e personalitetit të tij.

A thua se zemra është një organ që njeriu e ka harruar se e ka dhe për t'ia kujtuar atij këtë gjë është i nevojshëm paralajmërimi hyjnore në formën: “Kini kujdes, zgjohuni, ejani në vete.”

Më pas Allahu i Lartësuar me butësinë, mëshirën

“Mos të krijohet ndonjë distancë mes jush dhe përmendjes së Zotit, mos përjetoni një gjendje largimi me ajetet e Allahut, mos të shuhet gjallëria e zemrave tuaja, lexojini përditë ajetet e Zotit, në mënyrë që zemrat tuaja të jenë përherë me përmendjen e Zotit... Kjo gjendje kërkon një gjallëri të vazhdueshme.”

dhe dhembshurinë e Tij e analizon shkakun e kësaj gjendjeje të zembrës, në mënyrë që ne ta kuptojmë më mirë problemin dhe të dalim prej saj...

Paralajmërimi: "Kini kujdes se mos bëheni si popujt e mëparshëm që u patën ardhur Libra hyjnorë" sjell në mendjen e njeriut arsyetimin se "kjo ka ngjarë edhe me popujt e mëparshëm, pra kjo është një dobësi e të gjithë njerëzve."

Si formohet kjo dobësi?

Ja dhe përgjigjja:

"Për shkak se pati kaluar një kohë e gjatë, që prej kohës që ata u njohën me Librin tek zemrat e tyre nisi ngurtësimi.

Madje ata filluan të dalin tërësisht nga rruga e drejtë."

Pra mes tyre dhe ajeteve të Zotit u krijua një distancë. Humbi gjallëria e tyre në marrëdhëniet me ajetet. Megjithëse ajetet e Allahut, në rast se përthithen me kuptimin e tyre të vërtetë kanë një karakter "rigjallërues", ndodh që njeriu nga neglizhenca e humbet aftësinë e tij prej marrësi. Zemra shkëputet nga përmendja e Zotit. Zemra shkëputet nga ajetet. Në fund fare zemra ngurtësohet. Përmendja e Zotit është uji i jetës për zemrën. Nëse ajetet e Zotit janë harta e udhës drejt përjetësisë për njeriun, marrëdhënia e tij me këtë udhë nis të dobësohet atëherë kur ai largohet nga përmendja e Zotit dhe mes tij dhe ajeteve të Zotit krijohet një distancë deri sa ai del nga rruga e vërtetë.

Le të mendojmë se brezi të cilit i drejtohet pyetja "A nuk erdhi koha?" qe brezi që jetoi në të njëjtën kohë me të Dërguarin e Allahut dhe jetoi sy më sy dhe zemër më zemër me të. Nuk ka dyshim se kjo pyetje u drejtohet të gjithë brezave, por nuk duhet harruar se i drejtohet edhe brezit aftësitë shpirtërore së të

cilit ishin të reja flakë dhe të gjalla në kulm.

Ndoshta ky është një paralajmërim.

"Mos të krijohet ndonjë distancë mes jush dhe përmendjes së Zotit, mos përjetoni një gjendje largimi me ajetet e Allahut, mos të shuhet gjallëria e zemrave tuaja, lexojini përditë ajetet e Zotit, në mënyrë që zemrat tuaja të jenë përherë me përmendjen e Zotit..."

Kjo gjendje kërkon një gjallëri të vazhdueshme."

Zoti na vë përpara një shpresë:

"Mendonit thellë dhe dijeni se Allahu e ka ringjallur gjithësinë nga vdekja."

Pra nuk na jep leje që të na zërë paniku se "Mos vallë zemrat tona vdiqën një herë e përgjithmonë?" Ja se si ai e ringjall tokën e tharë.

Me begatinë e Allahut i vdekuri ringjallet.

Shih pranverën dhe merru me zemrën tënde. Shih lulen dhe merru me zemrën tënde. Kapu fort pas përmendjes së Allahut. Kapuni pas ajeteve të Allahut. Puno për zemrën. Pastroje atë sërish me përmendjen e Allahut... Strehuju tek Allahu. Kërko ndihmë prej Tij. Ofroja zemrën tënde Atij...

A nuk erdhi koha? Po, koha ka ardhur. Eja në vete, kupto kohën. Kjo është koha jote për t'iu drejtuar Zotit.

Zoti na thërret. Pra Ai na pranon ne si bashkëbisedues me Të. "Ejani, kthehuni."

A nuk i ka kapërcyer Ai të gjitha kohët kur na ka thënë: **"O ti shpirt i qetë! Kthehu tek Zoti yt i kënaqur me Të! Hyr në mesin e robërve të Mi dhe futu në xhenet!"** (Fexhr, 29)...

Çfarë të them më shumë, dëgjoje ftesën e Zotit tënd shpirti im!



Përmendja e Zotit është uji i jetës për zemrën. Nëse ajetet e Zotit janë harta e udhës drejt përjetësisë për njeriun, marrëdhënia e tij me këtë udhë nis të dobësohet atëherë kur ai largohet nga përmendja e Zotit dhe mes tij dhe ajeteve të Zotit krijohet një distancë deri sa ai del nga rruga e vërtetë.



Pema e hurmave e Ebu Xhehlit në xhenet

All Riza Temel

Jam i sigurt se çdokush që lexon këtë titull, në fillim fare do të shastiset, sepse Ebu Xhehli, armiku më i madh që ka pasur feja islame, qoftë me fe, qoftë me logjikë, nuk mund të ketë ndonjë pemë hurmash në xhenet.

Raportohet se një natë Profeti ka parë në ëndërr sikur gjendej brenda në xhenet dhe aty sheh një pemë me hurma që i pëlqen pa masë. Ai pyet se e kujt ishte ajo pemë, një zë i thotë se ajo është pema e Ebu Xhehlit. Kur dëgjon këto fjalë, Profeti hutohet. Pyet veten: “Si është e mundur të ketë një pemë në xhenet për Ebu Xhehlin, personin që nuk do të hyjë kurrë brenda në xhenet?”

Ebu Xhehli ka qenë personi që nuk ka lënë gjë pa bërë, në mënyrë që ta ndalonte përhapjen e fesë islame. Ai rrihte dhe torturonte myslimanët e dobët, si dhe kërcënonte myslimanët e pasur dhe me pozitë në shoqëri duke përhapur shpifje rreth tyre dhe duke organizuar embargo tregtare ndaj tyre. Madje ai kishte dashur t’ia shtypte kokën me gur Profetit ndërsa ai duke u falur ishte në pozicionin e sexhdes dhe do ta kishte bërë këtë gjë, në qoftë se nuk do ta pengonte një forcë hyjnore e mbinatyrshme që nuk e linte t’i afrohej. Ebu Xhehli ishte në krye të personave që patën provokuar betejën e Bedrit. Ai i nxiste mushrikët për luftë, përsëriste fjalët se “do t’u mësojmë mirë myslimanëve se çfarë do të thotë të braktisësh adhurimin e idhujve Lat dhe Menat” dhe në çdo rast që gjente rrinte duke fyer të Dërguarin e Allahut dhe myslimanët. Ky armik i përbetuar i fesë

islame u vra në betejën e Bedrit. Profeti e pati quajtur Ebu Xhehlin “faraonin e umetit mysliman dhe koka e madhe e qafirëve”, prandaj kur pati mësuar se Ebu Xhehli qe vvarë e pati falënderuar Allahun.

Ebu Xhehli kishte një djalë që quhej Ikrimë. Ikrimë nuk i linte gjë mangur të atit Ebu Xhehlit në armiqësinë që ushqente ndaj fesë islame. Ikrimë pati luftuar në betejën e Bedrit përkrah të atit dhe u pati shkaktuar shumë dëme myslimanëve. Ai ishte njëri nga kalorësit më të famshëm që kishin mushrikët. Kishte marrë pjesë në grupin e Kurejshëve, të cilët duke shkelur marrëveshjen e Hudejbijes patën ndihmuar fisin e Benu Bekir që të vrisnin anëtarët e fisit Huzaa, të cilët ishin nën mbrojtjen e myslimanëve. Ai pati folur me të madhe duke thënë se “këmba e Muhamedit nuk do të shkelte në Mekë për sa kohë që jetonte edhe mushriku mekas i fundit.” Kur Profeti Muhamed çliroi Mekën, Ikrimë qe arratisur nga qyteti. Ai ishte i pari në listën e personave që Profeti pati urdhëruar të vriteshin për shkak të mizorive dhe krimeve që kishin kryer. Ikrimë kishte një bashkëshorte të zgjuar që quhej Umu Hakim. Kur u çliroi Meka, ajo së bashku me gruan e Ebu Sufjanit, Hindin patën formuar një grup prej dhjetë grash dhe kishin shkuar tek Profeti Muhamed (a.s.), që t’i deklaronte atij se pranonte të hynin në fenë islame. Pasi kishte pranuar fenë islame, Umu Hakim i pati thënë Profetit: “O i Dërguari i Allahut! Ikrimës i hyri frika kur pa se Meka po binte në duart tuaja

dhe është arratisur drejt Jemenit. Ai ka frikë se ti do ta vrasësh, prandaj të përgjërohëm që t'ia falësh jetën." I Dërguari i Allahut tha: "Atij ia fala jetën."

Pas këtyre fjalëve Umu Hakim kërkoi leje që të shkonte dhe të gjente të shoqin Ikrime. Ajo dërgoi skllavin e saj që ta gjente atë sa më parë. Skllavi arriti ta gjente Ikrimen në njërin prej limaneve të Tihamesë, teksa po përgatitej të hipte në anije për t'u arratisur sa më larg. Pas disa fjalësh që këmbëu Ikrime me pronarin e anijes Umu Hakim i tha këto fjalë Ikrimes, në mënyrë që ta bindte atë:

- Kam ardhur tek ti pasi jam ndarë nga personi që tregohet më i kujdesshëm se çdokush tjetër në lidhje me të drejtat që kanë antarët e farefisit ndaj tij. Prej njeriut më të vyer dhe më të mirë që ka bota. Mos e shkatërro veten tënde më kot. Unë i kam marrë fjalën të Dërguarit të Allahut se jeta jote është e sigurt.

Ikrime u bind dhe të dy së bashku u kthyen drejt Mekës.

Kur po i afroreshin Mekës, Profeti u tha sahabëve të tij:

- Drejt Mekës po vjen Ikrime, biri i Ebu Xhehlit. Ai e ka pranuar fenë islame, prandaj askush të mos thotë asnjë fjalë të keqe në lidhje me të atin. Fjala e keqe për të vdekurin vetëm sa e hidhëron pasardhësin e tij të gjallë, sepse atij në vetvete nuk i bën keq.

Kur Ikrime u shfaq te dera e çadrës, Profeti u ngrit në këmbë dhe e mirëpriti duke u përqaftuar me të. Profeti me këtë rast i tha:

- Mirë se erdhe, o kalorës mërgimtar! Një njeriu të zgjuar si ti i ka hije të pranojë fenë islame!

Umu Hakim i kujtoi Ikrimes sigurinë që i kishte dhënë Profeti, prandaj Ikrime tha shehadetin dhe u bë mysliman. Pasi tha shehadetin, Ikrime tha:

- Për Zotin, ti të fton vetëm drejt së vërtetës dhe drejtës, drejt të bukurës dhe fisnikes. Ti ke qenë personi më i mirë, më i besueshëm dhe më fjalëdrejti në mesin tonë edhe përpara se të vinte shpallja hyjnore.

Kur dëgjoji këto fjalë, i Dërguari i Allahut uli kokën nga turpi dhe modestia.

Ikrime i kujtoi Profetit armiqësinë e tij të shkuar dhe pati shtuar këto fjalë:

- O i Dërguari i Allahut! Unë dua që ti të kërkosh falje për mua nga Allahu për gjithë armiqësinë që kam treguar

ndaj teje, për gjithë hapat që kam hedhur në shërbim të përhapjes së shirkut apo për të shkuar në të gjitha vendet që të dilja ty kundër, për të gjitha fjalët e rënda që të kam thënë në sy apo pas krahëve tuaj!

I Dërguari i Allahut kërkoi nga Allahu që Ai t'ia falte gjynahet që kishte bërë në të kaluarën Ikrime. Ky veprim e gëzoi së tepërmi Ikrimen, i cili tha:

- O i Dërguari i Allahut! Nuk do të më ndalë asgjë deri sa të shpenzoj dyfishin e përpjekjeve në rrugën e Allahut, në krahasim me përpjekjet që kam bërë për t'i larguar njerëzit nga rruga e Allahut si dhe të marr pjesë dy herë më shumë në betejat për hir të Allahut, krahasuar me betejat që kam marr pjesë në luftën kundër Tij!

Ikrime dhe Umu Hakim ricelebruan martesën e tyre, tashmë të dy si myslimanë.

Pasi u bë mysliman Ikrime, me të dëgjuar se ndonjë kurejsh kishte në shtëpi ende ndonjë idhull sado të vogël në përmasa, shkonte tek shtëpia e tij dhe ia thyente. Në kohën e xhahilijetit ai kishte qenë njëri ndër tregtarët më të mëdhenj të tregtimit të idhujve. Ai merrte në dorë Kuranin dhe mes lotësh e puthte duke thënë: "Fjala e Zotit tim! Libri i Zotit tim!"

Ikrime pati treguar trimëri të rrallë në betejat e Riddes, duke mos ia ndarë sytë. Atyre myslimanëve që e këshillonin të bënte kujdes kur hidhej në fushën e betejës, ai u përgjigj:

"Unë nuk jam treguar i kujdesshëm kur kam luftuar më parë për hir të Latit e Uzasë dhe të tregohem i kujdesshëm tani që luftoj për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij? Jo! Kurrë nuk kam për ta bërë këtë gjë!" Kur vendosi të zbriste nga kali dhe të luftonte si ushtar këmbësor, Halid b. Velid i tha: "Mos! Ka për të qenë shumë e rëndë për myslimanët, në qoftë se ke për t'u vrarë në luftë! Ikrime iu përgjigj: "O Halid! Mos më pengo dhe mos më dil para! Ti nuk i ke bërë aq shumë dëme në të kaluarën tënde të Dërguarit të Allahut! Unë dhe babai im kemi qenë armiq të më të egër dhe të përbetuar të të Dërguarit të Allahut!" Ai ra shehid së bashku me të birin, Amrin. Pas betejës Halid b. Velid ua mori kokat në prehër dhe teksa ua pastronte fytyrat me ujë nga plagët e gjakut, rënkonte sesi nuk kishte rënë edhe ai vetë shehid.

Kur pati parë në ëndërr pemën e hurmës në xhenet

Unë dua që ti të kërkosh falje për mua nga Allahu për gjithë armiqësinë që kam treguar ndaj teje, për gjithë hapat që kam hedhur në shërbim të përhapjes së shirkut apo për të shkuar në të gjitha vendet që të dilja ty kundër, për të gjitha fjalët e rënda që të kam thënë në sy apo pas krahëve tuaj!

të Ebu Xhehlit, në fillim fare Profeti nuk i kishte dhënë kuptim asaj. Kur Ikrimë, djali i Ebu Xhehlit u bë mysliman, ai i pati thënë kështu gruas së tij Umu Seleme: "O Umu Seleme! Ja kush paska qenë pema e hurmës në xhenet e Ebu Xhehlit! Ashtu sikur kishte ngjarë me profetin Jusuf edhe profeti i dha shpjegim shumë më vonë kur Ikrimëja pati pranuar që të bëhej mysliman. *"Allahu e nxjerr të gjallin prej të vdekurit dhe të vdekurin prej të gjallit."* (Rum, 19) Ebu Xhehli ishte shpirtërisht i vdekur edhe kur ishte në jetë dhe iku nga kjo jetë duke mos manifestuar as shenjë më të vogël të gjallërimit shpirtëror. Madje edhe në momentet që po vdiste ai nxirrte në pah mendjemadhësinë e femohimit dhe kokëfortësinë e mosbesimit. Edhe djali i tij Ikrimë jetoi në këtë botë duke qenë i vdekur "shpirtërisht", por u ngjall në momentin që i vuri veshin thirrjes hyjnore: **"O ju që keni besuar! Kur t'ju ftojë Profeti në ato gjëra që janë jetë për ju, dëgjojeni thirrjen e Allahut dhe të Dërguarit të Tij,"** (Enfal, 24)

Pema e hurmës, e parë në ëndërr, komentohet si begati. Në rast se shihet një pemë hurme në xhenet, ajo komentohet si një begati dhe mirësi e madhe. Megjithëse në fillim Ikrimë i kishte shkaktuar shumë dëme bashkësisë myslimane, ai arriti që ta kompensonte disafish dëmin e kryer duke treguar një guxim dhe sakrificë të paparë në rrugën e fesë islame në fund të jetës së tij. Në momentin që po pranonte fenë islame, kishte premtuar se do të tregonte të paktën në rrugën e fesë islame dyfishin e zellit që kishte treguar më parë në luftën kundër saj. Ai e mbajti fjalën që dha. Arriti shkallën e shehidit të cilën nuk e arriti as vetë Halid b. Velidi, megjithëse e kishte zili për këtë gjë.

Ëndrra që pa i Dërguari i Allahut që e mbushur me mësim për t'u marrë parasysh. Nga kjo histori mësojmë se sa e gabuar është të vlerësojmë njerëzit duke parë prejardhjen e tyre dhe pozitën e tyre të një periudhe kohore të caktuar. Ashtu sikurse një i gjallë me shpirt si Ikrimë rridhte nga gjaku i Ebu Xhehlit një njeriu të vdekur me shpirt që në këtë jetë, në jetë mund dhe ka ndodhur edhe e kundërta. Madje kemi raste kur biri i Profetit apo gruaja e tij nuk patën përfituar aspak nga fryma gjallëruese e shpalljes hyjnore, por u patën mbytur

brenda atmosferës helmuese të mosbesimit (kufr) dhe patën vdekur duke qenë mosbesimtar. Kështu pati ngjarë me birin e Nuhut dhe me gruan e Lutit...

Përveç vendimmarrjes së Ikrimës për ringjalljen e tij shpirtëror të simbolizuar nga pema e hurmës në xhenet, nuk duhet harruar edhe roli i mirësisë hyjnore të Allahut dhe qëndrimi i të Dërguarit të Allahut. Në qoftë se i Dërguari i Allahut nuk do t'ia kishte falur Ikrimës ato që kishte bërë më parë kundër tij, Ikrimëja nuk do të mund të shndërrohej në pemën e bekuar të hurmës, përkundër do të mbetej si një cung druri i xhehenemit.

Mësimi më i rëndësishëm që mund të nxjerrim nga kjo histori është që themelore nuk është të vrasësh, por të falësh jetë dhe ta shndërrosh armikun në mikun tënd. Ta bësh mikun armik është shumë e lehtë, por ta kthesh armikun në mik është jashtëzakonisht e vështirë. Para së gjithash, duhet të qëndrosh larg çdo veprimi dhe qëndrimi që nxit dhe provokon armiqësinë. Duke mos ia përplasur në fytyrë gabimet e mëparshme, por duke e rrokur atë me fjalët "Mirë se na erdhe, o kalorës mërgimtar!", si dhe duke ua ndaluar të pranishmëve që të flisnin keq rreth Ebu Xhehlit, faraonit të umetit mysliman me mendimin se kjo do ta bënte të ndihej keq të birin, Profeti Muhamed (a.s.), që sjellë jashtëzakonisht njerëzor, në mënyrë që ta shndërronte Ikrimën, armikun e dikurshëm të përbetuar të fesë islame, në luftëtarin trim të fesë islame. Xhahadi më fisnik është ai që arrin t'i shndërrojë njerëzit nga cungje xhehenemi, në pemë hurme xheneti.

Të gjithë dalin të fituar kur armikun e bën mikun tënd, pasi njeriu i rrezikshëm në këtë mënyrë do të shndërrohet në një person të dobishëm për veten dhe për të tjerët. T'ia fitosh zemrën njeriut, do të thotë të fitosh gjënë më të vyer që ai ka. A ka fitore më të madhe sesa ta shndërrosh njeriun që pranonte të vdiste për hir të idhujve Lat dhe Uzan, në njeriun që është gati të sakrifikojë gjithçka për hir të Allahut? Këto rreshta do t'i përmbyllim me këtë ajet të Kuranit, ku thuhet:

"Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të bëhet menjëherë mik i ngushtë." (Fussilet, 34)

Të gjithë dalin të fituar kur armikun e bën mikun tënd, pasi njeriu i rrezikshëm në këtë mënyrë do të shndërrohet në një person të dobishëm për veten dhe për të tjerët. T'ia fitosh zemrën njeriut, do të thotë të fitosh gjënë më të vyer që ai ka.



Rreth Profetit

Muhamed El-Gazali

I Dërguari i Allahut (a.s.) ishte më i buti i njerëzve, por edhe më trimi dhe më i drejti ndër njerëz. Ai ishte më i përmbajturi ndër njerëz; nuk e preku kurrë dorën e një gruaje ndaj të cilës nuk kishte të drejta. Ai ishte më bujari ndër njerëz, aq sa kurrë një monedhë ari apo argjendi nuk e kaloi natën në shtëpinë e tij. Nëse diçka tepronte në fund të ditës, sepse ai nuk kishte gjetur dikë që t'ia jepte dhe nata binte, ai do të dilte dhe nuk do të kthehej në shtëpi deri sa t'ia kish dhënë atë ndokujt në nevojë. Nga ajo që Allahu i dha, ai do te merrte vetëm ushqimin më të thjeshtë dhe më të kollajtë (për t'u gjetur): hurma dhe elb, duke dhënë çdo gjë tjetër në rrugë të Allahut. Kur iu kërkua ndonjë dhuratë, ai kurrë nuk refuzoi. Ai riparonte sandalet e veta dhe qepte teshat e veta dhe i shërbente familjes së tij dhe i ndihmonte ata të ndanin mishin.

Ai ishte më i turpshmi ndër njerëz, kështu që shikimi i tij nuk mund të rrinte gjatë në fytyrën e ndokujt: Ai do të pranonte ftesën e një njeriu të lirë ose të një skllavi, dhe të pranonte një dhuratë vetëm nëse ajo të mos ishte më shumë se një gllënjë qumësht ose kofsha e një lepuri dhe t'ia jepte diçka dhuruesit. Ai nuk konsumoi asgjë të dhënë për sadaka (lëmshë). Ai nuk ishte shumë krenar që t'ia kundërpërgjigjej një vajze skllave ose një varfanjakeje me leckë. Ai mund të nevikosej për hir të Zotit të tij, kurrë për veten e tij; ai do të bënte të mbizotëronte e vërteta dhe drejtësia edhe nëse kjo do të çonte në mos rehati për atë ose për shokët e tij.

A kishte zakon të ngjiste një gur në bark për të përballuar urinë. Ai do të hante çfarë t'ia silllej dhe nuk do të refuzonte asnjë ushqim të lejuar. Nëse kishte hurma pa bukë, ai do të hante, nëse do të kishte mish të pjekur, ai do të hante; nëse do të kishte vetëm bukë të fortë, ai do të hante; nëse do të kishte mjaltë ose diçka të ëmbël, ai do të hante; nëse do të kishte vetëm kos pa bukë, ai do të ishte krejt i kënaqur me atë.

Ai nuk u ngop as me bukë elbi, për tre ditë rresht, deri në ditën që takoi Zotin e tij, jo për varfërinë e tij apo koprracinë, por sepse ai preferonte të tjerët para vetes.

Ai do të shkonte në dasma dhe do të vizitonte të sëmuret dhe të shkonte në varrime dhe shpesh do të kalonte përmes armiqve të tij pa një roje. Ai ishte më i

përluri ndër njerëzit dhe më i kthjellti, pa arrogancë. Ai ishte më i shprehuri ndër njerëzit, duke mos folur kurrë tepër gjatë. Ai ishte më i gëzuar ndër njerëzit. Ai nuk i frikësohej asgjëje të kësaj bote. Ai vishte një si mantel Jemeni, ose një tunikë prej leshi; ai do të vishte çdo gjë që ishte e ligjshme dhe praktike. Ai do të ngjiste çdo kafshë që t'ia vinte për mbarë: ndonjëherë një kalë, ndonjëherë një deve, ndonjëherë një mushkë, ndonjëherë një gomar. Dhe nganjëherë ai do të ecte zbathur, pa një veshje të sipërme ose pa çallmë ose pa mbulesë koke. Ai do të vizitonte të sëmuret edhe nëse ata do të ishin në pjesën më të largët të Medines. Ai pëlqente parfumet dhe nuk pëlqente erërat e këqija.

Ai mbajti lidhje të ngrohta dhe besnike me të afërmit e tij, por duke mos preferuar ata në vend të ndokujt që ishte më superior se ata. Ai nuk shpërfilli kurrë njeri. Ai pranonte pendesat e kujt do që kërkonte falje. Ai bënte shaka, por nuk do të thoshte kurrë diçka që nuk ishte e vërtetë. Ai qeshte, por jo zhurmshëm. Ai ndiqte lojëra të lejuara dhe sporte dhe nuk do t'ia kritikonte ato. Ai do të bënte gara me gratë e tija. Zërat mund të ngriheshin rreth tij, dhe ai ishte i durueshëm. Ai merrte delen nga e cila milte qumësht për familjen e tij. Ai ecte përmes fushave të shokëve të tij. Ai nuk përbuzi kurrë ndonjë varfanjak për varfërinë apo sëmundjen e tij; as nuk frikësoi ndonjë mbret vetëm sepse ai ishte një mbret. Ai thërriste të pasurit dhe të varfrit për tek Allahu, pa dallim.

Tek ai, Allahu kombinoi të gjitha tiparet fisnike të karakterit; ndonëse kurrë nuk lexoi apo shkroi, duke qenë se u rrit në një vend injorance dhe shkretëtirash varfërie, si një bari, dhe si një jetim pa baba dhe pa nënë. Por Vetë Allahu i mësoi atij të gjitha cilësitë e shkëlqyera të karakterit, dhe mënyrat e lëvdueshme, dhe historitë e profetëve të hershëm dhe të mbramë, dhe rrugën për tek shpëtimi dhe triumfi në Ahiret, dhe të shijimit të veçimit në dynja, dhe si të qëndrohet fort në kryerjen e detyrimeve, dhe si të anashkalohej e panevojshmja. Dashtë Allahu të na japë sukses në bindjen ndaj tij, dhe në ndjekjen e Sunetit të tij. Amin ja rabbi al-alamin.

Përktheu: Erjon Temali

Dbikri dhe vitaliteti me Kuranin



Prof. dr. Sadik Këllëç

Si krijesa që ekzistojmë brenda në kohë dhe gjallojmë brenda një limiti të caktuar të saj, ndërgjegjësimi mbi konceptin e kohës është nja nga mundësitë e mëdha që i ofrohen njeriut. Aty ne përftojmë ndjenjën e unit e zhvillojmë atë dhe mbi të ndërtojmë universin tonë fizik dhe kulturor!

E thënë me fjalët e Fahredin Raziut (vd. 606/1209), koha është "lumi që buron nga fundet e malit të përjetësisë pa fillim dhe rrjedh drejt malit të përjetësisë pa mbarim." Pikërisht ky udhëtim i lumit na kujton neve se sa kalimtarë jemi në këtë jetë. Teksa e konsumojmë kohën në linjën e kësaj bote dhe të kësaj jete, nga një anë koha formësohet dhe hedh shtat duke na bërë që të përjetojmë emocionin e papërballueshëm të ekzistencës, ndërsa nga ana tjetër ajo bën të ngadalësohet ritmi i ndjenjave, emocioneve dhe shpërthimeve morale që janë në pronësinë shpirtërore të ekzistencës sonë. Kështu që koha bllokohet me mbetjet e saj damarët e ekzistencës dhe të ritmit shpirtëror.

1. KOHA E KALUAR, NDJESHMËRI E VYSHKUR...

Si përfundim, koha na ka rrethuar neve në çdo anë. Një moment të caktuar të kohës biem në tunelin e mitrës së nënës, pastaj gjatë udhëtimit tonë formohemi në formë

embrioni dhe në fund fare, kur shfaqemi në këtë botë në formën e njeriut, klithmat tona të para marrin kuptim brenda kufijve të kohës dhe të hapësirës duke hyrë kështu në botën e ekzistencës. Ai lumë i padukshëm i quajtur kohë ka shumë kohë që ka nisur të rrjedhë, madje çdo gjë ka nisur të marrë formë së bashku duke filluar që nga rrahja e zemrës, formimi dhe zhvillimi i qelizave, formimi i zemrës dhe i trurit, duke mbushur në këtë formë botën tonë të brendshme dhe të jashtme. Brenda kësaj rrjedhe duhet menjëherë të ndalemi një hop dhe të lexojmë mesazhet kuptimplote që na ka dërguar Zoti i Mëshirshëm me anë të rrahjeve të zemrës. Në emër të hartimit të një harte për rrugën që do të ndjekë aventura e ekzistencës sonë brenda rrjedhës së kohës dhe në emër të marrjes në dorë të iniciativës, ne duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi rrahjes së zemrave, ashtu siç është shprehur edhe poeti egjiptian me origjinë turke, Ahmet Shevki (vd. 1932):

"Në qetësi rrahja e zemrës më tha:

'Mos harro se jeta përbëhet nga minutat dhe sekondat, pra!'

Në lidhje me paradoksin mes vitalitetit të besimit me anë të kohës na e tërheq vëmendjen vetë Kurani i madhërueshëm! Në ajetin 16 të sures Hadid mësojmë

se për besimtarët dy janë mjetet që ata të arrijnë të mbajnë gjallë dhe vitale përherë ndjeshmërinë e tyre shpirtërore përballë ndikimit zbehës dhe gërryes të kohës: dhikri (përmendja e Zotit) dhe leximi i Kuranit.

“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë? Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur?”

Në periudhën e shpalljes hyjnore ky ajet i shpallur kishte të bënte me qortimin e një grupi të caktuar të besimtarëve për shkak të manifestimit nga ana e tyre e një gjendjeje përtacie dhe humbjeje të dinamizmit dhe fuqisë së besimit (Alusi, Ebu'l-Fadl Shihabudin, Ruhul-Me'ani, Bejrut, XXVII, 179.), por në të vërtetë në ajetin e mësipërm përdoret një shprehje më e përgjithshme kur thuhet:

“...për ata që kanë besuar...”,

duke përfshirë kështu të gjithë besimtarët në këtë paralajmërim hyjnor. Arsyeja e shpalljes së këtij ajeti është si më poshtë:

Kishin kaluar afërsisht trembëdhjetë apo shtatëmbëdhjetë vjet që kur kishte ardhur shpallja e parë. Aromat e shpalljes hyjnore, sihariqet nga qielli, vetëtimat në mes të errësirës, drita drejt horizonteve të së ardhmes kishin filluar të rreshonin palë-palë. Sqarimi që i ka bërë Ibn Mesudi (vd. 32/652) arsyes së shpalljes së këtij ajeti me aromë dhe freski të përhershme është shumë shokuese për besimtarin! Në lidhje me këtë ajet, që duhet të jetë shpallur në periudhën e Mekës, ai ka thënë: “Mes periudhës kur ne u bëmë myslimanë dhe momentit që u shpall ky ajet kishin kaluar katër vjet.” (Ibn Kethir (vd. 774/1372), Ebu'l-Fida, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim*, Bejrut, 1388/1969, IV, 310. Pjesa më e madhe e dijetarëve janë të mendimit se surja Hadid është shpallur në Medinë.) Sidoqoftë, në të dy rastet personat që u tërhiqet vëmendja dhe kritikohen me një gjuhë të ashpër janë sahabët, njerëzit modelë të idealizuar si “personalitetet e përzgjedhura që qenë dëshmitarë të shekullit të shpalljes, njerëzit më fisnikë. (Profeti (a.s.) ka thënë: “Sahabët e mi janë si yjet në qiej, këdo që të merrni shembull prej tyre keni për ta gjetur rugën e drejtë.”

Sipas Ibn Abasit (vd. 68/687) dhe Enesit (vd. 91/710) (r.a.), Allahu ua ka dhënë këtë mësim hyjnor të vlefshëm për të gjithë myslimanët deri në Ditën e Kiametit pas trembëdhjetë apo shtatëmbëdhjetë viteve që filloi shpallja hyjnore atyre e personave që për hir të besimit kishin shtëpi dhe katandi dhe kishin emigruar nga Meka në Medinë, të cilët kishin treguar guxim dhe trimëri në formimin e një bote të re me anë të personalitetit të besimit dhe fuqisë fizike, vetëm e vetëm se Ai kishte vërejtur se në zemrat e tyre nuk ekzistonte më emocioni dhe predispozicioni i mëparshëm i besimit. Zoti i kishte qortuar me fjalë, mjetin më efektiv të paralajmërimit dhe u kishte kërkuar të ktheheshin sërish në unin e tyre thelbësor që formon aksin e ekzistencës së tyre. (Sujuti, *Ed-Durru'l-Menthur*, VI, 174; *Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 179)

Cili ka qenë faktori dhe motivi themelor që u bë shkak për shfaqjen e këtij paralajmërimi hyjnor të Allahut? Çfarë zhvillimesh kishin ngjarë në botën shpirtërore të besimtarëve, që Vullneti Hyjnor kishte ndjerë nevojën për të ndërhyrë? Në tefsirin e Alusit, gjendet ky raportim nga Ameshi, që prek pikërisht pikën më delikate të ngjarjes. “Sahabët e të Dërguarit të Allahut, gjatë periudhës së shpalljes hyjnore në Meke përjetuan mungesë të madhe ushqimore dhe probleme të shumta për shkak të besimit të tyre, por kur erdhën në Medinë fituan liri të madhe dhe mundësi të mëdha materiale...

Kështu që ata filluan të tregohen më shumë indiferentë në disa pika që ishin treguar shumë më të kujdesshëm më përpara.” (Ebu's-Suud (vd. 951/1544), *Irshadu'l-Akli's-Selim*, Bejrut, VIII, 208; *Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 179.) Për shkak të argumentimit të konceptit të “hushu”-së në ajetin e mësipërm mund të thuhet se, ndikimi i kohës së kaluar mes mundësive materiale, bollëkut dhe moskokëçarjes mbi zemrën, manifestohet me dobësimin e forcës së aftësisë së drithërimës shpirtërore dhe të prehjes shpirtërore që përbëjnë thelbin e forcës së zemrës.

Hamdi Jazër Elmallëllë (vd. 1942) shprehet me këto fjalë, teksa nënvizon fuqinë shkatërruese të kalimit së kohës:

“Me kalimin e kohës ndjenjat plaken dhe e humbin freskinë e tyre. Dëshirat perëndojnë, zemra përjeton errësim dhe si rezultat i këtij ligji shpirtëror edhe



shoqëritë fillojnë ashtu si individ të përbërë në zhvillimin e tyre fetar faza të ndryshme që përngjajnë me zhvillimin fizik të njeriut, siç janë foshnjëria, fëmijëria, rinia, formimi, perfeksionimi dhe plakja. Prandaj shoqëritë e plakura arrijnë të gjejnë sërish jetë në sajë të ringjalljes së tyre shpirtërore, që e arrijnë me anë të rihyrjes në freskinë shpirtërore dhe vetëm në sajë të kësaj rruge mund të sigurojnë perfeksionimin e tyre." (Elmallëllë M. Hamdi Jazër, *Hak Dini Kur'an Dili*, Istanbul, 1979, VII, 4744).

2. HUMBIA E NDJESISË SË PREHJES SHPIRTËRORE (HUSHU).

Në kontekstin mes marrëdhënies njeri-e mira materiale, mund të thuhet se, në qoftë se nuk i themi dot ndal pasionit të "zotërimit", që është poli i kundërt i "ekzistencës dhe perfeksionimit", atëherë thesari më i madh që do të humbim në këtë rast do të jetë ndjeshmëria jonë ndaj qetësisë shpirtërore dhe frikës hyjnore! Ky hadith i raportuar nga Profeti është shprehje e kësaj të vërtete: "Gjëja e parë e rëndësishme që do të humbin njerëzit do të jetë ndjenja e qetësisë së shpirtit" (et-Taberi (vd. 310/922), Ibn Xherir *Xhami'u'l-Bejan 'an Tevili'l-Kuran*, 1954, XXVII, 228.)

Çfarë është qetësia shpirtërore?

Qetësi shpirtërore është bindja e brendshme e shpirtit që është gjithësia e vërtetë e ekzistencës, bindja dhe drithërima e tij. Kundrejt kuptimit leksikor të qetësisë shpirtërore që do të thotë qetësi e madhe, heshtje absolute apo lëshimi i vetvetes, kuptimi shpirtëror që i jep Islami kësaj fjale është bindja e vazhdueshme ndaj Allahut, mbushje e zemrës me devotshmëri dhe frikë ndaj Tij. Të jesh i bindur se do të vijë dita që do të takohesh me Zotin, sepse një ditë do të kthehesh sërish tek Ai. (Ude Halil Ebu Ude, *et-Tatavvuru'd-Dilali*, Jordani, 1985, fq. 199-201.) E thënë me fjalët e Xhunejdut, zemra duhet të jetë e bindur totalisht para "Njohësit së të gjithë sekreteve" (Ilhan Ayverdi, *Misalli Büyük Türkçe Sözlük*, İstanbul, 2005, 2, 1303)

Kuptojmë se fjala është një shenjë dhe paralajmërim në kontekstin e "marrëdhënies etimologji-kuptim" përballë rrezikut të myslimanit për t'u zhveshur nga ndjenjat e zemrës për t'u bërë i pandjeshëm dhe pa qetësi shpirtërore me kalimin e kohës!

3. GJENDJA E MOSNDJESHMËRISË SHPIRTËRORE: KASVET-I KALP

I ndjeri Alusi (vd. 1270/1854), pasi e ka cekur me fjalët: "Errësimi është burimi i fillimit të të gjitha të këqijave dhe zhvillohet si rezultat i indiferentizmit për një kohë të gjatë të urdhrave të Allahut." Gjendjen e errësimit, kur zemra fillon të humbasë cilësitë e saj të qetësisë shpirtërore, transmeton këto fjalë që besohet se i ka thënë profeti Isa: "Mos qëndroni kohë të gjatë pa e përmendur Allahun, sepse atëherë do t'u ngurtësohen zemrat tuaja! Ai që kupton se zemra e tij është forcuar dhe është bërë e pandjeshme, të nisë menjëherë të përmendë Zotin dhe të lexojë Librin e Tij, sepse vetëm kështu mund të kthehet në gjendjen e mëparshme!" (*Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 181.)

Muhammed bin el-Fadl ka thënë se kasvet-i kalb shkaktohet nga ushqimi haram, marrja me gjëra të kota, angazhimi me gjëra të rrejshme dhe zemra e ngurtësuar bëhet e pandjeshme ndaj kryerjes së gjynaheve. (Sulemi (vd. 412/1021), Ebu Abdurrahman Zijadat li-Hakaiki'-Tefsir, ed. Gerhard Böwering, Beirut, 1997, s. 152, 196.) Kështu që, në vend që të rrihet duke u lexuar Kurani vetëm sa për t'u lexuar, më mirë është që të mbylлим portën e **kasvetit** të zemrës, duke u përpjekur të hyjmë në ndikimin e atmosferës shpirtërore të Kuranit, duke u pajisur me ndjenjat e qetësisë shpirtërore dhe frikës së Zotit për t'u distancuar nga të gjitha situatat negative. Hasan el-Basri (vd. 121/739), i

ka këshilluar me këto fjalë paralajmëruese myslimanët: "Dua t'ju tërheq vëmendjen! Beto hem tek Allahu se ai sahab ka lexuar më pak Kuran sesa përpiqeni të lexoni ju brenda ditës, prandaj edhe është qortuar nga ana e Zotit. Ndërsa ju lexoni më shumë pjesë nga Kurani, por mendoni se sa shumë gabime dhe gjynahe janë përhapur në mesin tuaj." (*Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 180.)

Ky tregim me protagonist Ebu Bekrin është një nga shembujt më konkretë që tregojnë se si munden krahët e këtij lugati që zhduk vitalitetin tonë shpirtëror të rrokjin brenda vetes çdo person në çdo kohë dhe në çfarëdo pozite të lartë shpirtërore qoftë ai. Një ditë, kur pranë tij gjendej një bashkësi nga zona e Jemames, Ebu Bekri dëgjon ajetin 16 të sures Hadid. Kur përfundon ajeti njerëzit e fisit Jemame zënë të qajnë me ngashërim. Ebu Bekri i sheh ata me kujdes dhe u thotë: "Të tillë ishim

Mes marrëdhënies njeri-e mira materiale, mund të thuhet se, në qoftë se nuk i themi dot ndal pasionit të "zotërimit", që është poli i kundërt i "ekzistencës dhe perfeksionimit", atëherë thesari më i madh që do të humbim në këtë rast do të jetë ndjeshmëria jonë ndaj qetësisë shpirtërore dhe frikës hyjnore!

edhe ne një herë e një kohë, deri sa na u ngurtësuan zemrat." (Fahredin er-Razi, *et-Tefsiru'l-Kebir*, Teheran, XXIX, 229; el-Alusi, *Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 180.)

4. RUAJUNI NGA EFEKTET E TURBULLIRËS DHE INDIFERENCËS QË BUROJNË NGA KOHA!

Vlerësimi që duhet të bëjmë ne në këtë pikë është: njeriu e ka të pamundur të thyejë zinxhirin fizik të aspektit kohor të kësaj jete apo ta tejkalojë atë apo të parandalojë këtë zvarritje të kohës që shndërrohet në një tragjedi mendore dhe shpirtërore për njerëzimin. Megjithatë, njeriu duhet ta kuptojë se ai zotëron një hapësirë të gjerë lirie dhe preference përballë këtij paracaktimi të madh, sepse oqeani i tij shpirtëror dhe vullneti i tij janë ideali i tij i brendshëm dhe privat, në të cilin lundrojnë në gjendje të lëvizshme fuqitë e tij të preferencave dhe prirjeve humane. Mbajtja e kësaj pjese të njeriut në gjendje të lirë, vitale, të freskët dhe në gjendje aktive, të afërt me burimet dhe orientuesit e dritës hyjnore është një privilegj që i është dhuruar qenies njerëzore, në mënyrë që ai të shndërrojë errësirën e përkohshmërisë në një moment të përjetshëm. Në qoftë se arrijmë këtë nivel perceptimi dhe të kuptuari, dhe restaurojmë dhe normalizojmë me aromën e qetësisë shpirtërore mendjen dhe shpirtin tonë, atëherë shpirtat e besimtarëve kanë për të mbetur përherë të gjallë, të freskët dhe vitalë, edhe në qoftë se lëkura vjetërohet, gjaku trashet, dobësohet shikimi i syve dhe organet e humbasin funksionin e tyre.

Në brezin e kësaj hapësire të errësuar që gjendet larg jetës, ertësisë së të shenjtës dhe vetëdijes, ne mund të arrijmë ta gjejmë gjurmën e epokës të humbur vetëm në sajë të udhërrëfimit nga gjuhët që kanë shuar etjen e tyre në burimin e edukimit hyjnor. Ky informacion që na ka transmetuar neve Ibn Mesudi nga Profeti (a.s.) duhet vlerësuar si një kandil që ndriçon rrugën tonë: *"Mos e lejoni kohën të kalojë përmbi ju, sepse atëherë do t'ju ngurtësohen zemrat! Dijeni mirë se ajo që pritët të vijë është e afërt dhe mos e harroni kurrë se ajo që nuk do të vijë kurrë është e largët."* (Sujuti, *ed-Durru'l-Menthur*, VI, 175.)

Dy zgjidhjet që mund ta ndërpresin këtë proces kaq

të madh të vyshkjes dhe vjetërsimit janë përngjasimi i gjendjes së ekzistencës me përmendjen e Zotit brenda **enës** "së dijes, vetëdijes dhe syçeltësisë", duke e kthyer në shprehje ekzistence një proces vetëdijësimi me në qendër Allahun; më pas leximi i Kuranit, "shkëlqimit të së vërtetës së përhershme" që ka zbritur nga ana e Allahut me përpikmërinë e ndjesisë së përthithjes së pikave hyjnore dhe përpjekja e modelimit të jetës sipas Kuranit!

5. DHIKRI DHE KURANI JANË DY BURIMET E PËRHERSHME QË E MBAJNË GJALLËN NDJENJËN E QETËSISË SHPIRTËRORE.

Sipas një komentimi tjetër që e trajton në kontekstin e fuqisë intelektuale dhe shpirtërore që siguron besimtari nga leximi i Kuranit dhe përmendja e Zotit si dy burime të përhershme të mbajtjes gjallë të qetësisë shpirtërore, përmendja e Zotit që përmendet në ajetin 16 të sures Hadid është Kurani, ndërsa e vërteta që ka zbritur është qetësia shpirtërore që sigurohet nga leximi i Kuranit.

Kjo përjasje mbështetet në këtë rrëfim, që gjendet në Tefsirin e Alusit, ku tregohet: "Një person i quajtur Usejd b. Hudajr po lexonte suren Kehf dhe pranë tij qëndronte i lidhur kali që kishte. Papritur atë sahab e mbuloi një re e madhe. Kali i tij u frikësua nga kjo gjë dhe filloi të hidhte shqelma. Kur u bë mëngjes sahabi erdhi tek Profeti dhe i rrëfeu se çfarë kishte ngjarë. Profeti e dëgjoi me qetësi dhe në fund fare i tha: 'Kjo është prehja që zbret nga leximi i Kuranit!'" (Alusi, *Ruhu'l-Me'ani*, XXVII, 180; Buhari (vd. 256/870), *Sahih*, Tefsir, Feth, 4; Muslim, *Sahihu Muslim bi-Sherhi'n-Nevevi*, VI, 82)

Kjo do të thotë se leximi i Kuranit duhet t'i trondisë shtyllat tona të shpirtit dhe nëpërmjet leximit të Kuranit duhen shtënë në dorë përforcimet shpirtërore të besimtarit. Mundet që ngjarja, që në hadith është treguar si re, në fakt të jetë një mënyrë alegorike e blatimeve hyjnore.

6. SHEMBUJ NGA HISTORIA: HEBRENJTË DHE TË KRISHTERËT TË SHPARTALLUAR NGA HISTORIA.

Ajeti 16 i sures Hadid, nga njëra anë ka një frymë nxitjeje, ndërsa nga ana tjetër përmban një paralajmërim dhe qortim të shprehur me një gjuhë përgjithësuese.



Në ajetin e mësipërm u thuhet besimtarëve që “mos të bëhen si ata që u është dhënë Libri më përpara tyre”. Sado që lidhëza në gjuhën arabe *el-ledhine* është shumë e përgjithshme, sipas rregullave të gjuhës arabe pjesa “atyre që u është dhënë libri para jush” nuk nënkupton të gjithë popujt që kanë ardhur para ymetit të Muhamedit, por nënkupton në mënyrë specifike hebrenjtë dhe të krishterët, sepse ata ishin ndër bashkësitë fetare që e ruajtën për një kohë besimin e drejtë. Ata ia kishin frikën Allahut, u mbusheshin zemrat me qetësi kur dëgjonin t’u këndohej Teverati apo Inxhili dhe zemrat e tyre ishin të ndjeshme ndaj mësimave të Zotit. Vetëm se me kalimin e kohës bota e tyre shpirtërore nisi të ngurtësohej dhe filluan të mos përjetonin gjendjen e drithërimave shpirtërore kur dëgjonin t’u lexoheshin Librat e tyre. Por kjo nuk mbeti me kaq, sepse ata filluan të shpiknin gjëra të reja në fe, nisën ta komentonin besimin e tyre në përputhje me dëshirat e tyre vetjake dhe u ndanë në grupacione të shumta. (Ebu’s-Suud, *Irshad*, VIII, 209; Alusi, *Ruhu’l-Me’ani*, XXVII, 181.)

Kështu, Kurani na jep një shembull nga historia, duke na hapur rrugën që të mos biem në dialektikën e “ekzistencës dhe kohës” duke na dhënë si shembull hebrenjtë dhe të krishterët që kaluan nga një proces i tillë.

Në veprën *Ruhu’l-Me’ani* rrëfëhet një ngjarje e tillë e çuditshme: Ahmed b. Ebu’l-Havari tregon: Ndodhesha në një rrugicë të Basras.

Paspërjetim dëgjova një zë që thirrte dhe u drejtova nga drejtimi nga vinte thirrma. Aty pashë një njeri që ishte shtrirë në gjendje të fikëti.

- Çfarë ka ngjarë? – i pyeta ata që ishin përreth tij.
- Ky është një njeri shumë i ndjeshëm. – më thanë.
- Sapo dëgjoi një ajet të Kuranit i ra të fikët dhe ra në tokë shakull.

- Çfarë ajeti dëgjoi?
- **“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë? Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur?”**

Ndërkohë personi të cilit i kishte rënë të fikët erdhi në vete dhe tha :

*A nuk erdhi koha e përfundimit të ndarjes,
A nuk ka ardhur ende koha e buzëqeshjes?
Për këtë të apasionuar të shkrirë dhe të thyer më
dysh, ka ardhur*

*A nuk ka ardhur ende koha që të qani dhe të kërkoni
mëshirë prej Zotit?*

Pastaj nisi të përsëriste me vete: “Vështirë, shumë vështirë!” dhe i ra sërish të fikët. Filluan ta tundnin që të ngrihej, por ai tanikishte vdekur. (*Ruhu’l-Me’ani*, XXVII, 180.)

7. DHIKRI DHE KURANI, BURIME TË PASHTERRSHËM QË RINGJALLIN ZEMRAT!

Në ajetin e 17 të sures Hadid vihet theksi tek fakti që leximi i Kuranit dhe dhikri i Kuranit janë burimi i ringjalljes së ndjeshmërisë njerëzore dhe dy burime të energjisë hyjnore. Ja edhe ajeti i mëposhtëm, që tregon një tërësi kuptimore me ajetin 16 të sures Hadid, në

të cilën Zoti e ngjason ringjalljen e zemrave të ngurta me anë të leximit të Kuranit me ringjalljen e tokës së tharë nga reshjet e shiut, duke na treguar kështu me rrugë krahasimi se Ai nxit për qetësinë shpirtërore në sajë të së cilës ringjallen zemrat dhe nga ana tjetër na tërheq vërejte që të ruhem i zemrat tona të mos ngurtësohen, në të kundërt:

“Dijeni se Allahu e bën tokën që të ringjallet pasi ka vdekur nga tharja e madhe... Ne ua sqarojmë argumentet tona, në mënyrë që ju të përdorni mendjet tuaja.”

(Hadid, 17)

Si përfundim, mund të themi se edhe pas afërsisht një mijë e pesëqind vjetësh pas shpalljes së frymëzimit të parë hyjnor drejtuar njerëzimit, shpirtat tanë të përzhitur dhe mendjet tona konfuze kanë nevojë që të nisim një udhëtim të ri eksplorimi. Në përfundim të këtij udhëtimi, që synon të rikonceptojë sërish të kaluarën, për të formësuar në sajë të kinetikës së marrë nga e kaluara një të ardhme sa më shumë dinamike, do të arrihet gjithashtu që uni ynë të kapë të vërtetat e humbura, duke bërë që argumentet me fjalë të Zotit që janë ajetet e Kuranit dhe argumentet kozmike, të cilat janë shenjat e universit, do të qartësohen edhe më shumë për shpirtat e besimtarëve dhe në zemrat e tyre do të fryjnë sërish erërat rigjallëruese. Kjo ringjallje do të kaptojë të gjithë fuqinë tonë shpirtërore dhe administrimin e vullnetit tonë.

Mund të themi se edhe pas afërsisht një mijë e pesëqind vjetësh pas shpalljes së frymëzimit të parë hyjnor drejtuar njerëzimit, shpirtat tanë të përzhitur dhe mendjet tona konfuze kanë nevojë që të nisim një udhëtim të ri eksplorimi.



Në kërkim të njerëzores...

Ela Muça

Do të shkruaj për të dhe ndjej se po futem në një labirint...

Zoti krijoi Gjithësinë, pastaj krijoi njeriun, me të cilin Krijuesi i dha jetë jetës.

Njeriu, një qenie humane prej mishi dhe gjaku, tërësia konkrete e një trupi të gjallë, u pajis me arsye dhe me një shpirt inteligjent. Çdo gjë filloi këtu, nga krijimi i Tij në mënyrë të përsosur.

Njeriut iu dha jeta, rruga ku i duhej të ecte e kështu u bë udhëtar. Udhëtari kërkoi të dijë rrugën dhe fillimisht iu desh të njohë veten e tij, të njihje virtytet, veçantitë, dobësitë, përgjegjësitë, të drejtat dhe kufijtë e tij.

Iu desh të mendonte dhe e pati këtë aftësi, të menduarit si një nga dhuratat më të çmuara që Zoti i dha, e ndihmoi të bënte pyetje dhe të arsyetonte mbi ndjesitë e tij, të cilat lindnin aty, tek shpirti i tij, aty ku fillon gjithçka, te brendia e tij sepse aty është ajo çka ka njeriu në vetvete që mbetet për shumë kohë dhe e vetmja gjë e qëndrueshme.

Jeta i fali mundësi njeriut, por dhimbja dhe brenga u shfaqën në çdo anë. Fati që i egër dhe njeriu u krijua i denjë për shpresë dhe për mëshirë.

Zoti i fali dashuri, e mëshiroi dhe ai filloi të dojë veten. Do të ishte e pamundur që kjo qenie të dhuronte dashuri, nëse kjo dashuri nuk do kishte mbushur shpirtin e tij. Kështu njeriu u bë burim energjie.

E pyet veten vazhdimisht se cili është qëllimi i jetës e për të marrë një përgjigje e mbush shpirtin e tij me

besim për të ecur, për të njohur, për të jetuar, për t'u ndjerë njeri, për të ndjerë jetën në dejet e tij; për të ndjerë zemrën që rreh nga bukuria dhe shëmnia, dashuria dhe urrejtja, guximi dhe frika, e drejta dhe e gabuara, butësia dhe zemërimi, mirësia dhe ligësia, por mbi të gjitha, këto kontraste e mbushin shpirtin e tij me besim dhe adhurim për Krijuesin e tij duke bërë që me këtë adhurim të largojë çdo ndjenjë të keqe nga udha e tij!

Eci nëpër jetë, jetoi, po a ishte i lumtur njeriu?

Në këtë hap kuptoi se po, ishte i lumtur sa herë lumturia buronte nga brendësia e tij, nëse ajo nuk ishte brenda shpirtit të tij, e pamundur të ishte jashtë dhe askund tjetër.

Filloi të ecë sërish... Çfarë është njerëzore?...

Ah njeriu! Në qendër të botës, të jetës, të natyrës, të shkencave dhe të shoqërisë... dhe sa pak dimë për të, por ai është njeriu, i krijuar në mënyrë të përsosur që ekziston mes kundërshtive të jetës... unë e shoh dhe e dua, nuk mundem të rri pa e thënë këtë, e dua sepse ai m'u përgjigj "Është njerëzore çfarë të bën të ndjesh, të duash mirësinë, të thuash të vërtetën dhe të adhurosh Zotin; është njerëzore ajo që është e moralshme, ajo që të mbush shpirtin dhe të bën të ndihesh njeri!"

Reze dielli, ajër, marr frymë... dola nga labirinti, jam, besoj, falenderoj Zotin për ekzistencën time, arsyen e jetës sime... besimin në Atë, i Cili krijoi Gjithçka!

Përgjithmonë, Adhuresja e Zotit!



Xhafer Durmush

Fjala E KULLUAR

A e përdorim sa duhet dhe me kujdes aftësinë tonë të të menduarit, që na dallon nga krijesat e tjera dhe të folurit që është rezultat i kësaj aftësie? A tregojmë gjatë përdorimit të aftësisë sonë të sqarimit dhe të shprehurit që janë shfaqje e atributit hyjnor të Fjalës, minimumin e kujdesit që manifestojmë teksa shpenzojmë për përfitimet tona personale?

Në ajete të ndryshme Zoti na urdhëron t'i dalim për zot fjalëve që themi. Ai na urdhëron ta peshojmë dhe masim mirë çdo fjalë që nxjerrim nga goja.

Prandaj edhe në ajetin 53 të sures Isra thuhet: ***"Thuaju robërve të Mi të flasin sa më bukur! Në të kundërt, shejtani ka për t'i futur në sherr me njëri-tjetrin, sepse ai është armik i hapur i njeriut."***

Këtu urdhërohen të gjithë besimtarët që të flasin fjalën më të hijshme që është aftësi e njeriut për të folur, pa iu përcaktuar atij asnjë kufizim në kohë apo në hapësirë. Në rast se nuk respektohet ky kriter, atëherë Zoti na njofton për shfaqjen e një rreziku të madh: Shejtani, armiku i hapur i njeriut, do të përdorë fjalët që ai thotë në mënyrë që të formojë një atmosferë ngatërrese dhe konflikti.

Pra ne jemi përgjegjës që përherë të themi fjalën më të hijshme; në qoftë se kjo nuk është e mundur, atëherë të themi fjalën më të afërt dhe më të përshtatshme me të dhe ta pastrojmë fjalorin tonë nga çdo lloj fjale e pahijshme.

Në veprën Ruhul-bejan thuhet se fjala më e hijshme është fjalia e dëshmisë e thënë me sinqeritet, pra "La

ilahe ilallah" dhe lutja ndaj Zotit.

Fjala e bukur është shkurt e saktë. Ajo thuhet aty ku duhet, kur duhet dhe aq sa duhet. Ajo është e saktë dhe e vlefshme dhe e shtyn bashkëbiseduesin drejt veprës së mirë. Ajo pajton njerëzit dhe zgjon ndjenjat sublime që gjenden brenda çdo njeriu.

Në varësi të karaktersitikave që numëruam më sipër edhe fjala konsiderohet e shëmtuar dhe e panevojshme në varësi të largësisë apo kundërshtisë që ka ajo me veçoritë e numëruara. E dyta përmban në vetvete gënjeshtra, përgojime dhe thashetheme. Në rastin më të mirë ajo është e përlyer me kotësi, pra kjo është distanca më e afërt që ka ajo me "fjalën e mirë". Ajo është e përshtatshme për t'u përdorur nga shejtani dhe ndihmësit e tij.

Ka shumë fjalë të urta të popullit që na mësojnë se si duhet ta ruajmë gjuhën tonë. Në mesin e sa e sa prej tyre unë do të mjaftohem vetëm duke përmendur atë që thotë se "fjala është argjend, heshtja flori." Le të përpiqemi të lexojmë edhe një herë me kujdes paralajmërimin e Profetit se "Ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Gjykimit, ose të thonë fjalë të mira, ose të heshtin." (Muslim, Iman, 74.) Le të lexojmë edhe një herë kapitujt në lidhje me ruajtjen e gjuhës që gjenden në veprat e dijetarëve myslimanë.

E di se fjala është thikë me ty tehe. Ajo ia hap portën sa e sa mirësive atëherë kur thuhet në kohën dhe në vendin e duhur, ashtu sikurse ka fjalë që kur thuhet pa masë, bëhen shkak për fatkeqësi të tmerrshme.

Prandaj edhe në Kuran thuhet kështu, në mënyrë që të na bëhet e ditur se çdo fjalë do t'i kthehet pro ose kundër zotërisë së saj, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër: **“Njeriu nuk ka fjalë që e thotë dhe të mos e regjistrojë ndonjë melek që i gjendet pranë.”** (Kaf, 18) Ky ajet na kujton qartë se çdo fjalë që themi ka për t’u regjistruar.

Kultura jonë e pasuruar me besimin islam na ka mësuar këshillën e artë që “gëlltitu nëntë herë dhe fol një herë”. Ne jemi të detyruar të pyesim veten se sa mundohemi dhe përpiqemi ne, në mënyrë që të gjejmë fjalën më të hijshme dhe më të saktë.

Asnjë njeri me mend në kokë nuk e shpenzon më kot pasurinë e tij duke e bërë atë rrush e kumbulla. Njeriu merr masa në mënyrë që ta ruajë nga të tjerët pasurinë që ka në këtë botë, madje edhe shpenzojmë që të rrisim sigurinë e këtyre masave.

A kemi marrë masa, në mënyrë që fjalët tona të mos humbasin dhe të shkojnë dëm? A i kemi siguruar ato edhe më shumë duke i pajisur në fillim, në mes dhe në fund të tyre me të vërteta, të meritueshme për Zotin dhe të pastruara nga elementët e panevojshme? A janë fjalët tona aq të kulluara sa t’i rrëfejnë të gjithë botës

pastërtinë tonë të brendshme?

Këto dhe pyetje të tjera të ngjashme me to kanë shumë rëndësi që të zenë vend në shpirtin tonë me përgjigje bindëse, për faktin se vetëm në këtë mënyrë ne do të qartësojmë në mendjet tona imazhin e fesë islame që dëshirojmë të ndërtojmë. Mos pandehni se feja jonë e bukur kërkon prej nesh që të jemi njerëz nevrikë dhe me fytyrë të varur. Si mund të na e kërkojë neve këtë gjë feja, Profeti i së cilës urdhëron dhe thotë: **“Mos e konsidero të pavlefshme asnjë sjellje të mirë, madje as pritjen buzagaz të vëllait tënd të fesë.”** (Ebu Davud, Libas, 24)

Fjala, para se të kalojë nga potenciali në veprim është shprehje e mendimit. Ajo është pika e fundit nga e cila mund të mësojmë ngjyrën e qëllimeve përpara se ato të kthehen në veprim. Fjala që buron nga zemra i jep formë edhe personalitetit personit që e shpreh atë, së bashku me bashkëbiseduesin e tij. Prandaj fjala është pasqyra e thelbit.

Nëse është kështu, atëherë çdo fjalë e personave që e konsiderojnë mundësi mbërritjen në thelbin e jetës, duhet të jetë e matur në nivelin që mund të konsiderohet “e hijshme”.

A mund ta kthejmë këtë botë në një shëmbëllim të xhenetit?

“Ne do ta shkulim urrejtjen nga kraharori i tyre. Te këmbët e tyre do të rrjedhin lumenj dhe ata do të thonë: ‘Qoftë lavdëruar Allahu që na udhëzoi në këtë. Ne nuk do të ishim udhëzuar, sikur të mos na udhëzonte Allahu. Pa dyshim, të dërguarit e Zotit tonë kanë sjellë të vërtetën’. Dhe një zë do t’i thërrasë: “Ky është Xheneti që ju e keni merituar për atë që keni punuar.” (Araf, 43)

Ndërsa tek ajetet rrëfehen ngjarje që kanë për të ndodhur në të ardhmen, nuk përdoret forma e kohës së ardhme, por ajo e kohës së tashme apo të kryer. Kjo tregon se ngjarjet që rrëfehen kanë për të ngjarë se s’bën dhe para syve të lexuesve pikturohet edhe pamja e atyre

ngjarjeve. Atyre u duket se janë duke e parë me sytë e tyre gëzimin e reflektuar në fytyrat e njerëzve të xhenetit.

Në qoftë se arrini ta lexoni Kuranin duke e ndjerë atë, do të pandehni se kuptimet marrin formë, se karakteret e tij formësohen dhe përpara syve tuaj shihni të kaluarën dhe të ardhmen. Nga ky aspekt, ajeti i mësipërm pikturon një tablo që i fal qetësi botës sonë të brendshme. A thua se në fytyrat e lexuesve lexohet prehja e atyre që rrëfehen në tablo dhe ata pastrohen nga ndjesitë që ia bëjnë të ngushtë këtë botë njeriut. Në zemrat e tyre nuk ka mbetur asgjë në emër të së keqes...

Njeriu e stolis ambientin ku jeton me panorama qetësuese. Ah sikur të arrijmë të gdhendim në shpirtin tonë tablonë e cila pikturohet në ajetin e mësipërm, të dëshirojmë me gjithë shpirt që “të bëhemi njëri nga personat e rrëfyer në ajetin e mësipërm si njerëzit buzagazë në përjetësi” dhe të arrijmë të shkëpusim nga zemrat tona smirën njëherë e përgjithmonë!

Si thoni? A mund të transmetojmë në këtë botë një puih nga jeta e xhenetit?



Edukata para mësimmit

Nuredin Nazarko

Njeriu është qenia së cilës i është dhuruar mundësia të meditojë, të mendojë, të diskutojë dhe të debatojë mbi vetveten dhe mbi botën që e rrethon, e dukshme apo e padukshme. Bota në të cilën jetojmë nuk është zgjedhja jonë. Ardhja në jetë nuk është zgjedhja jonë. Konstrukti ynë fizik dhe funksionimi i tij nuk është zgjedhja jonë. Kësisoj, mund të konkludojmë se njeriu nuk vjen në jetë tërësisht bosh. Ndërkohë, përgjatë jetës, ai nëpërmjet shqisave aktivizohet për të mësuar mbi veten, botën dhe lidhjen mes tyre. Ai lexon, dëgjon, shikon, përjeton dhe grumbullon përvojë, duke mësuar vazhdimisht. Meqenëse shumë gjëra njeriu i njej nëpërmjet të mësuarit përgjatë jetës, atëherë mund të konkludojmë se të mësuarit është rruga nëpërmjet së cilës njeriu mbush pjesën bosh me të cilën vjen në jetë.

Sikundërse e kemi të qartë, të mësuarit implikon tjetrin me veten tonë, pasi që njeriu nuk mundet të mësojë gjithçka vetvetiu dhe gjithçka nga mundi i tij vetjak. Të rriturit, do të mësojnë të vegjlit, të diturit do të mësojnë të paditurit, më pak të diturit do të mësojnë prej atyre që dinë më shumë. Kësisoj, të mësuarit është prej rendit natyror dhe rrjedhimisht ne nuk mund t'i shmangemi rendit natyror përbrenda të cilit jetojmë. Qysh nga qenia e parë njerëzore, të mësuarit nga dikush, është absolutisht i pashmangshëm dhe ajo çfarë na është dhënë mundësia të mësojmë është një pikë në oqean në raport me atë që njeriu e ka të pamundur ta mësojë, për shkak të kufizueshmërisë së tij. Njeriut i është dhënë mundësia të mësojë, aq sa mundësitë e tij arrijnë të durojnë peshën e dijes dhe aq sa është e

nevojshme për njeriun për t'u qartësuar mbi zgjedhjen e rrugëtimit të tij në jetë.

Të mësuarit nëpërmjet atyre që dinë më shumë, është rruga kryesore nëpër të cilën duhet të kalojë çdokush që dëshiron të ngrihet gjithmonë e më lart në sferat e dijes. Të lexuarit e librave, harxhimi i orëve të tëra nga jeta jote nëpër arkiva, rafta bibliotekash, është kushti për të mësuar, njohur, ditur. Por, në të gjithë këtë sakrificë me apo pa dashjen tonë do të zënë vend edhe njerëzit që dinë më shumë, jo vetëm nëpërmjet trashëgimisë së tyre në faqe librash, që vijnë nga thellësitë e kohës, por do të zënë vend edhe ata që dinë më shumë, bashkëkohës të të cilëve jemi. Vendi i tyre tek ne do të jetë edhe më i rëndësishëm në rast se do të kemi fatin dhe mirësinë t'i njohim nga afër, të qëndrojmë me ta, të dëgjojmë prej tyre sesi i kanë kuptuar dhe zburthëjnë dituritë që kanë mësuar. Të qenët prezent, të qenët i pranishëm me njerëzit që dinë më shumë është një luks që nuk ka çmim me të cilin mund të paguhet. Prandaj, duhet të vlerësojmë me rëndësinë më të madhe dhe seriozitetin më të madh përfitimin prej urtësisë, kuptueshmërisë dhe diturisë së tyre, në rast se kemi fatin të qëndrojmë në praninë e tyre. Të tregohesh i pakujdesshëm dhe shpërdorues nëse të jepet kjo mundësi, nuk tregon aspak shenja pjekurie dhe serioziteti.

Mënyrat për të mbërritur sot tek njohja dhe të dituria, janë shumëfishuar në sajë të zgjerimit të përdorimit të teknologjisë në shpërndarjen e informacionit, zbulimeve shkencore, diturive. Megjithatë asnjë prej mënyrave bashkëkohore nuk mund ta zëvendësojë atë

të parëhershmen. Ne mund të vjelim informacion, artikuj, ese, libra prej teknologjisë, por nuk mund të vjelim kurrsesi ndjesitë që përjeton kur zhytsh tërësisht në fletët e librit apo në shpjegimet dhe komentet e drejtpërdrejta të njeriut të ditur. Siç është e kuptueshme, roli i njeriut të ditur në shpërndarjen e diturive është i rëndësishëm primare dhe rrjedhimisht këta personalitete që shërbejnë si kandila duhen nderuar me shkallën më të lartë të nderit, mirënjohjes, sepse është sakrifica e tyre që na shenjon orientimin tonë në binarët e rendit natyror të gjërave.

Nderimi dhe mirënjohja ndaj njerëzve të ditur nuk shprehet vetëm me magazinimin e diturive që ata transmetojnë dhe mospërtypjen e tyre. Nderimi dhe mirënjohja ndaj tyre shprehet, duke u përpjekur për të ndjekur modelin e tyre, frymën e sakrificës së tyre dhe mbi të gjitha, urtësinë, shpirtmadhësinë dhe zemërgjerësinë e tyre. A mund të jemi plotësisht të suksesshëm në këtë përpjekje? Edhe mund të jemi, edhe s'mund të jemi, por tek e fundit duhet të realizojmë përgjegjësinë e asaj që na është dhuruar, ashtu sikundërse modelet tona frymëzuese kanë punuar për këtë përgjegjësi, me guxim dhe kurajo pa u përkulur para shkëlqimit të floririt dhe butësisë së mëndafshit.

Mësimi i diturive është i hapur ndaj gjithkujt, por dhënia e urtësisë dhe kuptueshmërisë nuk është e hapur ndaj gjithkujt. Pikërisht, për këtë arsye jo të gjithë që rreken të mësojnë mund të bëhen pjesë e kostelacionit të kandilëve që ndriçojnë rrugën e dijes dhe ndriçohen prej saj. Ndodh, ashtu sikundërse që ka ndodhur edhe në të kaluarën, që nxënësi të bëhet më i ditur sesa mësuesi i tij. E megjithatë, kjo nuk do të thotë që nxënësi, tashmë më i ditur sesa mësuesi i tij, të shndërrohet në përbuzës të atij që di më pak, sepse është puna dhe sakrifica e këtij mësuesi që sot di më pak, që e frymëzoi për të çarë rrugën e dijes me kurajo, guxim e durim. Është puna e vazhdueshme e këtij mësuesi që i bëri të mundur zgjimin e potencialit që i ishte dhuruar. Dhe për këtë duhet të jemi përjetësisht mirënjohës ndaj atyre që nxitën dhe zgjuan dëshirën dhe vullnetin për të hyrë në rrugën që të fisnikëron më shumë se çdo dhuratë tjetër. Nxënësi duhet të jetë mirënjohës ndaj mësuesve që e kanë mësuar dhe gjithmonë kur të qëndrojnë pranë tyre, të qëndrojnë si nxënës i tyre, të qëndrojnë me përlulje dhe respekt edhe pse mund të jetë sot më i ditur se mësuesi i tij, edhe pse mund të mos pajtohet në çdo mendim me mësuesin e tij. Mospajtueshmëria në çdo mendim është njerëzore dhe buron nga unikaliteti i çdo

qenieje njerëzore. Përtej ndryshueshmërisë gjenden parime të cilat nuk mund të sakrifkohen në altarin e egoizmit individual dhe në altarin e të ndjerit superior ndaj tjetrit, edhe pse tjetri është personi që të ka dëftuar hartën e rrugës që duhet të shkelësh për të mbërritur aty ku je sot.

Njeriu mund të magazinojë informacion, dituri, por në qoftë se ajo çfarë mëson nuk ndikon aspak në ndryshimin e personalitetit dhe cilësisë së jetës së tij dhe të njerëzve që janë në kontakt me të, atëherë me siguri mund të themi se ky njeri ka humbur shumëçka nga vitet e jetës së tij. Detyrë nuk është vetëm magazinimi i njohurive, madje ka njerëz të cilët e kryejnë më së miri këtë, por përtpja dhe nxjerrja e esencës së asaj që kemi përtpur. Pa realizuar përtpjen e asaj që mësojmë, asnjëherë nuk kemi arritur aty ku duhet, edhe pse mund të vetëkënaqemi me "arritjet" tona. Në rast se vetëkënaqësia do të jetë bashkëshoqëruese e magazinimit, atëherë nxënësi, duke menduar se "di" shumë, nuk e ka të vështirë të shpërthejë deri në arrogancë ndaj atyre që i kanë falur pjesë të jetës së tyre për ta mësuar. Po a është kjo sjellje e denjë për dikë që mendon se ka hyrë në rrugën e të lexuarit, mësuarit për të qenë një nga yjet e kostelacionit të të diturve?

Ata të cilët kanë gjetur vullnetin, durimin dhe sakrificën për të mësuar, nuk duhet të kujtojnë se çfarë janë duke arritur është vetëm rezultat i punës së tyre. Duhet kuptuar që pavarësisht zgjuarsisë, rritjes së nivelit të njohurive që zotëron, nuk mund të pretendosh superioritet ndaj të tjerëve. Në rast se pretendon superioritet, duhet ta dish se ajo që mendon se do të të lartësojë mund të kthehet në pikënisjen e rrokullmës tënde në honet e vogëlsisë vetanake. Prandaj, para se të mësojmë diturinë duhet të ndalemi dhe të mësojmë një gjë tjetër shumë më të rëndësishme, mungesa e së cilës jo vetëm mund të na çojë dëm vitet e lodhjes dhe sakrificës për të lexuar, por mund të na asgjësojë përfundimisht vlerat e të qenit një personalitet jo thjesht për hir të njerëzve.

Për këtë kthehemi tek urtësia e të urtëve, të cilët kanë gdhendur në pedestal këto fjalë: "Përpara se të mësosh diturinë, mëso edukatën." Kjo është tepër e rëndësishme dhe bazike, pasi që dituria është dritë dhe kjo dritë nuk mund të vendoset në një zemër ku mbizotëron ligësia dhe zgjatimet e saj, prandaj që të përfitojmë të ndriçuarit nga dituria, të mësojmë edukatën e pastrimit të vendit të diturisë, në mënyrë që të fillojmë ngjitjen drejt sferave të larta të fisnikëve dhe të nderuarve.



Shpresa tek Zoti

Ilhan Armutçullu

Kur Gazaliu i hyri rrugës së dijes në moshë të re, ndodhi që karvani ku ai gjendej të sulmohej nga një grup banditësh, të cilët u morën udhëtarëve gjithçka që ata kishin me vlerë. Mes të tjerash i morën Gazaliut edhe librat që kishte me vete.

Sado që ai iu përgjërua atyre që të mos ia merrnin, duke u përpjekur që t'u mbushte mendjen se librat nuk kishin se ç'u hynin në punë, ata ia morën ato.

Kështu që Gazaliu, duke filluar nga ajo ditë i mësonte përmendsh të gjithë librat që i binin në dorë nga frika se mos ia grabisnin sërish banditët. Këtë ndodhi e përmenda këtu për t'u treguar të rinjve tanë që studiojnë në shkollë se çfarë dëshire të madhe dhe pasioni ushqente Gazaliu ndaj librave.

Tani dëshiroj të bëj disa transmetime nga Gazaliu, nga vepra e tij Mukashefetul-kulub, në mënyrë që t'u kujtoj lexuesve se e gjithë jeta jonë duhet të lëkundet mes frikës dhe shpresës tek Zoti.

Raportohet nga Ebu Lejs Semerkandi:

Njeriu dallohet nga shtatë veprime dhe sjellje të tij nëse ai e do me të vërtetë Allahun apo nuk e do Atë:

Nga gjuha e tij: Në qoftë se një besimtar ose besimtare e fëlliq gjuhën e tij ose të saj me gënjeshtër, përgojime, përfolje të panevojshme dhe të kota, si

dhe me shpifje, ka hyrë nën peshën e një përgjegjësie shumë të madhe.

Gjuha duhet të flasë vetëm të vërtetën, të përmendë Zotin, të lexojë Kuranin dhe të bashkëbisedojë në tubimet e dijes.

Në histori kanë jetuar nëna dhe baballarë të tillë, që u përgjigjeshin bashkëbiseduesve të tyre duke u dhënë përgjigje vetëm me ndonjë ajet të Kuranit dhe këtë e bënin se kishin frikë se mos flasin nga mendja e tyre ndonjë fjalë të gabuar, për të cilën do të ishin përgjegjës më pas. Bashkëbiseduesit e tyre e kuptonin se çfarë dëshironin t'u thoshin ata me këto fjalë dhe vepronin në përputhje me ato që dëgjonin. Ajme! Të gjitha këto kanë mbetur në të kaluarën tashmë.

Junus Emre nuk pati thënë më kot se:

Ka fjalë që i japin fund luftës!

Të tjera që bëjnë të të fluturojë koka!

Ka fjalë të hidhura farmak

Ka dhe nga ato të ëmbla mjaltë...

Zoti ka robër të Tijët që në tubimet ku gjenden, flasin me zemër me bashkëbiseduesit e tyre, marrin vendimet e tyre dhe ngrihen e ikin.

Zemrat e tyre janë të purifikuara. Ata hedhin përjashta zemrave të tyre çdo gjë që nuk i pëlqen

Allahut. Pastrimi i zemrës dhe purifikimi i egos janë dy veprime shumë të rëndësishme.

Nxirre dhe shporre nga zemra jote çdo gjë, deri sa aty të pasqyrohet Zoti!

Padishahu nuk hyn në sarajin që nuk është përkryer deri në detaj!

Çfarë fatkeqësish janë sëmundjet e ndryshme të zemrës, si smira, armiçësia dhe zilia ndaj vëllait të besimit...

Melekët shkruajnë vetëm ato që shohin dhe dëgjojnë, ndërsa Zoti njih edhe shikimet tradhtare dhe atë që fshehin zemrat. Kujt do t'ia fshehësh atë që rreh në zemrën tënde.

Le ta shprehim edhe këtë veçori:

Dy qytetet e bekuara në botë janë Meka dhe Medina. Njeriu që gjendet në këto qytete është përgjegjës edhe për gjynahet që i shkojnë ndër mend dhe ka dëshirë t'i kryejë, edhe në rast se nuk i kryen ato.

Këto dy qytete të shenjta e mbajnë afër personin që e duan dhe e nxjerrin jashtë atyre atë që nuk e duan.

Përvoja ndër vite na ka mësuar se ka haxhilerë të cilët, edhe pse mbaron detyra e haxhit, ata nuk kanë dëshirë të largohen nga Haremejni, ndërsa ka të tillë që mezi presin momentin të kthehen pas në vendlindjen e tyre...

Besnikëria e disa fatlumëve realizohet edhe në Haremejn dhe ata qëndrojnë në Xhenetul-Muala dhe në Xhenetul-Baki...

Kur bëhen të tria bashkë një besim i panjollësor, një adhurim i sinqertë dhe edukimi i një udhëheqësi shpirtëror atëherë zemrat pastrohen dhe egot purifikohen.

Sëmundja e fundit shpirtëror që do të braktisë trupin tone, është dashuria për pushtet dhe poste. Në qoftë se njeriu arrin të shpëtojë nga kjo lloj dashurie, atëherë ai ka ngjitur piedestalin e evlijait.

Krahasuar me xhenetin, pasuria e kësaj bote është një hiç!

Po arrite ta shohësh me sytë e tu Zotin, Xheneti është një hiç!

Kohën konsideroje kritikë, mbështetu tek Zoti dhe zhytu në urtësinë!

Po ece shtrembër dhe hedh çdo gjë pas krahësh, jeta për ty është një hiç!

Mahmud Sami Ramazanogllu ka thënë se zemrat ndahen në pesë lloje:

- 1- Zemrat e vdekura
- 2- Zemrat e sëmura
- 3- Zemrat indiferente
- 4- Zemrat që përmendin Zotin
- 5- Zemrat e gjalla.

Tek zemrat e vdekura nuk ekziston shenjë përshtirshmërie. Zemrat e vdekura mund të ringjallen, por, në qoftë se neglizhohen vdesin shumë shpejt sërish.

Zemrat indiferente e përmendin Zotin më pak se gjysma e një 24 orëve të një dite, ndërsa zemrat që konsiderohen se e përmendin vërtet Atë, bëjnë dhikër më shumë se gjysma e një 24 orëve të ditës.

Zemrat e gjalla nuk tregohen indiferente ndaj përmendjes së Zotit në asnjë çast të minutave të 24 orëve të ditës dhe të gjithë veprimet i kryejnë në gjendje dhikri dhe ndjeshmërie.

Këto zemra kishin të gjithë profetët e Zotit me në krye profetin tonë Muhamed (a.s.), si dhe të gjithë evlijatë e Zotit.

Shejh Galip Dede pati recituar:

O shpirt! Përse edhe në këtë shkallë ti je i mbytur në pikëllim?

Nëse je një rrënojë atëherë ti je gonxhe e magjepsur!

Ti je krijesa së cilës melekët u urdhëruan t'i bien në sexhde!

Nuk është ashtu siç ti mendon, ti je më i miri nga të gjitha krijesat!


Ti je shpirti në të cilën fryu Xhebrail!

Ti je enigma e madhe dhe shëmblyltyra e Isait të Merjemes!

Duaje veten tënde se tek ti është thelbi i universit mbarë!

Ti je Ademi, njeriu ku reflekton kozmosi mbarë!





Kurani DHE SHKENCA

M.sc. Artan S. Mehmeti

HYRJE

Në Kuran vazhdimisht përsëritet thirrja e besimtarëve për të kërkuar dituri e në të njëjtën kohë, aty paraqiten një mori observimesh për shumë fenomene, si p.sh. qiejt, shiu, bimët, kafshët, lindja dhe perëndimi i Diellit, shenjat gjeografike, procesi i krijimit të njeriut, planetët, etj. Për t'i eksploruar këto fakte shkencore duhet t'i studiojmë! Në shumë ajete vërehet qartë rëndësia e kërkimit të diturisë dhe përdorimit të intelektit për të kuptuar shenjat – argumentet e Allahut (xh.sh.), në Tokë, kudo që janë ato. Sa u përket ajeteve kuranore, të cilat na thërrasin që ta studiojmë hapësirën ku jetojmë

si dhe hapësirën e gjithësisë, jenë të shumtë. Ne kemi zgjedhur vetëm një prej tyre.

Zoti (xh.sh.), në Kuran thotë:

“A nuk shikojnë ata me vëmendje nga qielli se si mbi ta e kemi ndërtuar atë, e kemi zburuar atë duke mos pasur në të ndonjë zbrazëti? Edhe tokën se si e kemi shtrirë e në të kemi vendosur kodra përforcuese dhe kemi bërë që në të të mbijnë gjithfarë bimësh të bukura. Dëshmi të dukshme dhe përkujtuese për secilin njeri që ka drejtuar mendjen. Ne, nga qielli lëshuam shiun e dobishëm dhe me të bëmë që të kultivohen kopshte e drithëra që korren. Dhe rritëm

trungje të gjata hurmash me fruta të vendosur njëri mbi tjetrin.” (Kaf 6-10)

KURANI NXIT QË TA STUDIOJMË SHKENCËN

Nuk njohim ndonjë fe prej feve, e as libër prej libra-ve qiellorë, që ka thirrur në përdorimin e logjikës dhe shfrytëzimin e saj në të menduar dhe konkludim, lidhjen e pasojave me shkaqet dhe rezultateve me premisat, vështrim dhe përkujtim, qortim të pasivitetit të aftësisë të cilën Allahu (xh.sh.), ia fali njeriut për të soditur atë që është rreth tij, shmangies nga dëshmitë e Allahut në persona dhe horizonte, vende dhe popuj, shembuj dhe leksione që kaluan në jetën e popujve dhe ajo që u pa prej rezultateve të veprave dhe moralit, në nivel të individëve, popujve, pushteteve dhe kombeve, ashtu siç veproi për këtë Kurani.¹

Për rëndësinë e kërkimit të diturisë Zoti (xh.sh.), në Kuran thotë:

“...Thuaj: ‘A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?’ Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” (Zumer 9)

Shumë shkencëtarët musliman të nxitur nga mësimet Kuranore për të studiuar e hulumtuar, iu përkushtuan jo vetëm shkencës islame, por edhe shkencës në përgjithësi. Këta shkencëtarë bënë zbulime të rëndësishme si në fushat e shkencave natyrore ashtu edhe të atyre humane – shoqërore. Të arriturat e myslimanëve në këto fusha shkencore janë të pamohueshme. Numri i shkencëtarëve që kontribuan në zhvillimin e shkencës është shumë i madh, mirëpo ne do të përmendim vetëm disa prej tyre: **Abdul Malik ibn Kureib el-Esmai** (740 – 828 e.r.) – konsiderohet si shkencëtari i parë mysliman, i cili kontriboi në zoologji, botanikë, dhe përkujdesjen e kafshëve; Al-Khvarizmi ishte gjithashtu edhe astronom dhe gjeograf i njohur. Njihet si themeluesi i algjibrës. Emri algjebër rrjedh nga libri i tij i famshëm “Al-Xhabrua-al-Mukabilah”; **Abu Musa Xhabir Ibn Haijan** (vdiq 880 e.r.) – i njohur me emrin Geber, kontributi i tij më i madh ishte në fushën e kimisë, njihet edhe si babai i

kimisë; **Abd El-Rrahman El-Sufi (Azofi)** (903 – 986 e.r.) – në botën perëndimore është i njohur si Azofi, kontriboi në astronomi dhe ishte ndër dy astronomët më të njohur gjatë mesjetës; **Ebul Kasim Halaf ibn El-Abas El- Zahravi (Albukasis)** (936 – 1013 e.r.) – shërbeu si fizikant në oborrin mbretëror të mbretit El-Hakami II të Spanjës, gjithashtu ishte një kirurg i dalluar. Pacientët dhe studentët nga gjithë vendet e Evropës vinin tek ai për mjekim si dhe këshilla; **Ebu Raihan Muhamed el-Biruni** (973 – 1048 e.r.) – ishte një astronom, matematikan, fizikant, gjeograf, gjeolog dhe historian i shquar; **Ibn Khalduni** (1332 – 1395 e.r.) – njihet si themeluesi dhe babai i sociologjisë dhe i shkencave të historisë; **Abu Abd Allah Muhammad al-Idrisi** (1099 – 1166 e.r.) – kontributi i tij është në gjeografi, hartografi, zoologji, botanikë. Ai gjithashtu dha ndihmesë të madhe në bimët mjekësore; **Ebu Ali el-Husein ibn Abdullah ibn Sina** (981 – 1037 e.r.) – është i njohur në filozofi, enciklopedi, matematikë dhe astronomi, ku ishte astronomi më me famë gjatë kohës së tij. Kontributi kryesor i tij ishte në shkencën e mjekësisë. Në botën perëndimore ishte i njohur me emrin Avicena; Si dhe shumë myslimanë tjerë që kontribuan në zhvillimin e shkencës.²

KURANI PËRMBAN SHUMË FAKTE SHKENCORE

Kurani, i cili ka zbritur në gjysmën e parë të shekullit të VII (p.e.r.) përmban shumë fakte shkencore, të cilat shkenca i ka verifikuar nëpërmjet teorive dhe aparaturave të ndërtuara për këtë qëllim. Fillimisht shumë shkencëtarë të asaj kohe dhe më pas, pushtetarë dhe udhëheqës të shteteve të ndryshme të Mesjetës apo dhe njerëz të tjerë, i përbuznin shkrimet që ndodheshin në Kuran dhe i quanin si trillimet e Muhamedit (a.s.). Por zhvillimi i shkencës në vendet myslimane dhe dhënia e mendimeve dhe e teorive shkencore në Evropë në kundërshtim me dogmat kishtarë bëri që të verifikohen një e nga një shkrimet që ndodheshin në Kuran.

Kurani ka shumë fakte shkencore, si: gjeografi, biologji,

1. Ebul-Hasen Ali en-NEDEVIJ, ISLAMI - ndikimi i tij në civilizim dhe merita e tij për njerëzimin. Përktheu nga arabishtja Bashkim ALIU, KOMITETI I BASHKUAR SAUDIT – NDIHMË KOSOËVË, Prishtinë 2002, f. 72

2. Më gjerësisht rreth myslimanëve që kontribuan në zhvillimin e shkencës mund të shikoni në: BIOGRAPHY Muslim Scholars and Scientists, Dr W. Hazmy C.H. Dr Zainurashid Z. Dr Hussaini R. (<http://www.social-sciences-and-humanities.com/PDF/Biographies-of-Muslim-Scholars-and-Scientists.pdf>); si dhe në uebfaqen <http://mendohu.ucoz.com/blog/2009-03-20-150>

mjekësi, astronomi, fizikë, ekonomi, histori etj., disa prej të cilave janë zbuluar vetëm në shekullin e kaluar. Këto zbulime në kohën e Muhamedit (a.s.), as që ishin menduar se mund të ekzistojnë, si dhe nuk kishin mundësi as që të zbuloheshin me teknikën e asaj kohe. Me përputhjen e plotë të të dhënave shkencore, jo vetëm të zbuluara në 2 – 3 shekujt e fundit me shkrimet e shenjta, tregon që këto nuk janë trillime të të dërguarit të Allahut, por fjalët e të Madhërishmit Fuqiptotë, që ka formuar gjithçka që ndodhet në Tokë dhe në hapësirën e pafund të Gjithësisë.

Në Kuran ka shumë fakte shkencore. Në pamundësi që t'i cekim të gjitha këto fakte, ne i kemi zgjedhur vetëm disa prej tyre: Kurani përshkruan prejardhjen e Tokës, bukuritë e saj, lëvizjen e planetëve, si dhe paralajmëron fundin e jetës në Tokë si dhe fundin e planetëve. Kurani na tregon se jeta në planetin Tokë e ka prejardhjen prej ujit. Kurani na tregon se njeriu nuk është krijuar nga sperma, por nga pika e saj e farës. Kurani tregon se lëngu i cili hidhet nga mashkulli (sperma) është përcaktues i gjinisë. Kurani tregon se Toka dhe planetët, yjet, satelitët, si dhe asteroidet e kometat, janë krijuar nga e njëjta materie gazo – pluhurore. Kurani tregon se malet kanë formë kunjash, si dhe janë në lëvizje të vazhdueshme. Kurani tregon se si krijohen retë dhe reshjet. Kurani na tregon për shumë ndodhi që kanë ndodhur në historinë e njerëzimit para shpalljes së tij. Kurani gjithashtu flet edhe për ekonominë, jurisprudencën e që në kohën e shpalljes së tij kanë qenë të paimagjinueshme.

Për këto fakte shkencore Zoti (xh.sh.), na tregon në Kuran, ku thotë:

“Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në të nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argumente.” (Bekare 164)

Muhamedi (a.s.), nuk ishte as astronom, gjeograf, biolog, mjek apo jurist, që t'i studionte këto fusha dhe

t'i shkruante këto teori kaq të sakta dhe precize para 1400 viteve ku shkencëtarët e asaj kohe as që mund t'i paramendonin e jo më t'i studionin dhe të shkruanin për to. Por edhe nëse supozojmë se Muhamedi (a.s.), ishte shkencëtari më i mirë i kohës, Ai (a.s.), nuk do të kishte mundësi t'i dinte dhe t'i studionte këto fakte që ndodhën në Kuran, për arsye se teknologjia e asaj kohe nuk do t'ia kishte mundësuar që t'i studionte këto fakte të cilat i pasqyrojmë më lart.

Se Muhamedi (a.s.), ishte njeri që nuk dinte shkrim e lexim, pa asnjë ditë shkollë na tregon edhe Zoti (xh. sh.), në Kuran:

Thuaj (Muhamed): “O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju. Allahut që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i Tokës, s'ka të adhuroar tjetër pos

Tij; Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje, pra besoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, peygamberin e pashkolluar, që beson Allahun dhe shpalljet e Tij, ndiqeni rrugën e tij që ta gjeni të vërtetën.” (Araf 158)

PËRFUNDIM

Vlera e diturisë për fenë islame është e veçantë. Këtë e vërteton fakti, se në shumë ajete kuranore Zoti (xh.sh.), u bën thirrje myslimaneve që të vrapojnë pas kërkimit të diturisë. Çdo njeri i cili analizon ajetet e Kuranit, kupton lehtësisht se Islami të obligon në arritjen e diturisë, si dhe zhvillimin e shkencës. Të

nxitur nga mësimet kuranore që

bëjnë thirrje në kërkimin e diturisë, shumë myslimanë iu përkushtuan jo vetëm shkencës islame, por edhe shkencës në përgjithësi.

Kurani ka shumë fakte shkencore nga lëmet e gjeografisë, biologjisë, mjekësisë, astronomisë, fizikës, ekonomisë, historisë etj. Muhamedi (a.s.), ishte njeri i pashkolluar, nuk dinte shkrim e lexim. Në fund lind pyetja: si ka mundur t'i dinte, dhe t'i shkruante një njeri analfabet, i cili nuk dinte shkrim e lexim këto të dhëna shkencore? Pa dyshim se përgjigja e vetme dhe e saktë është se Kurani është fjalë e Zotit (xh.sh.), e të Gjithëditurit, të Urtit, të Gjithëfuqishmit, si dhe Muhamedi (a.s.), ishte njeri si gjithë të tjerët, mirëpo ishte i dalluar me shpallje hyjnore, pra i dërguar i Zotit (xh.sh.).

Me përputhjen e plotë të të dhënave shkencore, jo vetëm të zbuluara në 2 – 3 shekujt e fundit me shkrimet e shenjta, tregon që këto nuk janë trillime të të dërguarit të Allahut, por fjalët e të Madhërishmit Fuqiptotë, që ka formuar gjithçka që ndodhet në Tokë dhe në hapësirën e pafund të Gjithësisë.



RËNDËSIA E SISTEMIT TË VAKËFIT DHE INKORPORIMI I PROGRAMEVE TË VAKËFIT NË JETËN BASHKËKOHORE

Taxhudin Hamidi

Fjalët e shumë kulturologëve, historianëve, arkeologëve dhe argumente të fuqishme të teologëve, se nuk ka pasur dhe as nuk do të ketë ndonjëherë qytet pa tempull, tregojnë se është pikërisht tempulli ai që e lind dhe që e mban qytetin.

Tempulli ka qenë dhe mbetet gjithmonë qendra, shpirti dhe zemra e çdo qyteti, qytetërimi, feje, kulture dhe i çdo aktiviteti tjetër jetësor, shpirtëror dhe mendor që ka pasur dhe do të ketë njerëzimi.

Është tempulli ai që krijon komunitetin, që e bën njeriun të mendojë dhe të ndjejë se ai merr pjesë në fatet e përbashkëta të gjithë racës njerëzore, ai që i jep njerëzimit vlera universale.

Ndërsa qyteti rritej rreth tempullit fizikisht, ai rritej gjithashtu dhe nëpërmjet tij në mendim, kulturë dhe qytetërim.

Qytetërimi dhe kultura krijohen nga një mënyrë e të jetuarit, e cila ka filluar në tempull, është ushqyer nga ai dhe mbahet prej tij.

Përsëri tempulli mbetet shtylla kryesore e një qytetërimi.

Trashëgimia kulturore dhe shpirtërore, që ne e quajmë me fjalë më sublimë Vakëf në shtresat më të përsosura të ndërgjegjes sonë ka qenë, është dhe mbetet edhe më tutje si shkalla e rindërtimit të nocionit dhe kujtesës për të jetuar në paqe dhe për të menduar me paqe.

VAKËFI, MOTIV I PËRFORCIMIT SHPIRTËROR, MENDOR DHE FIZIK

Njëra ndër ngjarjet e rëndësishme të periudhës së

Muhamedit (a.s.), para pejgamberllëkut të tij është momenti i meremetimit të Qabes.

Momentet e meremetimit të Qabes, në Mekë e kishin përforcuar atmosferën shpirtërore dhe kuptimore, andaj edhe ndjenjat shpirtërore të Muhamedit (a.s.), kishin fituar fuqi.

Kur Muhamedi ishte në moshën 35- vjeçare Qabja ishte dëmtuar tepër nga një zjarr që e kishte kapluar.

Mekasit vendosën që ta prishin Qaben, e cila ishte ndërtuar prej tullave të dheut dhe ta ndërtonin me mur prej guri.

Pejgamberi ynë personalisht kishte marrë pjesë në këtë aktivitet ndërtimi duke bartur gurë në shpinë.

Pas meremetimit të Qabes, Muhamedin (a.s.), e kapluan ndjenjat e entuziazmit dhe bindja fetare, kohë pas kohe filloi të largohej nga shoqëria e familja e tij.

Veçanërisht gjatë muajit të ramazanit, shkonte në një kodër, në shpellën Hira dhe kështu ndodhi 5 vjet.

Entuziazmi i paraqitur tek Muhamedi (a.s.) dhe shfaqja e kësaj dashurie rrjedhimisht shpërtheu nga ndërmarrja e aktiviteteve për të riparuar ndërtimin e Qabes dhe përfundimi i këtij meremetimi shfaq një shtytje të fortë tek ndjenjat, dëshirat dhe bindja fetare në mbrendinë e personalitetit të Muhamedit (a.s.), ku pas pesë vitesh pasoi zbritja e Kuranit.

Kjo do të thotë se projektet ndërtimore dhe aktivitetet e vakëfit ishin një provë dhe dëshmi për shpalljen e Kuranit.

Kështu bëri më herërt edhe Davudi dhe djali i tij Sulej-

mani me tempullin e ndërtuar, në të cilin u rrit pishtarja e ndershmërisë, Merjema, nëna e Isait (a.s.).

CFARË FUNKSIONI KANË PASUR VAKËFET

Praqtja dhe zhvillimi i kulturës dhe i fesë isalme në Gadishullin Ballkanik është e lidhur ngushtë me ardhjen e Perandorisë Osmane në Ballkan, nga gjysma e dytë e shekullit të 14- të, deri në fillim të shekullit të 16- të.

Osmalinjtë që nga fillimi kanë vendosur sistem të ri të udhëheqjes me vlera të reja.

Në këtë kohë, në qytetet ballkanike, të cilët morën pamje orientale, u formuan lagje (mëhalla), në të cilat ka pasur objekte të shumta monumentale Islame, sikurse janë xhamitë, mesxhidet, teqet, tyrbet, medresetë, mejtepet etj.

Objektet arsimore fetare janë ndërtuar në pjesën qendrore të qyteteve, ku ka pasur edhe infrastrukturë përcjellëse të duhur.

Ndërtimi i shumë objekteve fetare islame dhe kulturore profane në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të lidhur me institucionet e vakëfeve dhe kanë luajtur rol të madh në zhvillimin kulturor-fetar dhe shoqëror-ekonomik të popullatës myslimane deri në fund të perandorisë osmane.

Një pjesë e madhe nga të ardhurat e vakëfeve është investuar në ndërtimin e institucioneve arsimore, medreseve dhe mejtepeve etj.

Për këtë arsye, nuk është e mundur të studiohet asnjë aspekt i marrëdhënieve shoqërore të përfaqësuara në jetën shoqërore – ekonomike, politike dhe sociale, posaçërisht në aspektin fetar, moral, kulturor, arsimor e ku vakëfet të mos kenë ndikuar dhe luajtur rol të madh në proceset e ndryshimeve të mëdha pozitive.

FUNKSIONI I VAKËFIT:

Formimi i institucionit të vakëfit në botën islame është i ndërlidhur drejtpërdrejt me paraqitjen e profetit Muhamed (s.a.) dhe predikimin e tij në fenë e shpallur nga Allahu (xh.sh.).

Inaugurimi i vakëfit është shfaqur me udhëtimin e Muahamedit (a.s.) dhe lidhja e tij mes Qabes dhe Mesxhidul Mekdis.

Kjo ngjarje historike vendosi rolin e vakëfit në qendër të vëmendjes dhe e afroi përpara çdo nisme të hajrit apo dobie të përgjithshme njerëzore.

Muhamedi (a.s.), me shembujt personalë i orientonte pasuesit e tij të themelonin vakëfe. Këtë veprim e shpjegonte kështu:

“Ju nuk do të arrini bekimin e Zotit, derisa nuk jepni

lëmoshë nga ajo që e keni më të vlefshme.”

Vakëfi si përcaktim i karakterit të tij të përgjithshëm ka kuptimin:

- se pronar i çdo sendi është Allahu,
- se prona është dhuruar nga Zoti për të mirën e njerëzve.

Ai ka rol shoqëror, ekonomik, politik, kulturor, arsimor dhe fetar.

Për zgjerimin e arsimit dhe kulturës, fondet e vakëfit kanë ndërtuar: shkolla, biblioteka dhe lexime me karakter të ndryshëm brenda kompleksit të vakëfit, donacione financiare për ndërtimin e objekteve me karakter shoqëror, si: spitale, barnatore, hamame, çezma, bunare etj.

DOBIA GJITHËPËRFSHIRËSE E VAKËFIT

Feja islame si një fe qiellore, e shpallur nga ana e Allahut (xh.sh.), nuk ka për qëllim që sigurinë dhe lumturinë që dhuron ta reflektojë vetëm brenda ithtarëve të saj, por pa hezituar kjo kulturë e gjerë dhe hiperaktive dëshiron të shtrijë energjinë pozitive tek i gjithë njerëzimi.

Deviza e sistemit të vakëfit është shumë e njohur: “Për hir të Zotit në të mirë të njerëzimit.”

Ka qenë deviza, e cila ka prekur çdo individ, pa marrë parasysh komunitetin nacional dhe fetar.

Sistemi i vakëfit si formë ekonomike dhe kategori sociale në vete, përmbante edhe interes të përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik.

Ato kishin një rëndësi më të gjerë shoqërore dhe me kalimin e kohës u formuan apo ndërtuan edhe objekte të tjera me interes shoqëror, si çezma, kanale, puse, mullinj, hamame –banja publike, ura, rrugë, bezistane, hane, sahatkulla etj.

Prandaj mund të themi se edhe jomyslimanët i kanë shfrytëzuar këto objekte të përgjithshme.

Vakëfet, në kuadër të llojeve të ndryshme që janë, ishin të formuar për shkak të nevojave të ndryshme jetësore, më së shumti për rregullimin e nevojave të ndryshme jetësore, në veçanti për rregullimin e nevojave fetare të popullsisë myslimane.

Përveç kësaj, vakëfet ishin të ndërtuara gjithashtu edhe për përmbushjen e nevojave sociale dhe nevojave tjera dhe njëkohësisht, për zbutjen e kundërthënies mes të pasurve dhe rajës së varfër përmes ndërtimit dhe më vonë, vakëfimit të bujtinave publike, kuzhinave për udhëtarë dhe tregtarë, në të cilat lirisht mund të pranoheshin pa pagesa.

Nuk ishin të rralla rastet kur vakëfet shfrytëzoheshin për ndërtimin e objekteve ekonomike, siç ishin imaretet,

hanet, hamamet, tregjet dhe qendrat tregtare, zejtare dhe dyqanet.

SISTEMMI I VAKËFIT NË DOBI TË VENDIT

Vakëfi është prona jonë e përbashkët, ku të gjithë e kemi të drejtën e barabartë ta duam dhe t'i takojmë asaj.

Por edhe kemi detyrime që të silllemi me përgjegjësi dhe respekt ndaj saj.

Vakëfi nuk është pronë e individëve, grupeve, por e të gjithë atyre që kanë jetuar dhe do të jetojnë në të ardhmen në këtë vend.

Zhvillimi i Vakëfit është proces dhe angazhim shumëdimensional.

Autoritetet e BFIM në mënyrë konstante kanë dëshmuar që mund të drejtojnë në kohën e duhur vakëfin e mbytur, të goditur dhe të linçuar nga instancat gjyqësore dhe institucione të ndryshme të shtetit.

Të gjitha këta veprime dhe angazhime që i mban mbi supë BFI në R.M., sigurisht se janë edhe obligime të buxhetit të Shtetit në R.M., sepse këta njerëz janë taksapagues të rregullt dhe remitenca e tyre kalon një e gjysmë miliard euro.

Me të gjitha këto aktivitete që BFI i përqaset funksionimit të fesë në R.M., de fakto kursen aparatit shtetëror, si në aspektin politik, po gjithashtu edhe nga aspekti financiar dhe ekonomik.

Të paktën shteti duhet të dalë me një mirënjohje ndaj BFI-së e jo më të pengojë vazhdimisht atë në projektet humane dhe arsimore.

Dhe ne jemi të vendosur të vazhdojmë të punojmë me intensitet të njëjtë, për ta bërë Vakëfin një vend të ndërtuar konform standardeve të harmonisë urbane dhe bukurisë arkitektonike të pastër, të gjelbër, dhe atraktiv për vizitorët.

Vakëfi mbetet nderimi i historisë sonë kombëtare dhe fetare dhe prezenca e gjallë e identitetit.

Prezenca dhe ekzistenca e Vakëfit i bëri nder të madh historisë dhe vendit tonë.

Vlera dhe çmimi i Vakëfit është konstituim i identitetit dhe i vlerave ekonomike në mesin e qytetarëve.

Sistemi i vakëfit (Arabti Baba Teqe dhe Xhamia e Pashës në Tetovë), është bastioni i multietnicitetit dhe multikulturalizmit në qytet dhe për këtë arsye, kjo pjesë e qytetit duhet të marrë vendin e merituar në vetëdijen e çdo qytetari dhe e njëjta të pasqyrojë të kaluarën dhe traditën e këtij lokaliteti të vlefshëm për trashëgiminë kulturore.

Kërkimi i pozitës së Vakëfit në gjendjen e lakmueshme vërteton për një shoqëri me vizion dhe përparim të

gjithanshëm.

Kthimi në funksion të mëparshëm rentabël të sistemit të vakëfit do të mundësojë integrimin me popujt e gjithë botës.

Kjo gjendje e tanishme e vakëfit tregon se ne akoma nuk kemi kuptuar rolin e vakëfit në sferat e ndryshme ekonomike dhe në afrimin e bashkëpunimit ekonomik me vendet e Azisë dhe Afrikës.

Një gjë që shumë shtetete perëndimore investojnë në këtë drejtim.

Sistemi i vakëfit dhe roli i tij në segmentet e bashkëjetesës nuk është model muzeal.

Të vendosësh sistemin e vakëfit të perceptohet si model muzeal, sigurisht se është një metodë e veprimit që nuk përkon saktësinë e zhvillimit ekonomik dhe social në sfera rehabilitimi.

Kjo sigurisht se nuk shkon në favor të demokratizimit dhe integritetit të vendit.

Logjika dhe truri i vakëfit konstaton se i gjithë ky obstrukcion ndaj vëkëfit është arritja e përçarjes mes strukturave profane dhe sakrale në vend.

Dhe kjo sigurisht se elektoratin tonë do ta dërgojë në eksplorime të pakufishme dhe investime ekstreme të padobishme për kulturën tone, të cilës i nevojitet bashkëpunimi e jo përçarja.

Të izoluar..... sa më afër njëri- tjetrit, aq më pranë Zotit.

Nganjëherë është shumë sfiduese çështja e vakëfit në lidhje me transparencën.

Ndër kompetencat e vakëfit është shumë me rëndësi që besimtarët të gjejnë shërbim cilësor, fetar dhe vakëfor.

Sistemi i Vakëfit, qoftë i vogël ose i madh, qoftë me vlerë ose pa vlerë, për momentin i plotëson ose nuk i plotëson kriteret e kontributit sporadik për nevojat e xhematit, ai nga ekspertët e juristëve të fesë islame, çdo herë ka vlerë dhe duhet ruajtur në parim.

Qëllimi i vakëfit ka qenë dhe do të mbetet jo vetëm në rolin e faktografimit të pronës së Vakëfit, por njëherë edhe të krijojë fonde të reja të vakëfit në vend për ruajtjen e vetëdijes myslimane dhe më gjerë.

Andaj çdo interes parcial, fragmentar i vakëfit në asnjë moment nuk duhet t'i lëndojë interesat e vakëfit në suaza globale dhe të përgjithshme.

Angazhimi i BFIM ka qenë dhe do të mbetet që me çdo kusht të ruajmë shenjtërinë dhe paprekshmërinë e vakëfit në psikologjinë e besimtarëve myslimanë, sepse përmes tij ndërtohet dhe ruhet identiteti ynë në këto trojet tona stërgjyshore.

MREKULLITË E Kuranit

SHPËTIMI I TRUPIT TË FARAONIT

Ishte vullneti i Zotit xh.sh. që Faraoni të mbytej e më pas trupi tij të nxirrej nga thellësitë e detit, për të qenë një dukuri e cila do të çorodiste shkencëtarët bashkëkohorë. Kjo, sepse trupi i Faraonit vazhdon të jetë ashtu siç ka qenë. Shkencëtarët që patën shansin të bëjnë autopsinë e kufomës së tij janë habitur shumë nga fakti se si trupi tij ka dalë në sipërfaqe nga thellësitë e detit pasi ishte mbytur prej shekujsh dhe arriti në ditët tona. Për këtë gjë flet Kurani në një ajet madhështor, kur Zoti xh.sh. thotë: **“Sot po të shpëtojmë ty (po të nxjerrim prej detit) me trupin tënd (të vdekur), që të shërbesh si argument për ata që vijnë pas teje. Vërtet, ekziston një shumicë njerëzish që nuk hulumtojnë argumentet Tona.”** (Junus, 92) Pyetja që ngrihet natyrshëm në këtë pjesë është: Kush e lajmëroi Profetin tonë a.s. për këtë fakt metafizik? Pa dyshim se Ai që e bëri këtë është Allahu xh.sh.



MILINGONA LËSHON VALË ZANORE

Një grup shkencëtarësh vendosën në foletë e milingonave amplifikatorë zëri shumë të vegjël për të përcjellë tingujt që lëshon mbretëresha milingonë, sepse këto tinguj stimulojnë vëmendjen dhe përqendrimin e milingonave të tjera. Ata zbuluan se milingonat i ndërprisnin lëvizjet e tyre sapo dëgjonin tingujt e lëshuara nga mbretëresha. Këtë gjë ato e bënin duke ngritur lart antenat e ndijimit, duke pritur për orë të tëra pa bërë as më të voglën lëvizje dhe nëse ndodhte që dikush apo diçka i afrohej folesë, ato e sulmonin me shpejtësi. Shkencëtarët pohojnë se milingona ka më shumë njësi nga sa mendohej më parë. Tingujt e ndryshëm brenda një kolonie të vetme mund të provokojnë reagime të ndryshme dhe për këtë Allahu xh.sh. thotë: **“Kur arritën në Luginën e Milingonave, një milingonë tha: “O milingona, hyni në banesat tuaja, që të mos ju shkelë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju parë!”** (Neml, 18)



"Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete."

(Rad, 11)

Kurani është mesazhi i fundit dërguar njerëzimit. Në sajë të Islamit u krijua qytetërimi më i rëndësishëm i historisë njerëzore. Myslimanët numëruan arritje të mëdha në fushat e shkencës, kulturës dhe artit. Rigjallëruan filozofinë duke kontribuar fort në rilindjen evropiane. U bënë shembull në moral dhe etikë. Për shekuj me radhë ruajtën drejtësinë.

Myslimanët asnjëherë në historinë e tyre nuk janë kolonizuar si në periudhën e fundit. Ata gjatë gjithë historisë jetuan të pavarur dhe të lirë, kurse sot janë mundur nga kultura materialiste perëndimore. E gjitha kjo ka ndodhur në dy shekujt e fundit. Dy shekujt e fundit kanë qenë të mbushur me hidhërim vuajtje, lot dhe gjak për botën islame.

Gjendja jonë ndryshoi, sepse ne ndryshuam thelbin, mendimin dhe ndjenjat tona. Në këtë mënyrë, u alienuam me vlerat tona, pësuam copëtim të personalitetit dhe mendimit. Nderin, krenarinë dhe shpëtimin e kërkuam larg vetes sonë.

Si pasojë e këtyre ndryshimeve ndryshoi edhe qëndrimi hyjnor ndaj nesh. Dërdhja e mirësive hyjnore pësoi ndërprerje. Sepse siç e thekson ajeti kuranor, ai që bën një jetë larg Allahut, është i destinuar të bëjë një jetë të vështirë, në mjerim dhe me vuajtje.

Njerëzit përballë fatkeqësive përpiqen të gjejnë shkaqet e tyre, dikush e kërkon shkakun te qeverisja, dikush tjetër tek armiqët, dikush tjetër përpiket t'i shpjegojë përmes teorive konspirative. Ka dhe prej tyre që i dorëzohen historisë me pretendimin se të gjitha këto janë shenjat e fundit të kiametit. Në këtë mënyrë, burimin e gjendjes së tyre shoqërore e shikojnë në vende të gabuara.

Kjo gjendja jonë e plogësht vjen sepse ne nuk e kemi rrënjësuar si duhet Tevhidin në zemër, në mendje dhe ndjenja. Duke qenë kështu, ne nuk mund të bëhemi një shoqëri që garon për mirësi.

Së pari, duhet të ndryshojmë ndjenjat, mendimet dhe idealet. Sepse nuk mund të ndërtohet një shoqëri e mëshirshme, individët e së cilës i kanë të hapura dyert e të keqes. Nëse nuk është e përshtatshme bota e brendshme, nuk mund të krijohet bota e jashtme.

Disiplina e brendshme shpirtërore është një parim i rëndësishëm në rrugën drejt përparimit dhe zhvillimit shoqëror. Shoqëritë që kanë arritur disiplinën e brendshme janë ngritur dhe zhvilluar. Njeriu dhe shoqëria që nuk kontrollon botën e brendshme nuk mund të kontrollojë botën e jashtme.

Pejgamberi -salall-llahu alejhi ve selem-, ka thënë:

"Kush fal namazin e sabahut është nën mbrojtjen e Allahut."

(Muslim, Mesaxhid, 262)

Treguesi më i qartë i lidhjes së besimtarit me Allahun është namazi. Namazi është një dhuratë qiellore për besimtarët. Ata që e falin siç duhet dhe në kohën e duhur, i pret shpërblimi i paçmuar. Namazi është prej cilësive të besimtarëve të cilët janë të shpëtuar. Midis namazëve, namazi i sabahut është namazi më i vështirë në realizim. Namazi i sabahut, i cili është edhe detyra e parë e ditës shpesh neglizhohet.

Nga hadithi i mësipërm kuptojmë se kryerja e këtij namazi na siguron mbrojtjen e Allahut në këtë botë dhe botën tjetër. Përdërisa njeriu nuk e braktis namazin, marrëveshjes midis tij dhe Allahut nuk i vjen asnjë rrezik.

Të zgjohesh në mëngjes herët kur intensiteti i gjumit është më i larti, për t'iu përgjigjur thirrjes së Allahut, nuk është krejt e thjeshtë. Kur njeriu dëgjon frazën: "Namazi është më i mirë se gjumi" të ezanit të sabahut, mendon me vete të flejë edhe pesë minuta, edhe pesë minuta të tjera deri sa sytë i hapen së bashku me lindjen e diellit. Megjithëse mund të pendohet për neglizhencën, ai namaz nuk mund të rikthehet.

Namazi i sabahut është prova dhe adhurimi i parë i besimtarit. Besimtari duhet

të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të luftuar këtë neglizhencë. Sepse namazi më i vështirë për munafikët është namazi i sabahut dhe jacisë. Namazi i sabahut është një tregues shumë i rëndësishëm i besimit dhe sinqeritetit. Prandaj Profeti (a.s.), e ka konsideruar namazin si pikë ndarëse midis besimit dhe mosbesimit.

Vlera e sabahut të namazit është e paçmuar, namazi i sabahut është aq i vlefshëm, sa ë vetëm dy rekatet sunet të tij janë më të vlefshëm se gjithë bota dhe pasuria e saj.

Qetësinë që të jep ndjesia se ke kryer namazin e sabahut dhe je përfshirë nën mbrojtjen e Allahut është diçka krejt e veçantë. Namazi i sabahut është mënyra më e mirë për të falënderuar Allahun për mirësitë e shumta që na ka dhënë në këtë botë dhe një ndihmesë e madhe për të fituar xhenetin në botën tjetër.

Namazi i sabahut është një mundësi e jashtëzakonshme për besimtarin për të fituar sigurinë dhe mbrojtjen e Allahut. Vetë përpjekja për të kryer namazin e sabahut është një formë adhurimi. Falja e një namazi të tillë e bën shumë të lehtë fitimin e xhenetit.

Mjë Hadith

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Rëndësia dhe vlera e madhe e namazit të sabahut;
2. Siguria dhe mbrojtja hyjnore që përfitojmë nga kryerja e namazit të sabahut.



SIGURIA DHE QETËSIA

Në krye të nevojave të njeriut në këtë botë vijnë siguria dhe qetësia. Njeriu ka nevojë të mbrohet nga çdo lloj padrejtësie dhe me të drejtat që zotëron të gjejë lumturinë, me të cilën do të garantojë të ardhmen e tij në këtë botë dhe në botën tjetër. Njeriu, i cili nuk ndihet i sigurt në vendin ku jeton, nuk mund t'ua shohë kurrë fytyrën as qetësisë e as rehatisë. Dhe fuqia më madhe që mund ta garantojë këtë siguri, janë parimet hyjnore që ka vendosur Allahu i Madhëruar, pra Islami. Allahu, në lidhje me këtë fakt shprehet:

“Për të mbrojtur (fisin) kurejshët, për t’i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes), i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.”
(Kurejsh, 1-4)

Sistemet dhe ligjet njerëzore janë shumë larg nga garantimi i kësaj sigurie dhe qetësie, sepse ato nuk kanë asnjë anë shpirtërore. Para se të vinte Islami, bota ishte mbështjellë nga një errësi e thellë injorance. E drejta i takonte të fortit. I dobëti nuk kishte asnjë të drejtë; e drejta e tij ishte të qëndronte i shtypur. Njerëzit rënkonin dhe shtypeshin nën një tirani, e cila është e pamundur të përshkruhet. Poeti i madh Mehmed Akif Ersoj, në lidhje me këtë gjendje shprehet:

I dobëti, e drejta e të cilit ishte të shtypej, u ringjall;

Tirania, zhdukja e së cilës as që mendohej, ngordhi!

Në një periudhë të tillë, Allahu i Madhëruar i fali fisit Kurejsh një mirësi hyjnore. Ndërsa ata, në sajë të kësaj sigurie, zhvilluan veprimtaritë e tyre politike, tregtare e kulturore duke arritur rehatinë dhe pasuri të mëdha materiale e shpirtërore. Kur erdhi koha e duhur, Zoti ynë i Madhëruar nxori prej këtij fisi pejgamberin e fundit, në sajë të të cilit i mësoi njerëzimit parimet më të shëndetshme të paqes, lumturisë dhe sigurisë.

ISLAMI ËSHTË BURIMI I QETËSISË DHE PAQES NË BOTË

Kuptimi i fjalës “Islam”, është shpëtim, paqe, qetësi, siguri, dorëzim dhe rehati. Dhe kjo tregon se feja islame, me të gjitha anët e saj, i fal të gjithë botës shpëtim dhe qetësi. Pra, Islami nuk u sjell shpëtim dhe qetësi vetëm njerëzve, por edhe kafshëve, bimëve, e madje edhe krijesave jo të gjalla. Vetë Pejgamberi (a.s.), gjatë gjithë jetës së tij pejgamberike prej 23 vjetësh, ka luftuar me çdo lloj të terrorit dhe në fund i dorëzoi botës fenë e vërtetë, që është burimi i paqes dhe sigurisë së përjetshme.

Islami e shpëton njeriun nga çdo lloj tiranie, padrejtësie dhe çdo lloj gjëje e keqe. Dijetarët islamë shprehen se synimi i fesë, është vendosja dhe mbrojtja e këtyre pesë parimeve themelore, të cilat njihen edhe si **“darurat-i dinijje”**:

- a) Mbrojtja e fesë,
- b) Mbrojtja e jetës,



- c) Mbrojtja e mendjes,
- ç) Mbrojtja e nderit dhe vlerave, për rrjedhojë mbrojtja e brezave,
- d) Mbrojtja e pasurisë.

Nëse mbrohen këto pesë parime, njeriu arrin paqen dhe sigurinë e plotë.

Islami, në lidhje me mbrojtjen e secilit prej këtyre parimeve, ka vendosur rregulla të forta dhe ka caktuar haramet/të ndaluara dhe hallat/të lejuara. Studimin më të hollësishëm të gjykimeve në lidhje me këto çështje, e bën "muamelati/kodi i të drejtave civile", që është një nga degët e jurisprudencës islame.

Para ardhjes së Islamit, njerëzimi, nga ana e besimit, adhurimit, të drejtave civile dhe jetës së përditshme, ishte për të ardhur keq. Siç nuk kishte siguri për jetën, pasurinë dhe nderin, nuk kishte as edhe një besim, adhurim dhe moral që mund ta ngrinte njeriun. Njerëzit adhuronin idhujt që i bënin prej hurmave dhe i hanin ato kur i merrte uria. I urdhëronin skllëverit e tyre të bënin idhujt prej druri e prej guri, pastaj prisnin ndihmë prej tyre. Kur pushonin në ndonjë vend gjatë udhëtimit, merrnin katër gurë, tre prej tyre i vinin si vatër zjarri poshtë tenxheres, njërin e bënin zot dhe e adhuronin.

Në lidhje me këtë fakt, Ebu Rexha Utaridi, thotë:

"Ne adhuronim një gur. Kur gjenim një gur tjetër më të bukur, e hidhnim atë që kishim dhe merrnim tjetrin. Kur nuk gjenim dot gur, bënim një kapule me dhé, mbi të cilën milnim një dele, pastaj bënim tavaf rreth saj."

(Buhari, Megazi, 70.)

Islami i abrogoi të gjitha këto besime të gabuara, të cilat përdhosnin vlerat njerëzore dhe solli një besim të lartë, adhurime dhe vlera morale të cilat e lartësojnë nderin dhe vlerën e njeriut. Islami e organizoi çdo fushë të jetës njerëzore në mënyrën më të bukur. Myslimanët, të cilët shijuan ndjenjat e larta që u fali Islami, u përpoqën me shumë sakrificë që edhe njerëzit e tjerë të

përfitonin nga kjo mirësi kaq e madhe. Ja disa shembuj të bukur në lidhje me këtë fakt:

Ebu Talha dëshironte shumë të martohet me **Ummu Sulejmen** (r.a.), e cila e kishite pranuar më parë Islamin. Mirëpo, Ummu Sulejme (r.a.), i vuri kusht që të braktiste idhujt dhe të hynte në Islam, duke u shprehur kështu:

"Mendo pak mbi këta gurë që i adhuron! Ata nuk mund të sjellin as dobi dhe as dëm! Po ashtu, mendo edhe për idhujt që keni bërë prej druri! Ju vjen marangozi, i cili e pret dhe e gdhend pemën, ndërsa ju e adhuron atë si zot. Nëse e hidhni në zjarr, do të digjet e do të bëhet shkumb e hi. A nuk ju vjen turp të adhuronit drurët që mbijnë nga toka dhe

gdhenden nga një skllav etiopas? Nëse thua shehadetin! dhe ndjek Pejgamberin tonë, do të martohem me ty pa kërkuar asgjë prej teje!"

Pasi i dëgjoi shumë herë këto fjalë, më në fund Ebu Talha pranoi dhe u nderua me besimin islam. Ummu



Kuptimi i fjalës "Islam", është shpëtim, paqe, qetësi, siguri, dorëzim dhe rehati. Dhe kjo tregon se feja islame, me të gjitha anët e saj, i fal të gjithë botës shpëtim dhe qetësi.

Pra, Islami nuk u sjell shpëtim dhe qetësi vetëm njerëzve, por edhe kafshëve, bimëve, e madje edhe krijesave jo të gjalla.



1. - Shehadet: Deklarata Islame: "Esh'hedu en La ilahe il-lall-llah ue esh'hedu enne Muhammeden abduhu ue Rasuluhu / Dëshmoj se përveç Allahut nuk ka zot tjetër dhe se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij".

Sulejme (r.a.), u gëzua shumë nga kjo dhe, megjithëse kishte mundësinë të merrte sa të donte prej pasurisë së tij, u martua me Ebu Talhan duke marrë si mehri të martesës vetëm thënien e shehadetit. Pra, mehri i saj u bë **“Islami”**.²

Pejgamberi (a.s.), në lidhje me parimin i cili do t'i garantojë të gjithë njerëzimit sigurinë dhe qetësinë, është shprehur në mënyrë shumë të qartë:

“Askush prej jush s'ka për të besuar në kuptimin e vërtetë të fjalës, pa dëshiruar për vëllain e vet mysliman atë që dëshiron për veten.” (Buhari, Iman, 7; Muslim, Iman 71-72.)

Nëse njerëzit e zbatojnë altruizmin që urdhërohet në këtë hadith fisnik, problemet shoqërore do të ulen në minimum dhe padrejtësitë do të marrin fund.

ISLAMI ËSHTË FEJA E SË VËRTETËS DHE DREJTËSISË

Ky urdhër i Allahut të Madhëruar garanton shërimin ndaj burimit më të madh të shqetësimeve të njerëzve:

“Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht! Dhe mos jepni ryshfet te gjykatësit për të marrë në mënyrë të paligjshme dhe me vetëdije një pjesë të mallit (pasurisë) të njerëzve.” (Bekare, 188.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), i pyet shokët e vet:

“A e dini se kush është i falimentuar?” Ata u përgjigjën:

“Sipas nesh, i falimentuar është ai që nuk ka para dhe mall.” Por i Dërguari i Allahu (a.s.), tha:

“S'ka dyshim, se të falimentuarit e umetit³ janë ata që në Ditën e Kiametit do të vijnë me sevapet përkatëse të adhurimeve, si namazi, agjërimi, zekati etj., por, për shkak se këtë e ka sharë, për atë ka shpifur për imoralitet, këtij i ka ngrënë mallin padrejtësisht, atij tjetrit i ka derdhur gjakun dhe një tjetër e ka rrahur, të gjitha sevapet e mirësive të tij u kalojnë këtyre. Nëse

sevapet i mbarojnë pa larë hakun e atyre që u ka bërë padrejtësi, gjynahet e atyre që kanë për të marrë hak, do t'i ngarkohen këtij dhe si përfundim ai do të hidhet në xhehenem.” (Muslim, Birr 59; Tirmidhi, Kijamet 2; Ahmed, II, 303, 324, 372.)

Një njeri që i dorëzohet Islamit me gjithë zemër, duke i mbajtur gjithmonë në mendje këto ajete dhe hadithe fisnike, sigurisht që nuk mund të mendojë aspak t'i bëjë keq ndokujt.

Botëkuptimi i **“drejtësisë”** që solli Islami, qëndron mbi çdo lloj imagjinate. Një shembull në lidhje me këtë fakt është edhe ky:

Gjatë betejës së Bedrit, para se të fillonte lufta, Resulullahu (a.s.), me shigjetën që mbante në dorë, i vinte në rresht dhe i numëronte luftëtarët me urdhrat, si *“Bëj para, bëj mbropa”*. Në këtë moment, prek barkun e **Seuad bin Gazijes**

(r.a.), i cili kishte dalë pak para rreshtit dhe i thotë:

“O Seuad! Vihu në rresht!”

Kurse Seuadi (r.a.), tha:

“O Rasullallah, më vrave! Allahu të ka dërguar me të vërtetën, prandaj kërkoj të marr hak!” Pas kësaj, Pejgamberi ynë (a.s.), hapi këmishën dhe tha:

“Eja merr hak!” Disa prej Ensarëve⁴ u shqetësuan dhe duke dashur ta sillnin në vete Seuadin, thanë:

“O Seuad! Ky është i Dërguari i Allahut!”

Seuadi tha:

“Para drejtësisë, asnjë njeri nuk është më i lartë se një njeri tjetër!” I Dërguari i Allahut (a.s.), tha përsëri:

“Eja merr hak!” Por Seuadi (r.a.), e puthi barkun e bekuar të Pejgamberit (a.s.), i cili tha:

“O Seuad! Përse e bërë këtë?” Seuadi (r.a.), u përgjigj:

“Siç e shihni, jemi përgatitur për të luftuar. Unë dëshirova që momenti im i fundit të jetë ky që po të prek ty!”

2. - Shih. Nesai, Nikah, 63/3340-1; Ibn-i Sa'd, Tabakat, VIII, 426-427; Ibnul-Esir; Usdu'l-gabe, VII, 333.

3. Umet: Popull

4. - Ensar (Ndihmës): Janë quajtur banorët e qytetit të Medinës që pritën emigrantët/muhaxhirët, të cilët erdhën së bashku me Pejgamberin (a.s.), nga Meka dhe u vendosën në Medinë.

Pas kësaj, Rasulallahu (a.s.), u lut për të.⁵

Pejgamberi (a.s.), i cili gjatë gjithë jetës së tij ka treguar një kujdes të jashtëzakonshëm ndaj të drejtave të të gjitha krijesave. Edhe në momentet e fundit të jetës nuk harroi këtë çështje dhe madje, megjithëse ishte i pafuqishëm, doli në minber dhe tha:

*"Shokët e mi! Nëse kam marrë pa dashje mallin e ndonjërit prej jush, ja ku është malli im, le të vijë e ta marrë!.. Nëse i kam rënë dikujt në kurriz (padashje), ja ku është kurrizi im, le të vijë e të më bjerë!.."*⁶

ISLAMI ËSHTË FE E DELIKATESËS DHE MIRËSJELLJES

Islami i mëson myslimanët të jetojnë duke menduar Ditën e Llogarisë dhe të mos i përdhosin të drejtat e të tjerëve. Rasulallahu (a.s.), myslimanin e devotshëm e ka përkufizuar me këto fjalë:

"Mysliman, është ai, prej gjuhës dhe dorës së të cililit nuk dëmtohet askush..." (Buhari, Iman, 4-5.)

Me të vërtetë që një mysliman, gjatë gjithë edukimit islam dhe adhurimeve, mëson të jetë "i padëmshëm". Në fund, arrin një gjendje të tillë, saqë askush nuk mendon se prej tij mund të vijë ndonjë dëm. Një besimtar i tillë, ngjall gjithmonë qetësi dhe siguri përreth vetes.

I Dërguari i Allahu (a.s.), ka thënë:

*"Besimtari i ngjan bletës. Bleta ha gjithmonë gjëra të pastra, bën gjëra të pastra, qëndron në vende të pastra dhe, për shkak se kur ulet në ndonjë vend vepron me delikatesë, ajo nuk dëmton, nuk thyen e nuk prish asgjë. Ndërsa kur rrëzohet, nuk thyhet e nuk dëmtohet!"*⁷

Bleta është një krijesë jashtëzakonisht e aftë, specialiste, e zgjuar, e dobishme dhe modeste. Madje, ajo punon edhe natën. E mbledh ushqim e saj prej luleve dhe

ha gjithmonë gjëra të pastra. Ajo është e bindur ndaj prijesve të saj dhe dëmet e saj janë jashtëzakonisht minimale. Qëndron larg gjërave të pista dhe nuk e ha djersën e tjetrit.

Edhe besimtari, ashtu si bleta, e fiton pasurinë në mënyrë hallall, ha ushqime hallall dhe qëndron në vende të pastra nga gjynahet. Kudo që ndodhet, shpërndan mëshirë prej shpirtit të tij. Nuk cenon askënd dhe nuk cenohet prej askujt. Kur bën ndonjë gabim, e kupton menjëherë atë, e korrigjon veten dhe gjithmonë e ruan dinjitetin dhe maturinë. Ai është modest dhe punon gjithmonë për të mirën e të gjithëve. Po ashtu, ai qëndron larg shkujdesjes, ngatërresave, haramëve dhe dëshirave të ulëta të egos.

Një shoqëri, individët e së cilës janë si bleta, padyshim që mund të arrijë nivelin më të lartë të paqes dhe sigurisë.

Resulullahu (a.s.), këtë e ka deklaruar që në vitet e para të Islamit:

Habbab bin Eret (r.a.), tregon:

Një ditë, shkuam pranë Rasulallahut (a.s.). Ai kishte vendosur rrobën e tij poshtë kokës si jashtëk dhe po pushonte nën hijen e Qabes. Duke iu ankuar prej torturave që na bënë idhujtarët, thamë:

"A nuk do të kërkoni ndihmë për ne? A nuk do t'i luteni Allahut për ne?"

Rasulullahu (a.s.), u mërzit paksa dhe me fytyrë të skuqur u ngrit dhe tha:

*"Në popujt e mëparshëm, një besimtar ka-
pej dhe futej në një gropë. Pastaj ia ndanin kokën
më dysh me sharrë dhe ia krihnin mishin dhe kockën me
krehër hekuri. Por të gjitha këto nuk mundën ta kthejnë
atë nga feja e vet. Beto hem se Allahu patjetër do ta bëjë
mbizotëruese këtë fe. Aqsa një kalorës i vetmuar do të
udhëtojë nga San'a deri në Hadramaut⁸ pa asnjë shqet-
ësim e frikë tjetër përveç Allahut dhe sulmit të ndonjë
ujku ndaj kopesë (bagëtime) së tij. Por ju po nxitoheni
(jeni të padurueshëm)!"* (Buhari, Menakib, 25, Isti'zan 35,
Menakibu'l Ensar 29; Ebu Daud, Xhihad, 97/2649.)

Njëherë tjetër, Resulullahu (a.s.), i thotë Adij bin Ha-



5. - Ibn-i Hisham, II, 266-267; Uakidi, I, 57; Ibn-i Sa'd, III, 516; Ebu Daud, Edeb, 148-149/5224; Dijat, 14/4536.

6. - Shih. Ibn-i Sa'd, II, 255; Taberi, Tarih, III, 190 Ahmed, III, 400.

7. Shih. Ahmed, II, 199; Hakim, I, 147; Bejhaki, Shuab, V, 58; Sujuti, Xhami, no: 8147.

8. San'a dhe Hadramaut: Dy vende që ndodhen në Jemen

timit, i cili ngurronte të bëhej mysliman:

"Unë e di shkakun që të pengon të hysh në Islam. Ti mendon se: "Atë (Islamin) e ndjekin vetëm të dobëtit dhe të pafuqishmit, të cilët arabët i shohin si të pavlerë. A e di Hiren?" Ai u përgjigj:

"Nuk e kam parë, por e kam dëgjuar." I Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

"Betohem në Allahun, i Cili mban në dorë shpirtin tim, se Allahu do ta plotësojë këtë çështje! Aq sa një grua do të vijë e vetme prej Hires dhe do të bëjë tavaf shtëpinë e Allahut. Pastaj do të hapen thesaret e Kisra bin Hurmuzit!" Adij bin Hatimi i habitur pyeti:

"Të Kisra bin Hurmuzit?" Ndërsa Pejgamberi (a.s.), tha:

"Po të Kisra bin Hurmuzit!" Pastaj vazhdoi duke thënë:

"S'ka për të kaluar shumë dhe pasuria do të shtohet aq shumë, saqë askush nuk do ta prekë me dorë dhe nuk do të gjendet dikush që do të pranojë zekatin e pasurisë!"

Më vonë, kur Adij bin Hatimi (r.a.), e tregoi këtë ndodhi, tha:

"Vallahi, unë kam parë një grua që erdhi e vetme nga Hira mbi devenë e saj pa u frikësuar nga asgjë dhe bëri haxh në Shtëpinë e Zotit! Vallahi edhe unë kam qenë bashkë me ata që kanë hapur thesaret e Kisras. Betohem në Allahun, i Cili ka në dorë shpirtin tim, se edhe e treta do të realizohet, sepse atë e ka thënë Resulullahu (a.s.):"⁹

Po, synimi i Islamit është të garantojë që njerëzit të jetojnë në një vend të qetë, ku të mos kenë frikë prej tjetërkujt përveç Allahut. Si rezultat i kësaj, vjen edhe mirëqenia materiale. Në periudhën e Khalifit Omer bin Abdulazizit, për shkak se myslimanët nuk po gjenin të varfër për t'i dhënë zekatin, shkuan tek Khalifi dhe e pyetën se çfarë të bënin me zekatin.¹⁰

ISLAMI ËSHTË FE E TOLERANCËS

Pejgamberi (a.s.), shumë njerëzve u ka dhënë "eman"-e¹¹ me shkrim. Prof. Dr. Muhammed Hamidullah, në veprën e tij të quajtur *"Letrat diplomatike të Pejgamberit"*, shprehet se në vende të ndryshme, ka parë shumë kopje të "emanname"-ve, që i përkisnin Pejgamberit tonë (a.s.). Një nga këto, ka edhe një ndodhi shumë të bukur:

Kur u çlirua Stambolli, nga mbretëritë përreth vinin delegacione për të urrear. Midis tyre, ishte edhe Patriarku Ortodoks i Kudsit (Jeruzalemit) Athanasios, i cili kur doli përpara Sulltan Fatihut, i tregon atij emannamen që kishte firmosur Pejgamberi ynë (a.s.), me gishtin e tij dhe disa dorëshkrime të shkruara me shkrim "kufi"¹²,

që kishin ngelur që nga koha e Omerit (r.a.).

Pas kësaj, i kërkon që vendet e adhurimit që ndodheshin në Kuds, të qëndronin ashtu siç kishin qenë më parë. Sulltan **Fati**

tihu aprovon po ato të drejtat që u kishte dhënë Pejgamberi (a.s.) dhe lëshon një ferman me shkrim, në fund të të cilit gjendet një shënim: "E mallkoftë Allahu atë që e anullon këtë urdhër të padishahut!" Sot, ky ferman gjendet në Arkivin Osman të Kryeministritisë, i regjistruar si "Kilise Defteri, no: 8"¹³.

Në sajë të parimeve islame, shoqëria myslimane kishte arritur një nivel të tillë, saqë edhe komunitetet e tjera që jetonin në administrimin e saj, qoftë të krishterët e qoftë hebrenjtë, jetonin në mirëqenie dhe ishin të kënaqur. Madje, ata nuk e dëshironin aspak administrimin e bashkëfetarëve të tyre dhe në shumë raste i kanë ftuar vetë myslimanët në vendet e tyre.

Bernard Lewis thotë:

"Osmanët i magjepsnin të krishterët. Toleranca osmane dhe mundësitë që njihte shteti i tyre, kishte tërhequr aty shumë njerëz që kërkonin të arrinin qetësinë. Fshatarët e shtypur shpresonin ndihmë prej armiqve të të zotëve të tyre. Madje, vetë **Lutheri**, në një vepër të

9. Shih. Buhari, Menakib, 25; Ahmed, IV, 257, 377-379; Ibn-i Hisham, IV, 246; Inb-i Kethir, Bidaje, V, 62.

10. Shih. Bejhaki, Delailu'n-Nubuue, VI, 493; M.S. Ramadan Buti, Fikhu's-sire, fq.434.

11. Eman / Emanname: Një dokument i lëshuar në vendet islame, i cili garanton jetën dhe pasurinë e atij që e posedon.

12. Kufi: Një stil shkrimi me gërma arabe.

13. -Ziya DemirAvni Arslan, Osmanlı'da Peygamber Sevğisi, Ankara 2009, s. 63; www.turkislamtarihi.nl/makaleler/kudus.php

tijën, të cilën e publikoi në 1541-in, i paralajmëron kështu të krishterët: «Në vend që të jetojnë nën administrimin e princërve, feudalëve dhe borgjezëve syngopur si puna juaj, të varfërve mund t'u duket më mirë të jetojnë nën administrimin e turqve...»¹⁴

ISLAMI ËSHTË FE MËSHIRE

Islami është një fe mëshire. Mëshira është një nga parimet më të rëndësishme të fesë islame. Aq sa Allahu i Madhëruar, pranë fjalës "Bismilah", që është edhe kryetitull në Librin e Tij, ka vendosur edhe dy emrat e Tij të bukur, **Rrahman** dhe **Rrahim**, të cilët shprehin mëshirën e Tij të gjerë. Menjëherë më pas, në ajetin e dytë të sures së parë, Fatiha, janë përsëritur të njëjtët emra. Më tutje, emri **Rrahman** është përdorur si fjala e parë e një sureje, e cila ka marrë po të njëjtin emër, Rrahman. Më konkretisht, aty urdhërohet: "**Rrahmani ua mësoi Kur'anin!**", duke shprehur në këtë mënyrë faktin se Kurani Kerim i është ofruar njerëzimit si një mëshirë hyjnore. Gjithashtu, në suren Isra, deklarohet qartë se Kurani është mëshirë dhe shërim. (shih. Isra, 82)

Në të njëjtin kontekst edhe në sure të tjera të Kuranit, butësia dhe mëshira përmenden dhe këshillohen me qindra herë. Nga ana tjetër, një nga virtytet më të larta që Allahu Te-ala i dhuroi Pejgamberit tonë (a.s.), është mëshira. Në mënyrë të veçantë, në sajë të deklaratës hyjnore: "**Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.**" (Enbija, 107.), kjo cilësi e Rasulullahu (a.s.), përbën një nivel aq të lartë, sa askush tjetër nuk mund ta arrijë. Një nga shembujt e mëshirës së tij të pashoqe është edhe ky:

Ndërkohë që në betejën e Bedrit ushtritë kishin dalë përball njëra-tjetrës, Rasulullahu (a.s.), u dërgon idhujtarëve përfaqësues me qëllim për të bërë paqe. Në këtë kohë, në radhët e ushtrisë së armikut filloi kriza për ujë. Një grup prej idhujtarëve, midis të të cilëve ishte edhe Hakim bin Hizami, erdhën për të pirë ujë në pusët

e myslimanëve. Kur myslimanët tentuan t'i pengonin, i Dërguari i Allahu (a.s.), tha:

"*Lërimi të pinë!*" Pastaj ata erdhën e shuan etjen. (Ibn-i Hisham, II, 261)

Pra, mund të themi se në Islam, fryti i parë përbëhet prej mëshirës. Të dashurit e Allahut, të cilët kanë bërë një jetë mbi këto parime, e kanë përkufizuar devotshmërinë me këto dy shprehje të shkurtra:

- a)- Tadhim li-emrillah, të tregosh respekt dhe nënshtrim në zbatimin e urdhrave të Allahut,
- b)- Shefkat ala halkillah, të mëshirosh të gjitha krijesat për hir të Krijuesit.

Islami është një fe mëshire. Ndërkohë që njerëzimi, i cili është rrokullisur në shumë gropa të gjynaheve dhe të shkuqdesjes, e ka merituar shkatërrimin dhe humbjen për shkak të atyre që ka bërë, Allahu i Madhëruar gjithmonë i ka hapur krahët e mëshirës dhe faljes duke dëshiruar t'i tërheqë robërit e Tij në atmosferën e lumturisë. Kjo deklaratë e Tij e qartë: "**Mëshira ime e tejkaloi zemërimin tim!**"¹⁵, është treguesi më i bukur i kësaj të vërtete.

Mund të themi me bindje se një shoqëri, e cila e jeton Islamin ashtu siç duhet, bëhet shoqëri e paqes dhe qetësisë. Njerëzit që jetojnë aty, ndihen të sigurt edhe në jetën e kësaj bote, por mund të shohin me shpresë edhe jetën e botës tjetër.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"*Atij që është mysliman, i është dhënë furnizim i mjaftueshëm dhe është i kënaqur me mirësitë që i ka falur Allahu, ka arritur shpëtimin (e vërtetë).*" (Muslim, Zekat, 125)


O Zot! Na e bëj të mundur ta kuptojmë Islamin dhe ta zbatojmë atë në mënyrën më të bukur në jetën tonë, me qëllim që të arrijmë shpëtimin në të dyja botët; që nga dora dhe gjuha jonë të mos cenohet asnjë krijesë; të bëjmë një jetë të qetë, pa cenuar askënd dhe pa u cenuar nga askush; dhe që të gjitha gjymtyrët e mirësitë, të cilat na i ke falur, t'i përdorim gjithmonë në rrugë të drejtë!

Amin!..

"Besimtari i ngjan bletës. Bleta ha gjithmonë gjëra të pastra, bën gjëra të pastra, qëndron në vende të pastra dhe, për shkak se kur ulet në ndonjë vend vepron me delikatesë, ajo nuk dëmton, nuk thyen e nuk prish asgjë. Ndërsa kur rrëzohet, nuk thyhet e nuk dëmtohet."

14. -Bernard Lewis, "The War and the Politics", In The Legacy of Islam, botimi i dytë, Oxford 1974, fq. 156-209.

15. Shih. Buhari, Teuhid, 15, 22; Muslim, Teube, 14-16.



Shpjegimi i Dyzet e Dy Thënieve Profetike

Imam Didmar Faja

“Dyzet hadithet” e Imam Neveviut, një vepër e shumëpritur dhe e dashur në mesin e myslimanëve shqiptarë

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Vepra e shquar “Dyzet hadithet” e Shejkul-Islamit, Jahja ibn Sheref, Muhjiddin Ebu Zekerija En-Nevevi (631-676 h.), është një ndër veprat më të shquara që ka gjetur pranim të gjerë në mesin e myslimanëve, në mbarë botën. Vetë interesimi i dijetarëve islamë ndër shekuj për ta shpjeguar dhe komentuar këtë vepër, tregon për rëndësinë që ka ky libër jo i madh në vëllim, por shumë me vlerë në përmbajtje, në jetën tonë.

“Këto dyzet hadithe u shquan gjithandej dhe njerëzit vrapuan t’i mësonin përmendsh. Për hatrin e mirësisë së njetit të mirë të grumbulluesit të tyre, Allahu i dha botës dobi. Dijetarët më të shquar të botës sonë u angazhuan për ta shpjeguar dhe komentuar këtë vepër, saqë sot, numërohen rreth pesëdhjetë komente në gjuhën arabe, disa të botuara dhe disa të tjera të humbura ose akoma

në dorëshkrim!”¹

Në studimin e tyre të komentit të kësaj vepre nga Ibn Haxher Askalani (773-852 h.), studiuesit islamë, Mr. Rijad Isa El-Mensi dhe Abdulkadir Mustafa Taha, teksta flasin për vëmendjen e madhe që dijetarët islamë i kanë dhënë kësaj vepre të Imam Neveviut, rendisin disa prej komenteve dhe shpjegimeve më të afirmuara deri më sot, si: “Sherh el-erbaine hadithen en-Nevevijje”, nga Imam Neveviu (v. 676 h.) – “Et-taajin fi sherh el-erbain”, nga Imam Tufi (v. 710 h.) – “El-menhexhul-mubin fi sherh el-erbain en-Nevevijje”, nga Imam Fakehani (v. 731 h.) – “Et-tebjin fi sherh el-erbain”, nga Imam Ibn Xhemaah (v. 819 h.) – “El-fet’hul-mubin bisherh el-erbain”, nga Imam

1. Dr. Mustafa El-Bugha dhe Muhjiddin Misto, “El-Vafi fi sherh el-erbain en-Nevevijje”, Damask, pa vit botimi, fq. 5.

Ibn Haxher El-Hejtemi (v. 973 h.) – “El-mubinul-muin lifehmil-erbain”, nga Molla Ali El-Herevi Hanefiu (v. 1014 h.) – “Sherhul-erbain en-Nevevijje”, nga Imam Shernubi (v. 1348 h.) etj.²

Fatmirësisht, kjo vepër e dobishme është përkthyer dhe komentuar edhe në gjuhën shqipe. Fillimisht, në duart tona ka mbërritur “Hadithi - Errbeain”³, nga i nderuari, i përndjekuri dhe i sprovuari, Hafiz Ibrahim Dalliu, i cili në vitin 1934, pati mirësinë të botonte këtë vepër të dobishme.

Më pas, në vitin 1986, në Michigan të ShBA, Burhan Al-Din S. Fili, botoi: “Katërdhet hadithe”. Në parathënien e përkthimit të tij, ndër të tjera shënon: “Asht detyrë dhe nder për sejcilin me u përpjekë për të mirën dhe mbarsin se aty asht burimi i knaqsis dhe i prehjes fiziko-shpirtnore”.⁴

Ndërkohë, në vitin 1992, në Shkup, doli në qarkullim libri: “Dyzet hadithe dhe shtojca e Ibni Rexhepit”, i përkthyer nga studiuesi i afirmuar islam i trojeve tona shqiptare, Ef. Nexhat Ibrahimisi.⁵

Këtij angazhimi mund t’i bashkangjitet edhe vepra “150 hadithe” nga Imam Vehbi Ismaili, botuar fillimisht në Michigan të ShBA, në vitin 1990 dhe e ribotuar më pas në vitin 1993 (po aty) dhe së fundi, në vitin 2009, si pjesë përbërëse e kolanës voluminoze (tetë vëllime) të veprave të Imam Vehbi Ismailit, nga Shtëpia botuese LOGOS-A, Shkup.⁶

Mund të përmend në këtë vazhdë, edhe botimin e Myftinisë Shkodër, “111 hadithe të përzgjedhura”, në

format broshure, Shkodër, 2014.⁷

Sot, lexuesi shqipfolës, ka mundësi të ketë në duart e tij një botim dinjitoz me komente dhe shpjegime të dobishme, të nxjerra nga burimet e veta origjinale, nga punëtori i zellshëm dhe kërkuesi i vëmendshëm i dijes së dobishme, Imam Didmar Faja, drejtues i Qendrës së Bashkuar Islame, në Phoenix të Arizonës, SHBA.

Veprën në fjalë e kam lexuar me një frymë. Në rreshtat e saj ka një sekret të madh dashurie dhe madhërimi për të Dërguarin e Allahut, që të tërheq me mirësi, hadith pas hadithi, koment pas komenti, në thellësitë e këtij libri dinjitoz.

Kam vlerësuar shumë, ndërhyrjet me vend të bëra nga autori në komentet e tij të haditheve, sidomos në ato raste, kur ai ka sjellë mendime të ndryshme të dijetarëve të shkuar dhe sqarime nga burime të reja islame, që e pasurojnë edhe më tej këtë vepër në gjuhën shqipe. Shumë të goditur janë edhe shembujt konkretë nga realiteti i jetuar, bota jonë dhe zhvillimet materiale të saj, që në raport me vetë hadithet, krijojnë një larmi, që të tërheq me logjikën e saj, drejt bindjes dhe nënshtrimit, para duarve të Zotit dhe të Dërguarit të Tij.

Me shumë vend, autori ka përzgjedhur komente elitare të dijetarëve të afirmuar në shekujt e shkuar si: Imam Teftazani, Imam Kushejriu, Imam Gazaliu etj, duke e zburuar këtë vepër në shqip, me prekje të lashta nga dija e vyer dhe thellimi i dijetarëve të lartpërmendur në disa prej çështjeve të komentuar në këtë libër.

Jam i bindur se lexuesi do të përfitojë nga ky botim i ri, sidomos myslimanët shqiptarë në mërgatë, të cilët, më shumë se kushdo, janë të etur për vepra të këtij niveli.

Njëkohësisht, kjo vepër është dëshmi e një hapi cilësor, të matur dhe solid të vëllait tim, Imam Didmar Faja, në rrugën e botimeve me vlerë, që kapërcejnë realitetet e ngushta lokale drejt hapësirave globale të dijes dhe dobisë së saj.

Allahu Mëshirëplotë e pranofte këtë vepër si shenjë përkushtimi dhe dashurie për Madhërinë e Tij dhe për të Dërguarin Mëshirë për mbarë botërat, Muhamedin (a.s).

Amin!

7. Me shënimet: “111 hadithet e mëposhtme janë nxjerrë nga 1550 hadithet e para të librit të mirënjohur: “El-Xhamius-Sagir”, të dijetarit të shquar Imam Xhelaludin Es-Sujuti (h. 849-911). “Libri “El-Xhamius-Sagir”, është i mbushur me një vëllim të madh hadithesh profetike, të cilat u përzgjedhën nga Imam Sujuti, nga libri i tij i madh “Xhem’ul-Xhevamia”, në të cilin mblodhi hadithe profetike të renditura sipas rendit alfabetik”. Ndërkohë, shpjegimet në futnotat janë nxjerrë nga libri voluminoz: “Fejdul-Kadir”, i dijetarit Imam Muhammed Abdurrauf El-Mennavi (h. 924-1031), në të cilin ka analizuar dhe shpjeguar të gjitha hadithet e librit në fjalë të Imam Sujutit, duke analizuar njëkohësisht edhe gradën e secilit hadith... Përzgjedhja, përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip: Muhamed B. Sytari, Shkodër, janar, 2014”.

2. Ibn Haxher El-Askalani, “Sherh el’erbaine hadithen en-Nevevijje”, me studim të Rijad Isa Mensit dhe Abdulkadir Mustafa Tahasë, botimi i parë, Jordani, 2013, fq. 44-46.

3. Me shënimet: “Hadithi - Errbeain”, Dyzet fjalë përmbledhse të Pejga - berit, alejhisselam të cilat i bāhen udhëheqse e plotsimit të çdo myslimani si kah besimi ashtū edhe kah moralet dhe kah veprat. Përmbledhë prej Imami Muhjiddini Neveviut. Përkëtheje prej H.I. Dalliu. Epet falas. Tiranë, Shtypshkroja “Shkodra”, 1934”.

4. Libri: “Katërdhet hadithe” (Fjalë të profetit Muhammed A.S.) Zgjedhur prej: IMAM SHEREFED-DIN NEVEVIUT. I shqiptoi me shenime: Burhan Al-Din S. Fili. Botimi i parë -1986- Albanian Islamic Center Harper Wood, S, MI 48225.

5. Në parathënien e tij, përkthyesi i nderuar, ndër të tjera jep dhe këtë s - hariq: “Tashmë, kur antalogjinë “Dyzet hadithe” po e dorëzojmë në botim, me plot përkushtim i kemi hyrë komentit të këtyre haditheve. Shpresojmë se me ndihmën e Allahut, këtë punë do ta kryejmë me sukses... (Prizren, 5 tetor 1988) – Nexhat Ibrahimisi”.

6. Shumë interesant është shënimi që bën autori, Imam Vehbi Ismaili, teksta e lidh punën e tij me “Katërdhet hadithet” e botuara në vitin 1986. Shkruan: “Në vitin 1986, Qendra Islame Shqiptare e Michiganit botoi librin “Katërdhet Hadithe” (Fjalë të Profetit Muhammed), të zgjedhura nga Imam Sherefeddin Neveviu dhe të shqiptuara me shënime nga Burhan El-Din S. Fili. Ky libër u prit shumë mirë nga lexuesit dhe brenda një kohe të shkurtër u shitën të gjithë ekzemplarët dhe u detyruam të botojmë kopje të tjera... Që nga botimi i këtij libri, Qendrës sonë i kanë ardhur kërkesa të shumta që të paraqesim një përmbledhje më të madhe të Haditheve. Në përgjigje të këtyre kërkesave, fillova të zgjedh dhe të përkthej nga një Hadith çdo ditë. Kur arrita në 150 Hadithe, vendosa t’i botoj... Imam Vehbi Ismaili, 14 tetor 1990” – Kolana e veprave të Imam Vehbi Ismailit, vepra 6, LOGOS-A, Shkup, 2009, fq. 11-12.

T'i mbështetesh Zotit dhe t'i shërbesh Njerëzimit

Një evlija nga rrethinat e Bagdatit e kishte emrin Ibrahim b. Ahmed, llagabin e kishte Havvas, ndërsa nofkën Ebu Is'hak. Havvas ka kuptimin shportë e thurur prej gjetheve të hurmës.

Ibrahim Havas vdiq në vitin 903 në qytetin e Rejit. Ai përherë përsëriste se durimi është kushti i parë për çdo sukses. Ai që nuk duron, nuk do të ketë kurrë sukses.

Atë e konsideronin si sahabiun më të njohur për mbështetjen në Zotin. Megjithatë, ai përherë si në udhëtim, ashtu edhe në vendqëndrimin e tij mbante me vete një gjilpërë, një rrotë peri, një pagure dhe një thikë. Këto duhet t'i mbash përherë me vete, thoshte.

I pëlqente shumë të dilte dhe të udhëtonte. Gjatë udhëtimeve merrte edhe nxënësit e tij me vete. Rrëfëhet se ka shkuar me dhjetra herë në Mekë. Njëherë nga këto udhëtime e rrëfen njëri prej nxënësve të tij me këto fjalë:

“Bëmë njëzet së bashku me Ibrahim Havasin të shkonim në haxh. Para se të niseshim, më tha:

- Njëri prej ne të dyve duhet të bëhet udhëheqësi i tjetrit në këtë udhëtim. Ai do të drejtojë gjatë gjithë udhëtimit.

- Bëhuni juve udhëheqësi im. – i thashë dhe ai pranoi. U nisëm për rrugë.

Rrugës bëmë konak që të pushonim ca. Më tha të ulem dhe filloi të shërbente vetë. Nxirrte ujë nga pusi. Mblodhi dru dhe ndezi zjarr. Gatoi gjellën dhe më dha për të ngrënë edhe mua. Dëshiroja që ta ndihmoja tek-sa i bënte gjithë këto, por nuk pranonte. Sado që unë ngulmoja ta ndihmoja, ai më bënte shenjë ta lija dhe të ulesha.

Pasi pushuam ca u nisëm për udhëtim. Na zuri një

shi i rrëmbyeshëm. Hoqi njëherë rrobë dhe e mbajti mbi kokën time, që të mos lagesha. Nisa të ndjem shumë ngushtë nga gjithë ky shërbim i mësuesit tim. Në fakt duhesha unë t'i shërbeja atij, por ai nuk më dha asnjë mundësi që t'i shërbeja me argumentimin se ishte ai udhëheqësi i udhëtimit. Meqë nuk pata fatin t'i bëja as shërbimin më të vogël, nuk kishte minutë që nuk ndjeja pendesë që nuk kisha zgjedhur që të bëhesha unë udhëheqësi i udhëtimit.

Vazhduam rrugën për ditë me radhë në këtë mënyrë. Pas një udhëtimi të gjatë, më në fund mbërritëm në Mekë. Pasi kryem adhurimin e haxhit, u nisëm në rrugën e udhëtimit për në Bagdad. Ky udhëtim ishte mësimi më i paharrueshëm që kisha marrë në jetën time. Pasi u kthyem nga haxhi, Ibrahim Havasi më këshilloi me këto fjalë:

- *Biri im! Kështu të shërbesh edhe ti kur të bëhesh udhëheqës. Udhëheqës nuk është ai që i vë të tjerët t'i shërbejnë atij, por ai që u shërben të tjerëve. Ai që u siguron miqve të tij lumturinë dhe qetësinë dhe i duron problemet që i krijojnë të tjerët.”*

Rrëfëhet se Ibrahim Havasi nuk i tregonte askujt nëse kishte vendosur të dilte për udhëtim. Kur nisej merrte me vete vetëm enën e ujit. Hamid el-Esved ka rrëfyer këtë ngjarje, që gjendet e regjistruar në tefsirin Ruhu'l-bejan:

“Një herë po qëndronim së bashku me Ibrahim Havasin brenda në xhami. Mori enën e ujit dhe doli jashtë. Unë u ngrita dhe i shkova nga pas. Pasi ecëm një copë here, u kthye nga unë dhe më tha:

- Ku po shkon kështu, o Hamid?

- Po ju ndjek juve nga pas. – iu përgjigja unë.

- Unë jam nisur të shkoj për në Mekë, inshallah. – më tha.

- Dhe unë atëherë, inshallah. – i thashë.

U nisëm për në Mekë dhe rrugës takuam një djalosh të ri. Ai u bashkua me ne.

Djaloshi udhëtoi me ne një ditë e një natë. I riu nuk falte namaze. Këtë gjë ia tregova Ibrahim Havasit.

Pas një copë here Ibrahim Havasi ndaloi për të bërë një pushim. Nisi të hynte në bashkëbisedim me djaloshin dhe mes të tjerash e pyeti:

- O djalosh! Përse nuk e fal namazin? A nuk e di se namazi është një obligim më i fortë se sa haxhi?

- O shejh! – iu përgjigj djaloshi. – Unë nuk e kam detyrim namazin!

- A nuk je mysliman ti? – e pyeti Ibrahim Havasi.

- Jo. – iu përgjigj ai.

- Cila është feja jote? – e pyeti Ibrahim Havasi.

- Unë jam i krishterë. – u përgjigj djaloshi. – Por kam arritur nivelin e besimtarit që i mbështetet vetëm Zotit sipas besimit tim. Uni më mbushi mendjen se unë e kam arritur këtë nivel dhe dola në shkretëtirë, aty ku nuk ka krijesë tjetër përveç Zotit. Vendosa që të zhytesha në meditim.

Ibrahim Havasi u ngrit dhe nisi të ecte, ndërkohë që më tha mua:

- Lejoje të vijë bashkë me ty!

Djaloshi vazhdoi të ecte rrugës bashkë me ne. Në fund fare mbërritëm në kufirin e haremit. Ibrahim Havasi u ngrit, hoqi rrobat dhe i lau mirë e mirë me ujë. Pastaj u ul dhe e pyeti djaloshin:

- Si të quajnë?

- Abdulmesih. – u përgjigj ai.

Ibrahim Havasi i tha:

- O Abdulmesih! Këtu fillon kufiri i zonës së Mekës. Allahu e ka vënë këtë kufi që të mos e kalojnë jomuslimanët sikurse je ti dhe për këtë në Librin e Tij ka thënë: **“...Mushrikët janë të fëlliqur, prandaj prej këtij viti e tutje të mos i afrohen Mesxhidi Haramit...”** (Tevbe, 28) Unë kisha për qëllim që të dilte në shesh ajo që ti mbaje përbrenda. Ti na e tregove atë. Mos e kalo kufirin e caktuar.

Pasi tha këto fjalë u ngrit dhe u nis. Hamid el-Esved iu vu nga pas. Ata e lanë aty djaloshin dhe hynë në Mekë.

Pastaj u nisën në drejtim të Arafatit. Ndërsa porrinin në Arafat dalluan nga larg djaloshin e udhëtimit, i cili po vinte në drejtimin e tyre i veshur me dy copë peshqirë të mëdhenj.

Ai kishte veshur ihramin dhe ecte duke i parë njerëzit

në fytyrë, në mënyrë që t'i dallonte se kush ishin. Në fund fare u afrua pranë nesh. Kur e pa Ibrahim Havasin u përkul para tij dhe ia puti duart.

- O Abdulmesih! – i tha Ibrahim Havasi. – Çfarë ka ngjarë me ty?

- Mos! – i tha djaloshi me sytë e përlotur. – Unë tani nuk jam më robi i Mesihut, por i Allahut, tani e tutje emri im do të jetë Abdullah.

- Pa më trego si ngjau. – i tha Ibrahim Havasi. Djaloshi filloi të na tregonte:

- Pasi u ndava prej jush, qëndrova ashtu i ulur dhe nisa të mendoja. Në atë moment pranë meje kaloi një karvan me haxhilerë. Ishin veshur të gjithë me rroba të bardha. U ngrita në këmbë në shenjë respekti. Pikërisht në këtë moment në zemër ndjeva një ndjenjë të re. Dashuria ime për ju nisi të më shtohet. E ndjeja veten a thua se kisha veshur ihramin dhe gjendesha në Qabe. Në çast të gjithë besimet humbën rëndësinë e tyre në sytë e mi përpara fesë islame. Vendosa të bëhesha mysliman, mora gusl dhe veshi ihramin. Pastaj u vura në kërkimin tuaj.

Ibrahim Havasi u kthye nga unë dhe më tha:

- O Hamid! Shih se cila është begatia e besnikërisë ndaj fesë! E pe se si e pranoi ai Islamin?

Djaloshi që prej asaj dite e kaloi jetën së bashku me ne dhe vdiq duke qenë njëri nga të dashurit tonë.

Ismail Haki Burseviu ka nxjerrë këto përfundime nga kjo histori:

1. Ashtu sikurse një mushrik i zhytur në shirk nuk mund të hyjë në haremin e Qabesë, ashtu edhe një pretendues që mbron vetëm pretendimin e tij nuk mund të hyjë në haremin e zemrës.

2. Ky djalosh pati shijuar momentet e qëndrimit së bashku me besimtarët e devotshëm. Ai pati shoqëruar me ditë me radhë një njeri të ditur siç ishte Ibrahim Havasi. Allahu nuk ia çoi dëm këtë udhëtim me të, por ia shndërroi në një kapital besimi.

3. Besnikëria që kishte djaloshi ndaj shpirtit të tij e shtyu atë drejt besimit tek Allahu dhe e nxiti të refuzonte të pavërtetën dhe të gënjeshtërtën.

4. Ata që janë në kërkim të së vërtetës dhe të së drejtës përfitojnë nga njerëzit e mirë, nëpërmjet tyre gjejnë Zotin dhe nuk i përgënjeshtrojnë argumentet e Zotit.

Zoti na mundësoftë të gjithëve të arrijmë nivelin e sinqeritetit dhe besnikërisë ndaj fesë dhe na bëftë nga ata që i mbështeten vetëm Zotit dhe u shërbejnë myslimanëve!

Amin!



Alshe Tuba Bakiler

E dashur si Nënna!

Nëna është personi që e bën fëmijën e saj burrë për jetën. Nëna është pasqyra, ndërsa fëmijët e saj drita dhe ngjyrat. Nëna është grusht vuajtjesh dhe simboli i personifikuar i sakrificës. Flatrat e saj janë përherë mbi fëmijët e saj. Nëna është mbështetja dhe loja e parë e fëmijës. Nëna është shembulli dhe shkolla e parë e tij. Fëmija merr nga e ëma mësimet e para, e imiton atë dhe e vë veten e tij në pozicionin e saj. Ka ditë që nëna bëhet ruajtësja e sekretit të fëmijëve, ka ditë që krenohet me ta. Ka ditë që nëna bëhet reja e fëmijës së saj, që lëshon shiun e begatë për të, ka ditë që ajo e edukon ashpër atë duke thënë me vete se “fëmija është i shenjtë, por edukimi i tij është edhe më i shenjtë.”

Nëna është jeta, syri dhe veshi i fëmijës që ia ka borxh jetën e tij nënës. Fëmija ka botën e tij në qoftë se ka nënën dhe nuk ka botën e tij, në qoftë se nuk e ka atë. Pra fëmija është gjithçka me nënë dhe asgjë pa të. Një asgjë e madhe. Fëmija lëkundet nga mungesa e nënës së tij, është i trullësuar, i frikësuar dhe për të çdo gjë është i pamotivuar. Mëmësia është ndjesia që e bëri Haxheren të vraponte në shkretëtirën e stërmadhe. Nëna e qumështit e Musait në saraje është emri i ndjenjës së fuqishme që e gjunjëzoi edhe vetë faraonin. Nganjëherë nëna purifikohet nga një mëkat i sajuar me anë të Isait që flet në djep, nganjëherë ajo është tema e fermanit hyjnor drejtuar birit të saj, të cilit i thuhet “o në xhenet, o në xhehenem”. Nëna është si kandili që ndriçon veten dhe të tjerët duke u shuar. Zemra e nënës është si ujvarë, por ajo shndërrohet në luaneshë kur fëmija i saj bëhet subjekti i një padrejtësie. Ajo end pak e nga pak të ardhmen e fëmijës së saj në avlëmendin e shpirtit. Ajo e stolis, e zbukuron atë me përpikmërinë e një argjendari duke e përgatitur për jetën.

Çfarë është fëmija në sytë e nënës së saj? Fëmija është një lule e brishtë e livadhit. E ardhmja që pritet me shpresë, e nesërmja që premton të ardhmen. Fëmija është drita e syve të nënës, rrahja e zemrës dhe fryma e jetës. Fuqia që ia mban hapur fletoren e jetës, potenciali që do t'i vërë kurorën mbi kokë. Fëmija është investimi në rininë e saj dhe shpresa e saj në pleqëri. Në kohët e

vështira fëmija është bastuni i dorës, drita e syve dhe forca e gjunjëve për nënën. Fëmija është gjithçka për nënën. Fëmija është një fidan, një gjethe, një fryt për nënën. A nuk i ka quajtur edhe dielli i dy botëve “frytat e xhenetit” fëmijët e tij? Pa shiko se çfarë e urdhëron Zoti fëmijën e prindërve të tij kur i thotë me anë të sures Isra: **“Shtrij krahët e mëshirës për prindërit e tu dhe thuaj: ‘Zoti im! Mëshiroji ata të dy ashtu siç më kanë mëshiruar dhe u jam dhimbsur edhe unë atyre kur kam qenë i vogël.’** Në çfarë mënyre madhështore që e ka shprehur Zoti. Në çfarë mënyre të qartë dhe haptazi na kanë ftuar të lutemi me këto ajete të madhërueshme.

Prandaj të dashur miq, ne duhet të vëmë gishtin mbi këtë të vërtetë: Në qoftë se fëmija për nënën dhe nëna për fëmijën e saj janë kaq të vyer dhe të rëndësishëm, si është e mundur që me kalimin e kohës kjo dashuri dhe ndjeshmëri dobësohet dhe shkatërrohet? Si ndodh që fëmijët nuk u shërbejnë më prindërve të tyre dhe e konsiderojnë marifet që mos t’u binden atyre? Ka fëmijë që nis t’u duket angari mbulimi i shpenzimeve të prindërve të tyre dhe nis t’u duket si torturë kjo gjë. Si arrin fëmija që t’ia prishë zemrën nënës së tij, duke iu bindur kështu egos dhe shejtanit, ndërkohë që ajetet e Zotit e kanë urdhëruar atë që “mos t’u guxojë t’i thotë as Uf! prindërve të tij? Vërtet që e kam të vështirë të gjej përgjigjen e këtyre pyetjeve.

Ejani miqtë e mi! Rishikojini edhe një herë marrëdhëniet me prindërit tuaj, në qoftë se ata janë gjallë. Mos harroni se ua keni borxh atyre ekzistencën tuaj! Bëni gara se kush do të arrijë të jetë më shumë respektues për prindërit e tij. Merrni duanë e tyre dhe gëzojuani zemrat. U këshilloj me këmbëngulje të arrini të merrni duanë e nënës suaj “me meritë”. Duaja e nënës suaj është kapitali më i madh për ju. Mos i merrni këto fjalë si ofshamat e një vajze të mbetur pa njeri, por si klithmën e fortë të një evladi për nënën e vet. Pa dyshim që hadithi profetik na ka mësuar se nëna ka tri herë përparësi ndaj babait, por nuk duhet të harrojmë që t’u shërbejmë edhe baballarëve tanë, sepse vetë i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë se: “Lutja e babait për evlatin e tij është si lutja e Profetit për ymetin e tij.” Mos të harrojmë që të bëjmë dua me fjalë dhe me vepra për këto dy krijesat më të mira për ne në të gjithë gjithësinë. Veproni dhe bëni diçka për ta para se të jetë shumë vonë, para se të pendoheni për këtë gjë, një gjë që është e prekshme. Në qoftë se tani është vonë, sepse ata janë nisur për në udhëtimin e përjetshëm, atëherë kujtojin ata përherë me lutjet më të mira.

Edlson Çeraj

SISTEMI ËSHTË KAOS

Duket si lojë fjalësh ky pohim, pasi tanimë stilistika me akrobacitë e saj formale shënon lëvrime të lavdishme deri në bezdi, duke nisur që nga gazetari apo analisti më në hije e deri te kandidatë bombë për "Nobel-in" në letrat aspak higjenike – por, ajo që dua të them është se cilido qoftë sistemi, i marrë nga lashtësia apo i shpikur së fundmi, nga Lidnja apo Perëndimi, apo i përshtatur ca andej e ca këtej, ai ka prirjen e pashmangshme të rezultojë utopi, dhe utopia është një mbivendosje artificiale mbi rrjedhën mrekulliplotë të gjërave dhe mbi njeriun në veçanti, ku ky i fundit, sipas utopisë, nuk lind, por (duhet të) bëhet. Kështu, kjo mbivendosje cenon drejtpërdrejtë spontanitetin e jetës dhe lirinë e njeriut, pasi utopia e për-kufizon jetën dhe njeriun, por as jeta dhe as njeriu nuk kanë përkufizim; ose më shkoqur, përkufizimi i tyre i vetëm është se nuk kanë përkufizim. Kjo i tmerron shumë racionalistët dhe teologët, si dhe gjithë shpurën e asistentëve të tyre sypatrembur. Prandaj, në këtë kuptim, sistemi shënon kaos¹, pasi i dikton njeriut deri edhe se çfarë duhet të bëjë në të ashtuquajturën kohë të lirë, dhe kjo përbën një ndrydhje me pasoja çnjerëzore².

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh sa më lart, interpretohet tërthorazi edhe pjesa e dytë e pohimit në titull, që "kaosi është sistem". Domethënë, kaosi si rrjedhë spontane, si liri, si përmbushje e qenies hap pas hapi duke u nisur nga "domosdoshmëria e brendshme" (Kandinsky), duke i qenë besnik vokacionit ontologjik

1. Çrregullim, ose dalje nga natyrorja.

2. Natyrisht që kjo është në varësi të asaj se çfarë ka mbetur nga njerëzorja te qenia që aq kalimthi e gati biofunktionalisht e quajmë "njeri".

për të ruajtur njerëzoren e rrezikuar nga poret magjike të utopisë – pra, jo kaos në kuptimin e anarkisë, ku, për shembull, liria nënkuptohet të bësh çfarë të të thotë rradakja e çfarë të ngasin rrethanat, duke eklipsuar kështu një prej shtyllave që mban më këmbë qenien: aftësia për të dalluar.

Tani do ndalemi te një hapësirë ku në një mënyrë apo në një tjetër synohet të vihet rend/sistem, dhe për pasojë ka lidhje të drejtpërdrejtë me sa trajtuam gjer më tani. Kjo hapësirë është krijimtaria artistike, një nga hapësirat e pakta që na nxjerr nga rreshti ku kërkon të na vendosë sistemi.

Studiues të caktuar, por edhe artistë, jo rrallë flasin për kondita të caktuara (që në thelb aludojnë për një sistem), të cilat sipas tyre janë gati *conditio sine qua non* për krijimtarinë artistike dhe për kulturën në përgjithësi; përndryshe nuk do kemi një krijimtari për të qenë. Por, ja që ka qindra raste nga e shkuara dhe nga e sotmja që na dëshmojnë shkoqur se një vepër arti lind në kushte nga më të ndryshmet, si: në skamje, në mirëqenie, në klimë totalitare, në totalitarizmin global të ditëve tona, në burg, në sisteme teokratike, në anarki, në mungesë të një studioje apo galerie, në vende të zhvilluara industrialisht dhe në të ashtuquajturat vende të prapambetura, nën qeverisje që investojnë shumë për kulturën dhe në ato qeverisje që s'e kanë fare në agjendë atë e kështu me radhë.

Cilido qoftë sistemi (mbi artin), sado i arrirë apo i përsosur qoftë, sado "i hapur" e me "liri zgjedhjeje" qoftë, ai është vrasësi *par excellence* i krijimtarisë, pikërisht duke e sistemuar këtë të fundit, duke e rregulluar atë

HE KAOSI ËSHTË SISTEM

sipas një mënyrë apo hierarkie të caktuar; pra, duke e bërë krijimtarinë të parashikueshme, që mund të porositet; duke e bërë konkrete, që shënjon gjithnjë një çështje X apo Y, sidomos politike (një trend i kohës ky); duke e zberthyer veprën copë e çikë e duke ta dhënë kuptimin e saj në një copë A4; duke e reduktuar veprën në mall ndër mallra, që prodhohet e konsumohet me afat skadence të shpallur. E thënë shkurt, sistemi kërkon ta përdorë artistin, jo për ndonjë arsye që lidhet me tregun apo për të përshpejtuar fundit e botës, por vetëm për ta kontrolluar, ashtu siç është e kontrollueshme llogaria e tij bankare.

Pikërisht kjo është çmagjepsja e artistit.

Vepra e gjen vetë rrugën e vet, pavarësisht nga ne dhe çfarë bëjmë apo nuk bëjmë ne.

Rrëkeja rrjedh vetë. Ndërhyrjet për ta rregulluar apo për ta bërë atë më të bukur, në mos sot, nesër do bëjnë që ajo të shterojë për fare.

Ka diçka të ngjashme në këtë drejtim me ndërhyrjen e një shtetit totalitar në ekonomi, duke e centralizuar atë në emër të barazisë apo mirëqenies ideale³ (socializmi). Në emër të popullit, i cili nuk ka ekzistuar kurrë. Tani e dimë mirë se cilat ishin pasojat për ekonominë në një regjim totalitar si, fjala vjen, komunizmi.

Në fakt, vetë artisti, as që do t'ia dijë për atë që quhet sistem, duke qenë se për të mbërritur gjer te sistemi duhet ta lësh mënjanë krijimin; por, duhet edhe dije, dhe artisti nuk është i ditur, dhe nuk del dot nga ethet e krijimit, edhe nëse do. Për artin mund të themi se

³. Preteksti është për t'u pirë në kupë, por si gjithnjë ai është vetëm një karrem.

është njohje, por jo dije.

Të gjitha elementet që i vijnë rrotull veprës së artit, si: muzeu, galeria, kuratori, menaxheri dhe menaxhimi, rryma/stili, çmimi, tregu etj., nuk janë shpikur nga artisti dhe as nuk mbahen në këmbë prej tij.

Parashikimi rezulton absurd. Kur vetë artisti nuk e di se çfarë vepre do bëjë, për shembull, pas një jave apo pas një muaji, si mund ta dijë/vendosë këtë një tjetër? Kalendarët për veprimtaritë kulturore janë të zymta si asfalti i rrugëve.

Çdo vepër e porositur, për arsye tregu apo të ashtuquajtura kulturore, ose për një arsye cilado qoftë ajo, i ngjan fundekrye veprave të programuara me plan në regjimin komunist. Ato janë si kufomat, ose si mumie – janë të pranishme dhe të imponohen me mënyra të caktuara, mirëpo nuk kanë jetë. Kjo sepse vepra të tilla, në këtë gjendje, nuk vijnë nga brenda, – domethënë, nga burimi – por nxiten dhe provokohen (me dhunë sistematike) nga jashtë, dhe kështu e jashtëmja (rrethana) modifikon mendimin dhe përjetimin.

Këtë kuptim transmeton ajo thënia e njohur latine, *ars longa vita brevis* – “arti është i gjatë, ndërsa jeta e shkurtër”. Pra, arti, duke marrë në vëmendje burimin e tij, është i përjetshëm; kurse jeta – ajo e kohës dhe hapësirës – është e shkurtër, ose thjesht një përjetim.

E çfarë ndryshimi ka ndërmjet ëndrrave dhe të shkuarës? (Borges)

Sa më pak plane, aq më shumë liri, aq më shumë jetë; si dhe *vice versa*: sa më shumë plane, aq më shumë ndrydhje e ngurtësi.



Sakrifica:

Prologu i udhës drejt lumturisë

A. JasIn Demirxhi

Megjithëse lumturia dhe vështirësia mund të duken si dy koncepte të kundërta me njëra-tjetrën, vështirësitë dhe problemet që jetohe gjatë kësaj jete konsiderohen edhe si prologu i ditëve të mbushura me gëzim dhe hare. Me fjalë të tjera, hallet dhe problemet janë edhe lajmëtarët e ditëve të hareshme që janë duke afuar drejt nesh. Shpërblimi i durimit ndaj halleve dhe fatkeqësive është gëzimi dhe hareja që do të mbushin jetën tonë. Pra, ashtu siç ngjan për çdo gjë tjetër edhe fitimi i lumturisë kushtëzohet nga sakrifikimi dhe shpenzimi i përpjekjeve serioze në këtë jetë. Specialistët kanë nënvizuar faktin se ata që arrijnë një jetë të lumtur pasi kanë përballuar me sukses vështirësitë që kanë hasur në jetë dhe kanë shpenzuar energjitë e tyre në këtë drejtim, janë më të ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe vlerën e jetës së qetë dhe të lumtur.

Dr. Salah Salih Rashid është një psikiatër nga Kuvajti. Ai është i njohur në lindjen e mesme me librat që ka shkruar në lidhje me lumturinë. Njëri prej këtyre librave titullohet: **“100 Këshilla për një jetë sa më të lumtur.”** Këshillat dhe konstatimet e Dr. Salah Salih Rashid në lidhje me përpjekjet që duhet të shpenzojë njeriu dhe rëndësinë e përdorimit të intelektit në këtë drejtim në mënyrë që të arrijë lumturinë në këtë jetë, janë shumë interesante.

Salah Rashid i ndan në katër grupe njerëzit nga aspekti i lumturisë:

1. Njerëzit e lumtur edhe në këtë jetë, edhe në jetën tjetër. Këta janë besimtarët që përpiqen për një jetë sa më të lumtur, duke përdorur për këtë qëllim edhe intelektin e tyre. Pra këta janë njerëzit më pozitivë në shoqëri.

2. Njerëzit e lumtur në jetën tjetër dhe të palumtur në këtë jetë. Këta janë besimtarët, të cilët nuk shpenzojnë energji të mjaftueshme në këtë drejtim.

3. Njerëzit e lumtur në këtë jetë dhe të palumtur në jetën tjetër. Këta janë jobesimtarët të cilët shpenzojnë energji të mëdha për të fituar lumturinë në këtë jetë.

4. Njerëzit e palumtur edhe në këtë jetë, edhe në jetën tjetër. Këta janë personat që nuk janë besimtarë dhe nuk shpenzojnë energjitë e duhura për një jetë të lumtur në këtë botë. Këta janë njerëzit më të pavlefshëm për shoqërinë dhe më fatkeqët.

Me këtë klasifikim që u ka bërë Dr. Salah Salih Rashidi njerëzve në varësi të faktit se sa të lumtur janë ata, ai njëkohësisht nënvizon faktin se lumturia është një situatë e mundshme për t'u arritur. Që të jesh i lumtur në jetën tjetër mjafton të jesh besimtar i vërtetë. Në qoftë se besimtari është i palumtur në këtë jetë, përgjegjësia e vetme për këtë gjë rëndon mbi të, sepse ai nuk e ka



përdorur mendjen e tij sa duhet dhe nuk është përpjekur sa duhet të fitojë lumturinë.

Këtë të vërtetë Aliu (r.a.), e ka shprehur me këto fjalë:

- O njeri! Ti je burimi i lumturisë apo fatkeqësisë tënde, prandaj mos i kërko këto të dyja më kot atje lart në qiell apo brenda futur në tokë!

Atëherë, cilat janë hapat që të shpien drejt rrugës së lumturisë?

Dr. Salah Salih Rashid këshillon:

- Njeriu duhet të pyesë veten se çfarë është lumturia? Kjo pyetje mund të marrë afërsisht dhjetë apo njëzet përkufizime, në dritën e të cilave secili mund të krijojë një ide sa më të saktë në lidhje me lumturinë dhe mungesën e saj.

- Personi duhet të besojë thellë në zemër se ai do të jetë një ditë i lumtur, nëse i përkushtohet me gjithë fuqitë e tij këtij qëllimi. Për shembull, ai duhet të thotë: "Unë mund të ngadhënjej mbi zemërimin tim dhe me

lejen e Allahut unë do të ndihem i lumtur.

- Personi duhet të përpiqet që të zhvillojë në ndër-gjegjen e tij ide që janë vërtetuar se krijojnë premisa lumturie, siç janë mendimet e llojit të nxjerrësh mësim nga e kaluara, t'ia dish vlerën momentit që je duke përjetuar, të shohësh me optimizëm drejt së ardhmes, t'i konsiderosh problemet me të cilat ballafaqohesh si "mundësi të reja për thyerjen e monotonisë", të jesh në paqe me veten dhe me të tjerët.

- Jeta ka katër dimensione dhe ato janë: dimension i shpirtëror, shoqëror, personal dhe fizik. Njeriu i lumtur i jep secilës prej tyre rëndësinë që i takon.

- Mendo dhe shpreh me fjalë atë që dëshiron dhe kërkon dhe mos mendo rreth asaj që nuk do të dëshiroje që të të ndodhte. Në vend që të thuash: "Unë nuk dua tensione, shqetësime dhe probleme", përdor fjalët "unë dua të jem i qetë, i lumtur." Mendimet dhe shprehjet tuaja formuloji përherë mbi pozitivitetin.

Këshilla për jetën e përditshme, në mënyrë që të jesh i lumtur

- Tregohu i kujdesshëm që të kryesh me përpikmëri faljen e pesë kohëve të namazit brenda ditës, që janë edhe lidhja jote më e fortë me Allahun. Lutu. Lexo për ditë diçka nga Kurani, qoftë edhe vetëm disa ajete.

- Lexo në mëngjes dhe në mbrëmje suret Ihlas, Nas dhe Felek, në mënyrë që të ruhesh nga dyshimet dhe cytjet e shejtanit. Mos harro ta bësh përherë këtë dua:

- *Unë çdo veprim e kryej me emrin e Allahut, i Cili ndalon çdo gjë në tokë dhe në qiell që t'i bëjnë dëm personit që përmend emrin e Tij. Allahu dëgjon, sheh dhe di çdo gjë deri në detaje.*

- Interesohu për prindërit tuaj dhe ndaj kohë për familjen tënde.

- Ushqehu në mënyrë të shëndetshme duke ngrënë ushqime hallall.

- Bëj sport dhe thith ajër të pastër. Mos i nënvleftëso kontrollet shëndetësore.



KJO BOTË ËSHTË E JONA

Enklid Pelari

Është përhapur ndër njerëz klisheja se të punosh për ahiretin, do të thotë ta lësh mënjane këtë botë. Mirëpo Zoti (xh.sh.), në Kuran na porositi që të mos e lëmë mangut atë që na takon nga kjo botë. (surja: Kasas, ajeti 77). Dhe Profeti (a.s.), thotë: *"Mbi një pemë, edhe sikur nesër të bëhet kijameti."* Të dyja këto argumente hedhin dritë mbi faktin se besimtari, jo vetëm që nuk duhet ta neglizhojë këtë botë, por nga ana tjetër, duhet të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së kësaj bote.

Shumë besimtarë sot në shtëpitë e tyre përkujdesen për higjienën personale, për pastërtinë dhe mirëmbajtjen e ambientit, për zbulimin e shtëpisë etj. Tani pyetja që shtrohet është: Pse mini-shtëpinë e mirëmbajmë, kurse mega-shtëpinë (mjedisin që na rrethon) nuk e mirëmbajmë? A nuk thithim të gjithë të njëjtin ajër, a nuk shkelim të gjithë të njëjtat rrugë, a nuk na e vret veshin të gjithëve ndotja akustike, ajrore dhe mjedisore. Shkurt, a nuk po "bashkëjetojmë" të gjithë poshtë të njëjtit qiell dhe brenda së njëjtës botë?

Kjo botë është e jona, sepse Zoti (xh.sh.), në Kuran tregon se tokën do t'ua trashëgojë atyre të cilët falin namazin dhe japin zeqatin. Shkurt, atyre që e falënderojnë Krijuesin me gojë dhe vepra. Duke qenë se besimtari është më i merituari për këtë botë, pra "është shtëpia" e tij, përse ai nuk nxiton në ruajtjen dhe pastrimin e ambientit, në sensibilizimin e kësaj pune, kur dihet hadithi që thotë se të heqësh një pengesë nga rruga është sadaka.

"Profeti (a.s.), në Mekë e nisi lëvizjen siç funksionojnë sot organizatat bamirëse" (Alija Izetbegović), ndërsa unë them që me termat e sotëm Ai (a.s.), e nisi atë si shoqëri civile. Luftoi për të vobektët dhe të dobët, luftonte kur paria e Mekës bënte padrejtësi ndaj jabanxhinjve (ashtu siç sot shoqëria civile lufton korrupsionin dhe moszbatimin e ligjit). Shkurt, Profeti (a.s.), ishte aktiv në përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve, pra duke tentuar të maksimizojë ndikimin e vet në ndryshimin e gjendjes e jo duke e abandonuar të keqen.

Në shoqërinë turke prevalon një kulturë e tillë e trashëguar nga religjioni, ku çdokush e ndjen veten pjesë të shoqërisë dhe e ndjen shoqërinë pjesë të problemeve të veta. Kjo ndjesi manifestohet në empatinë turke me shprehje

të tilla, si: "Çfarë të bëjmë që të punësojmë të papunët tanë, çfarë të bëjmë që të mos ndotim ambientin tonë, çfarë të bëjmë për të varfrit dhe të vobektët tanë, çfarë të bëjmë për politikën që t'i shërbejë popullit tonë, çfarë të bëjmë për sirianët vëllezërit tanë. Shkurt, të gjithë ishin të "vetët" dhe shoqëria trupëzohej në një trup me shumë shpirtra, ku mishërohej hadithi i Profetit (a.s.): *"Shembulli i besimtarëve është si një trup i vetëm, kur rënkon njëra gjymtyrë i gjithë trupi rri zgjuar natën e vuan."*

Myslimanët sot e kanë braktisur "shtëpinë" e tyre dhe e kanë lënë atë në mëshirë të fatit apo të tjetrit. Shqipëria nuk është një shtet ku myslimanët të izolohej se shoqëria s'është me ta, por një vend me shumicë myslimane ku duhet të punojnë së bashku për të mirën e përgjithshme dhe dobinë universale të tyre. Nëse Profeti (a.s.), shfaqte pëlqim për pjesëmarrje në forumin Nedwa¹, po ne sot pse mos ta zbatojmë sunetin e tij. Pse sot myslimanët mos të ngrenë organizata ku të merren, fjala bie, me gratë e dhunuara, fëmijët me sëmundje të ndryshme, me pleqtë që kanë nevojë për azil, me njerëzit që u mohohet e drejta nga gjykatat e t'u ofrojnë konsulencë ligjore dhe t'i orientojnë drejt mekanizmave ndërkombëtarë ku ta kërkojnë të drejtën, me zyra punësimi dhe biznese sociale etj.?

"Njeriu më i dashur tek Allahu (xh.sh.), është ai që u bën më shumë dobi njerëzve (shoqërisë)" (Profeti Muhamed (a.s.). Islami tek Zoti (xh.sh.), tregohet me adhurim dhe ndalohet që kjo pjesë t'u ekspozohet njerëzve, kurse Islami tek njerëzit tregohet me vepra të dobishme, me utilitarizëm, me pozitivizëm, me seriozitet dhe korrektësi. Le ta nxjerrim Islamin në shoqëri, në mënyrë që ajo të futet në Islam, sepse murgëria në xhami nuk është pjesë e Islamit dhe sepse Profeti (a.s.), Islamin e propagandonte në Mekë, epiqendra kulturore botërore e asaj kohe, në tregje, në tubime etj. e jo vetëm në xhami. Ka ardhur koha që myslimanët shqiptarë të mos punojnë vetëm me fjalë, por të flasin me punë dhe për këtë le të marrin shembull shtetin e tyre mik Turqinë.

1. Forumi Nedwa ishte një forum ku mblihdeshin fiset kryesore arabe në mënyrë që të miratonin një memorandum për t'i garantuar të drejtat jabanxhive e pelegrineve që vinin në Mekë. Profeti (a.s.) shpesh shprehte pëlqimin e tij që kishte marrë pjesë në këtë forum dhe thoshte: "Edhe sikur sot të më thirrnin për të marrë pjesë atje do e pranoja ftesën."

Receta pa efekte anësore

Dr. Ali Akben

Studimet shkencore kanë treguar se efekti *placebo* i recetave që shkruajmë për pacientët ndikon mbi njëzet për qind për shërimin e tyre. *Placebo* me pak fjalë mund ta përkufizojmë si ilaç pa efekt kurimi.

Ilaçet që ne mjekët i rekomandojmë me anë të recetave të ndryshme, për shkak se është më e lehtë dhe nuk ka vështirësi dhe mbështeten nga hulumtimet gjithëpërfshirëse shkencore dhe trustet e ilaçeve nuk arrijnë të sigurojnë tërësisht përmirësimin e shëndetit të pacientëve tanë. Formulatat e rafinuara kimike që përdoren në kurimin perëndimor bashkëkohor mund të shkaktojnë ndikime anësore të panumërta, përmirësimi i të cilave mund të jetë i pamundur.

Do të doja t'ju kujtoja edhe disa receta të shkurtra që nuk përmbajnë ilaçe, efekti i të cilave ka shekuj që është vërtetuar:

Mos u shtroni në sofër për sa kohë që nuk keni uri dhe përpiquini të ngriheni nga sofa pa e ngopur stomakun plot.

Hani dhe pini me masë, thjesht dhe aq sa të thyeni urinë.

Përpiquini të shmangni bukën e bardhë dhe produktet e përgatitura me miell të bardhë. Përpiquini të ushqeheni me bukë gruri të përgatitur në mënyrë tradicionale.

Përdorini me masë mishin dhe nënproduktet e tij dhe mundohuni të mos hani copat me dhjamë.

Përdorini më shumë mishin e pulës dhe të peshkut.

Përpiquini të përdorni sa më shumë vajin e ullirit në ushqimet tuaja.

Ushqehuni me masë dhe me karar me mjaltë të prodhuar në kushte natyrale, si dhe pini çajra bimore, qu-mësht dhe kos.

Ushqehuni me të gjitha llojet e frutave dhe perimeve. Ato edhe të ruajnë nga sëmundjet, edhe të kurojnë. Nuk është e thënë që njeriu duhet të dijë urtësinë e çdo gjëje. Vetëm se disa ilaçe natyrore t'i konsumojmë pak a shumë.

Ka bimë medicinale që kurojnë çdo lëngim me për-

jashtim të vdekjes. Studimet e gjithanshme laboratorike që janë kryer, kanë treguar se këto lloj bimësh e forcojnë sistemin tonë imunitar duke u bërë kështu një mburojë ndaj mikrobeve dhe viruseve që asgjësojnë qelizat tona dhe si rezultat rritet rezistenca jonë kundër qelizave kancerogjene.

Le të shohim se çfarë portash hap përpara nesh duaja që ka kuptimin kërkesë dhe lutje. Para së gjithash, me anë të lutjes ne takohemi me Krijuesin tonë që na ka premtuar kurimin. Një takim ku dyfytërsia nuk ka përfitim. Një takim i sigurtë. Njeriu në këtë gjendje psikologjike bën që

nëpërmjet gjuhës dhe zemrës së tij të shkaktojë prodhimin e disa hormoneve në trurin e tij.

Lëndët dhe hormonet që

përftohen kanë një ndikim shumë pozitiv, mbështetur në studimet e gjithanshme që janë kryer. Ky ndryshim bio-kimik, që formohet në trurin dhe në inteligjencën tonë bëhet

shkak për sigurimin e shërimeve të pa-shpresuara.

Pendimi dhe kërkesa e faljes, ajetet e shërimit në Kuran, suret, si Jasina, Fatihaja, Xhin, Ihlas dhe Bekare, Besmeleja dhe lutjet e këshilluara në literaturën e mjekësisë profetike mund të përdoren si receta shtesë për shërimin e shumë sëmundjeve.

Burime shëndeti dhe shërimi janë edhe ndjenjat e dashurisë së ndërsjellë mes njerëzve, kontakti buzagaz me ta, interesimi për njëri-tjetrin, përqaftimi me njëri-tjetrin dhe shkëmbimi i dhuratave.

Teksa kërkojmë zgjidhje dhe shërim për kurimin tonë duke i përdorur në nivelin më të lartë të gjitha mundësitë moderne të mjekësisë, duhet të përpiqemi të përfitojmë edhe nga recetat e mësipërme që u përpoqëm t'i përmbledhim shkurtimisht, rezultati i të cilave është vërtetuar tek të tjerët.

Provojeni dhe do ta shihni...





M. Sami Ramazanoglu



MËNYRAT E LARTËSIMIT NË ROBËRINË NDAJ ALLAHUT

Me vullnetin e Zotit të Madhëruar, të është bërë e mundur që në moshë të re të drejtohesh drejt përsipirtshmërisë përmes pendimit. Zoti i Madhëruar ta bëftë të lehtë largimin nga nefsi dhe shejtani. Që të mund të hedhësh hapa në këtë rrugë, duhet të ruhesh edhe nga e tepërta e mubahut dhe duhet të mjaftohesh me aq sa është e nevojshme. Kjo masë e mjaftueshmërisë kryen mrekullisht detyrën tonë si robër të Krijuesit. Fjala vjen, qëllimi i ngrënies është që njeriu të fitojë fuqi për të kryer ibadetet; qëllimi i veshjes është mbulimi i vendeve të turpshme dhe mbrojtja nga ndikimi i temperaturave.

Vitet e risinë janë ato vite ku fitohen veprat e mira. Burrë është ai që, pa humbur kohë, vlerëson si pasuri çdo mundësi që i ofrohet, pasi mendon se ka gjasa të mos mbërrijë në kohën e pleqërisë. Edhe sikur ta mbërrijë, nuk do të ketë mundësi dhe fuqi. Ndjaj dhe koha e mundësive është ajo kohë kur ke fuqi dhe mundësi. Të kesh shqetësim për fëmijët me frikë mbijetesën e tyre, kurrë s'mund të jetë justifikim për të vonuar ibadetin. Ndjaj dhe Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"U shkatërruan ata që thanë: 'Nesër e bëj!'"

Sa mirë për ata që i ndërthurin punët e dynjasë me punët e Ahiretit. Për ndryshe, koha që humbet nuk mund të kthehet. Koha e rinisë ka shumë shpërblime dhe pak punë, ngaqë pushtohet nga nefsi dhe shejtani. Kurse në kohën e pushtimit të vetëm nefsit, sevapi nuk është dhe aq i madh, pasi një zbrapsje në kohën e pushtimit të armikut është me mjaft vlerë për ushtarët. Por, kur ka një garanci nga e keqja e armikut, nuk përbën aspak vlerë ky veprim.

Urtësia e krijimit të njeriut nuk është ushqimi, gjumi dhe harxhimi i kotë i kohës, por është drejtimi me thjeshtësi nga Zoti, duke kryer detyrat e të qenit rob i

Tij. Qëllimi i kryerjes së secilit ibadet sipas udhëzimit të Sheriatit, është interesi dhe dobia e vetë njerëzve. Përndryshe, nuk bëhet fjalë që Allahu të ketë nevojë për to. Zoti i Madhëruar nuk ka nevojë për asgjë, ndaj Ai u ka hapur rrugët njerëzve që të lartësohen përmes urdhësave dhe ndalesave që Ai ka vendosur. Ajo çfarë na bie neve përsipër është që t'i jemi mirënjohës Zotit të Madhëruar për këtë.

Edhe ata që janë njerëz të posteve të kësaj bote, kur kërkojnë t'u bëjnë shërbim ata që janë nën kujdesin e tyre, e bëjnë atë, sado e rëndë qoftë, duke thënë: "Në këtë punë ka një dobi që i përket drejtuesit", që do të thotë se urdhrin e drejtuesit e njohin si të shenjtë dhe duan ta kryejnë me kënaqësi. Thua vallë, vendimi i Zotit të Madhëruar mos është më i dobët në syrin e tyre..?

Mosbindja ndaj urdhrave dhe ndalesave që ka vendosur Zoti i Madhëruar bëhet për dy shkaqe: ngaqë e shikon me përbuzje duke mos i kushtuar vëmendjen e duhur, sepse i vlerëson si gënjeshtër apo të pabaza të dhënat e sheriatit. Edhe një njeriu që i është vërtetuar me disa herë gënjeshtër që bën, nëse na thotë: "Armiku ka pushtuar filan popull dhe po vjen drejt nesh", duke e ditur mjaft mirë se ai është gënjeshtar, merrren masa dhe mendojmë lidhur me zgjidhjen e mundshme të atij shqetësimi. "Muhabiri sadik", që do të thotë "lajmtari i saktë", pra, Resulullahu (s.a.s.), ndërkohë që ka dhënë të dhëna lidhur me dënimet e botës tjetër, nuk ndikohemi aspak dhe nuk mendojmë se si mund të shpëtojmë prej tyre. Çfarë imani është ky kur nuk respektohet fjala e të drejtit të paktën aq sa fjala e gënjeshtarit. Në këtë mënyrë nuk mund të na shpëtojë një Islam sipas tekave tona, ndaj dhe duhet bërë myslimanë të vërtetë.

Zoti i Madhëruar në Kuranin Famëlartë thotë: **"Allahu i sheh punët e tyre të këqija."** (Bekare, 96)



EDUKIMI i një brezi fetar

Sadik Dana

Fëmijët janë një amanet në duart e prindërve. Zemra e pastër dhe e kulluar e fëmijëve, është si një xhevahir, si një tokë e pastër. Dhe çfarë të mbillet në atë tokë të pastër, ajo do të korret. Në suren et-Tahrim, Allahu Teala ka urdhëruar: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...”** (Tahrim, 6)

Mbrojtja e fëmijëve nga zjarri i xhehenemit, arrihet duke u mësuar atyre besimin, adhurimet, detyrimet fetare (farzet), hallallet, haramet dhe duke i ruajtur nga shoqëria e pafe dhe e pamoralshme. Shoku i keq është babai i të gjitha të këqijave.

Prindërit që nuk ua mësojnë dhe nuk ua bëjnë të dashur fëmijëve të tyre Allahun Teala dhe Pejgamberin (a.s.), konsiderohen si shkatërrues të kësaj bote dhe botës tjetër për fëmijët e tyre. Mosngritja e fëmijës për namaz me arsyen që të mos ftohet apo të mos e prishë gjumin, është një nga shkatërrimet më të mëdha që i bëhet të ardhmes së fëmijës. Ky veprim nuk është mirësi, por një e keqe e madhe ndaj fëmijës. Në fakt, as që mund të mendohet ndonjë e keqe më e madhe se kjo.

Nëse prindërit janë të mëshirshëm, nëse i duan fëmijët e tyre, më parë u mësojnë fenë, pastaj dituritë e tjera në lidhje me këtë botë. Nëse ata u mësojnë fëmijëve të tyre vetëm se si të fitojnë sa më shumë para në këtë botë dhe e lënë pas dore mësimin e fesë, tregojnë se ata janë njerëzit më të pamëshirshëm ndër të pamëshirshmit.

Të rritësh fëmijë pa i edukuar me dituri fetare, është njësoj sikur të kultivosh pemë për t'i djegur në sobë. Allahu Teala duhet falënderuar për çdo të mirë që na ka falur. Nëse nuk falënderohet, ajo mirësi një ditë do të na ikë nga duart. Fëmija është një nga mirësitë më të mëdha që na ka falur Allahu Teala. Nëse fëmijën tonë nuk e edukojmë me besimin dhe moralin islam, nuk e kemi kryer falënderimin tonë për këtë mirësi. Mbi të gjitha, kemi tradhtuar amanetin që na ka lënë Allahu. Prandaj, i lutemi Allahut të na ruajë nga mosmirënjohja ndaj të mirave dhe tradhtia ndaj amanetit. Amin!

Edukimi i fëmijës duhet të fillojë që prej moshës trevjeçare. Mendimet apo fjalët e kota, si; “është ende i vogël, nuk kupton, etj.”, duhen hedhur mënjanë. Bima përkulet, kthehet dhe merr formë sa është ende filiz i

njomë. Kur rritet, ngurtësohet dhe as nuk përkulet e as nuk merr formë. Pra, nëse neglizhohet në edukimin e tij pas kësaj moshe, vetëm sa ia kemi vështirësuar punën vetes. Nëse prindërit tregohen të vetëdijshëm, përpjekjet e tyre në lidhje me zhvillimin shpirtëror të fëmijës nuk kanë për të shkuar dëm.

Disa prindër janë shumë të dhënë pas fëmijëve, nuk ua prishin qejfin për asgjë, duke ua plotësuar të gjitha dëshirat me vend dhe pa vend. Një veprim i tillë e dëmton rëndë procesin e tyre të edukimit. Fëmijët që edukohen në këtë mënyrë, zhvillojnë një karakter kapriçioz dhe duan t'u plotësohet çdo dëshirë. Kur rriten, bëhen kryeneçë dhe nuk u binden prindërve.

Disa prindër të tjerë e teprojnë në disiplinë dhe nuk u japin aspak liri fëmijëve të tyre. Ata nuk tolerojnë që fëmijët e tyre të flasin qoftë edhe kur kanë nevojë për diçka. Në raste të tilla, edhe pse fëmija duket i bindur, ndonjëherë ai pëlçet dhe ngre krye duke kryer veprime që mund ta dëmtojnë edhe vetë atë. Prandaj, ashtu si për çdo gjë, edhe në edukimin e fëmijëve duhet ndjekur një rrugë mesatare.

Prindi duhet të jetë shembull për fëmijët e tij në çdo çështje. Nëse nga një anë e këshillon fëmijën për diçka dhe nga ana tjetër bën të kundërtën pranë fëmijës, këshilla e tij nuk do ketë asnjë lloj efekti pozitiv.

Kur fëmija mbush shtatë vjeç, me një metodë të ëmbël dhe të lehtë, duhet mësuar të marrë abdes dhe të falë namaz. Kur arrin moshën dhjetë vjeçare, duhet të nxitet që të falë namazin rregullisht. Gjithashtu, atij duhet t'i mësohen në mënyrën e duhur edhe hallallet dhe haramet.

Në lidhje me shkollimin e fëmijëve tanë, duhet të zgjedhim shkollat që në programin e tyre mësimor kanë edhe lëndët fetare, siç janë medresetë. Fëmijët që edukohen në këto shkolla, kanë më shumë mundësi të rriten larg veseve të këqija dhe injorancës ndaj besimit islam. Si rrjedhojë, çfarëdo universiteti që të ndjekin më vonë, do të kenë më shumë mundësi për të arritur suksese. Të udhëzuar nga besimi dhe morali islam, ata do të jenë të dobishëm për veten, prindërit e tyre dhe të gjithë shoqërinë.

Qëllimi i asketizmit

Prof. dr. Sulejman Derin

Në krye të temave që imam Rabani trajtonte herë pas here, qe tema se kjo botë është kalimtare dhe se jeta tjetër do të jetë e përhershme. Madje, ai kishte vënë re se disa muridë i tërhiqte prapë jeta e kësaj bote edhe pasi kishin bërë përpara në edukimin mistik të sejri sulukut, madje mund ta ndërprisnin sejri sulukun.

Miku im i vyer, jeta e kësaj bote është me të vërtetë shumë e shkurtër. Sa e sa njerëz e kanë bërë veten telef për shkak të kësaj jete të shkurtër. Ndërsa jeta në botën tjetër është e përhershme dhe e amëshuar. Fitimi i Ahiretit, që është i përhershëm dhe i amëshuar, varet nga vlerësimi i duhur i ditëve të caktuara në këtë jetë. Pasi të kenë kaluar ditët e kësaj jete, atëherë njeriu, ose do të gëzojë begati të përjetshme, ose do të meritojë një dënim të përhershëm në jetën tjetër. Këto të vërteta na i ka treguar Lajmëtari i Sinqertë, profeti Muhamed (a.s.). Nuk ekziston as mundësia më e vogël që të ndodhë e kundërta e atyre që na ka treguar Profeti ynë. Ne na takon vetëm të përdorim mendjen siç duhet. (Letra 210)

Jeta e botës tjetër dhe pëlqimi i Allahut janë shpërblime aq të rëndësishme, saqë njeriu, çfarëdo që të bëjë për t'i fituar ato, asnjëherë nuk do të arrijë ta përmbushë detyrën e tij siç duhet. Ashtu siç është shprehur edhe Ibn Ataullah Iskenderi: **"Burimi i çdo gjynahu, dëshire të kotë dhe indiference ndaj mësimave të fesë, është të kënaqesh me nefsin tënd dhe të jesh razi me çdo kërkesë të tijën. Baza e bindjes, mendjemprehtësisë, zgjuarsisë dhe moralit të virtytshëm është të mos jesh i kënaqur asnjëherë me nefsin tënd."**

Megjithëse gjatë gjithë jetës së tij Imam Rabani pati realizuar vepra të mira, ai i nënvlehtësonte ato që kishte bërë dhe thoshte:

Miku im i vyer, pjesa më e vlefshme e jetës na kaloi duke plotësuar dëshirat dhe epshet, si dhe duke ua bërë qejfin armiqve të Zotit. Tani jemi në periudhën më të pabegatë të jetës. Në qoftë se nuk e përdorim edhe këtë pjesë të jetës, në mënyrë që të punojmë gjëra me të cilat do ta fitojmë pëlqimin e Allahut, në qoftë se nuk e konsumojmë duke e shpenzuar në rrugën e Zotit këtë periudhë të keqe të jetës, në këmbim të periudhës së artë të asaj që na ka kaluar dhe nuk mundohemi të kompensojmë ato mundësi që na kanë ikur duarsh në të kaluarën, në qoftë se nuk mundohemi pak në këmbim të lumturisë së përjetshme dhe nuk bëjmë që ato pak vepra të mira që mund të bëjmë të shlyejnë mëkatet e

mëdha, që mund të kemi bërë, si do të dalim nesër përpara Allahut! Çfarë preteksti do të kemi për të thënë! Sa kohë të tjera do të vazhdojë gjumi i indiferencës në të cilin jemi zhytur! Kur do ta heqim nga veshët tanë pambukun e indiferencës! Nuk ka dyshim se në jetën tjetër perdet do të ngrihen dhe sytë tanë do të shohin më larg dhe pambuku i indiferencës do të na hiqet prej veshëve! Por asnjëra, as tjetra nuk do të na bëjë dobi në Ahiret, përveçse do të na bëjë të kemi mall për mundësitë që kishim në këtë jetë dhe të pendohemi që nuk i kemi shfrytëzuar ato. Përpiqu të punosh për veten tënde, para se të vijë vdekja dhe të të vendosin brenda varrit, aq sa të vijë momenti të thuash: "Ah, ku mbeti kjo vdekje që nuk vjen të më marrë!" (Letra 210)

Sipas imam Rabanit, hyrja në rrugën e tasavufit bëhet që njeriu të fillojë të bëhet gati edhe më shumë për jetën tjetër dhe ta presë vdekjen me sa më shumë punë të mira. Zbulesa (keshf) dhe kerametet nuk janë enigma mistike, që nuk i njeh kush tjetër përveç nesh. Prandaj para së gjithash, duhet që personi ta përmirësojë akiden e tij, të besojë me gjithë shpirt në ato gjëra që janë bazat e fesë dhe të mësojë dhe të praktikojë njohuritë



e fikhut. Vetëm pas këtyre gjërave mund të fillohet jeta e përsëritshme mistike.

Vetëm pas këtyre niveleve duhet të hysh në rrugën e tasavufit. Kur të hysh në tasavuf, mos ki synim të shohësh një sërë formash dhe pamjesh nga bota e panjohur (gaib) apo të zhytesh në vrojtimin e ngjyrave dhe dritave nga ajo botë. Përballë qëllimit final të tasavufit, këto gjëra mbeten lojëra dhe dëfrime kalimtare. Çfarë të mete kanë dritat dhe format e kësaj bote, që njeriu të dëshirojë të shohë në vend të tyre forma dhe drita nga bota e padukshme. Pse të jetojë jetë askete dhe të përpiqet aq shumë, vetëm për të parë forma dhe ngjyra nga ajo botë! Si format dhe dritat në këtë botë, si format dhe dritat në atë botë, janë krijuar që të gjitha nga Allahu dhe të dyja janë shenjat që ekspozojnë artin hyjnor. Drita e diellit dhe e hënës në botën që shohim, është më superiore sesa dritat e botës së shëmbëlltë. Vetëm se këto drita janë të vazhdueshme dhe mund t'i shohin në këtë botë, si shtresat e ulëta, ashtu edhe ato të larta, pra çdo njeri në këtë botë, atyre nuk u japin vlerë dhe njerëzit dëshirojnë dritat e botës që nuk shihet nga kjo jetë.

Sipas Imam Rabanit, qëllimi i vërtetë i tasavufit është:

Hyrja në rrugën e sufive ka për qëllim rritjen e imanit të sigurt, në lidhje me ato gjëra që të urdhëron sheriat. Nëpërmjet kësaj rruge kalohet nga bota e ngushtë e imanit fillestar drejt horizontit të ndriçuar të imanit vizionar. Kalohet nga imani përmbledhtazi në imanin e detajuar. Për shembull, ekzistenca e Allahut dhe fakti se është një dhe nuk ka tjetër përveç Tij, mund të kuptohet me anë të imanit imitues dhe arrihet në shkallë të caktuara të imanit të vendosur, por përfshirja në rrugën e

tasavufit bën që imani imitues të shndërrohet në iman zbulues dhe vizionar, ndërsa imani i vendosur është në nivelin perfekt.

E thënë me fjalë të tjera, sufu që përfundon edukimin mistik (sejri suluk) vjen në atë gjendje që fillon të besojë duke shijuar personalisht nëpërmjet zbulimit (keshf) të vërtetat tek të cilat besojnë të gjithë myslimanët. Ai fillon gati ta shohë me sytë e tij ekzistencën e Zotit dhe faktin se nuk ka tjetër përveç Tij. Si rezultat, efekti i këtyre përjetimeve shihet në praktikat dhe veprimtaritë e jetës së përditshme. Bindja ndaj urdhrave të fesë dhe kryerja e adhurimeve bëhen gjëra më e lehtë për t'u kryer në këtë jetë për besimtarin:

Tasavufi mes të tjerash synon të arrijë ta bëjë besimtarin t'i kryejë urdhrat e fikhut me dëshirë dhe të zhdukë vështirësitë që i nxjerr atij nefsi emare. Unë i ngrati besoj se rruga e tasavufit është në shërbim të shkencave të sheriatit dhe kurrë nuk bie në kundërshtim me to. Këtë çështje e kam trajtuar gjerësisht në veprat dhe traktatet që kam shkruar. Personalitetet e tarikateve e kanë pasur rregull të pandryshueshëm zbatimin e suneteve të Profetit dhe distancimin prej bidateve në fe. Për këto arsye, personalitetet e tarikateve e kanë konsideruar përherë begati të madhe zbatimin e sunetit të Profetit dhe si rezultat i kësaj dashurie të madhe për sunetin, Zoti u bëri të mundur të përjetonin disa gjendje të përsëritshme, që nuk i përjetojnë besimtarët e tjerë. Kur ata vinin re mangësi në zbatimin e sunetit, nuk u kushtonin rëndësi situatave shpirtërore që mund të përjetoheshin në këto kushte.

Imam Rabani citon fjalët e mistikut të madh nakshibendi, Haxhe Ahrar:

"Të gjitha situatat e përsëritshme dhe pasionet mistike që mund t'i përjetoja, unë do t'i konsideroja vetëm si barrë dhe pikëllim, në qoftë se nuk jam në rrugën dhe praktikën e ehli sunetit dhe xhematit. Për sa kohë që jam në rrugën dhe besimin ehli sunetit, nuk mërzitem aspak që nuk kam përjetuar asnjë përjetim mistik në jetën time."

Më këto fjalë, imam Rabani na tregon qëllimin e vërtetë dhe dobinë e rrugës së përsëritshme të mistikës. Ndosht, sikur se vërejmë në ditët e sotme, që tasavufi kthehet në mjet që u shërben kërkesave të nefsit apo si mënyrë për realizimin e synimeve egoiste, si të dukesh ndryshe nga të tjerët, të shtiesh në dorë enigma të përsëritshme që nuk i di kush tjetër, të përjetosh situata shpirtërore të çuditshme etj. Tasavufi i vërtetë është ai që e bën besimtarin t'i kryejë me kënaqësi detyrat dhe obligimet e caktuara në shariat, që e shndërron imanin fillestar në dëshmues, pra që na bën t'i besojmë të vërtetat hyjnore sikur të ishim duke i parë me sytë tanë që në këtë botë.





Urtësia NË HISTORITË E KURANIT FISNIK

Xhemal Nar

Historitë në Kuran tregojnë ngjarje të vërteta. Prandaj quhen "histori të vërteta". Këto histori, siç pohojnë edhe disa orientalistë, nuk janë tregime që s'kanë lidhje me të vërtetat historike apo që thuhën për të dhënë këshilla. Historitë që tregohen në Kuran, janë të vërteta historike dhe lajme në lidhje me popujt e mëparshëm. Allahu i Madhëruar ka thënë në Kuran: **"Kështu pra, Ne po të tregojmë ty (o Muhamed) disa histori të së kaluarës. Ky (Kuran) që të kemi dhënë, është një Këshillë nga ana Jonë."** (Taha, 99). **"Ne po ta tregojmë ty historinë e tyre sipas së vërtetës. Ata ishin djelmosha që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcua në rrugën e drejtë."** (Kehf, 13.)

Këto shprehje të Kuranit Fisnik janë një mrekulli e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili nuk dinte shkrim e këndim, që të lexonte librat e vjetër dhe të mësonte prej tyre. Po ashtu, janë edhe një përgjigje për politeistët që Kuranit i thoshin **"esatiru'l-evvelin / përralla të të lashtëve"**. (Kalem, 15.) Sepse Kurani Fisnik nuk përbëhet nga përrallat e të lashtëve, por ai tregon lajmet dhe historitë e tyre.

Kurani është zbritur për t'i orientuar njerëzit në rrugën e drejtë. Për këtë arsye, përdor metodën e urtësisë dhe këshillimit. Ngjarjet e përjetuara i tregon me një metodë ndikuese dhe kërkon që njerëzit të nxjerrin mësim nga ato, sepse të njëjtat ngjarje mund t'u ndodhin të gjithëve në çdo kohë.

Deklarimet, këshillat dhe urtësitë që Kurani i ka përdorur si metodë, janë të mbledhura bashkë në histori. Ndër pesë temat që përfshin Kurani (besimi, ibadeti, veprat, ndëshkimet, morali dhe historitë), ajo që është shtjelluar më gjerë është tema e moralit dhe historive. Me të vërtetë, synimi i dërgimit të profetëve është udhëzimi i njerëzve dhe edukimi i tyre me moral. Prandaj, relativisht gjysma e Kuranit Fisnik përbëhet nga historitë e peygamberëve dhe popujve të mëparshëm, në mënyrë që njerëzit të marrin mësim.

Historia ka rol të madh në edukimin e njeriut. Tregimi i ngjarjeve që u kanë ndodhur njerëzve në të kaluarën dhe i shkaqeve të tyre, e udhëzon dhe i jep mësim edhe njeriut të sotëm, sepse njeriu është i njëjtë më të tjerët në aspektin e krijimit, prirjeve dhe dobësive. Ajo që

bënte fjalë për njerëzit dhe popujt e mëparshëm, bën fjalë edhe për njerëzit e sotëm. Për shembull, fundi i dhimbshëm i femohuesve dhe tiranëve, shtrohet para syve në Kuran duke treguar padrejtësitë që u bënë shkak për mbytjen në det të Faraonit dhe ushtrisë së tij. Po ashtu, në historinë e Jusufit (a.s.), tregohen në mënyrën më të bukur gradat e mëdha që do të arrijnë dhe shpërblimet marramendëse që do të marrin për durimin ata që u kanë vënë gjoksin vështirësive dhe nuk e kanë humbur besimin e mbështetjen tek Allahu Teala.

Synimi i historive në Kuran nuk është dhënia e informacionit historik. Prandaj nuk tregohen vendet dhe koha të cilat shfaqin detaje. Qëllimi është "tregimi i disa cilësive në historitë e popujve të ndryshëm, shpjegimi i ngjarjeve që kanë ndodhur në jetën e Muhamedit (a.s.) dhe që u ngjajnë atyre që kanë ndodhur

në jetën e pejgamberëve të tjerë, vërtetimi se e drejta dhe e vërteta do të fitojnë dhe do të jenë të larta gjithmonë, ngushëllimi i Pejgamberit e i besimtarëve dhe forcimi i vendosmërisë së tyre duke ua vërtetuar me shembuj historikë shkatërrimin dhe shkrirjen e atyre që kanë kundërshtuar pejgamberët". (Mehmed Sofuogllu, Hyrje në Tefsir, fq. 97.)

Në Kuranin Fisnik tregohen historitë e Ademit, Nuhut, Hudit, Salihut, Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Lutit, Jakubit, Jusufit, Shuajbit, Musaït, Davudit, Sulejmanit, Idrisit, Lukmanit, Dhu'lkiflit, Iljasit, Uzejrit, Ejubit, Junusit, Zekerijas, Jahjas, Isait dhe Muhamedit (a.s.).

LAJMET E POPUJVE TË KALUAR

Siç shprehet edhe Kurani Fisnik, në "historitë e së kaluarës" (Taha, 99) zënë vend historitë e Dhu'lKarnejnit, As'habu'l-Kehfit, As'habu'l-Uhdudit, As'habu'l-Filit, As'habu'r-Resit, As'habu'l-Ejkes, Adit, Themudit dhe e popullit të Lutit e Nuhut. Veçanërisht shtjellohet edhe historia e Israsë, Hixhretit, Bedrit, Uhdit, Benu Nadirit, Ahzabit, Çlirimit të Mekës, Luftës së Hunejnit, Ngjarjes së Ifkut dhe historitë e hipokritëve. Në suren Jusuf, e cila tregohet si historia më e bukur / ahsen kissah, ka mësim të shumanshme. Prej tyre mund të përmendim: Shpërblimi i madh për durimin dhe rezistimin ndaj vështirësive, shpresa e pathyeshme në çdo kohë

ndaj Allahut Teala, mosbindja ndaj dëshirave të këqija të nefsit dhe shejtanit, lidhja me Allahun e Lartësuar, falja e atyre që bëjnë të këqija pa dije dhe edukimi i tyre me moral të lartë, vërtetimi se je një njeri i besueshëm duke e kryer në formën më të mirë detyrën që të është dhënë, mbajtja e amanetit dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve. Po, Kurani është për t'u kuptuar dhe për t'u jetuar. Ndërsa historia e bën më të lehtë dhe më të dashur leximin dhe kuptimin e tij.

HISTORIA SI MJET EDUKIMI

Rrëfimet historike, fetare dhe morale kanë një rëndësi të madhe në edukimin e fëmijëve dhe të rinjve. Përshkrimi me një gjuhë dinamike dhe metodë letrare i ngjarjeve të përjetuara apo që mund të përjetohen, ka një ndikim shumë të madh te lexuesit. Përfundimet

e tmerrshme të të këqijve dhe imoralëve, më mirë tregohen me metodën e rrëfimit. Në këtë mënyrë, njerëzit largohen nga të këqijat. Edhe veprat e mira dhe shembujt e moralit të lartë duhet të tregohen në këtë mënyrë influencuese, që të rinjtë të inkurajohen për sjellje dhe vepra të mira.

Për t'ua bërë njerëzve Islamin të dashur, është përfituar shumë nga rrëfimet dhe historitë. Edhe nëse nuk ka ndonjë kundërshtim me fenë në tregimin e historive morale të këtij lloji duke synuar edukimin e të tjerëve, është e ndaluar të trillosh tregime duke u dhënë natyrë fetare

për të inkurajuar apo për të ndaluar

diçka që nuk ka bazë në Kuran dhe Sunet. Në historinë e njerëzimit ka pasur shumë rrëfyes që kanë trilluar dhe transmetuar histori për përfitimet e tyre personale, duke e keqpërdorur ndikimin që ato kanë te njerëzit. Ngaqë mistika Islame merret me përsosjen e moralit (tehzibu'l-Ahlak) dhe edukimin e nefsit, përfiton shumë nga historitë kur shtjellon temat. Historitë që tregojnë mistikët, në shumicën e rasteve janë histori të Beni Israilëve dhe rrëfime e tregime që shpalosin moralin dhe sjelljet e personaliteteteve shembullore.

Le t'i gjallërojmë kuvendet tona me historitë e pejgamberëve, dijetarëve, evlijave dhe luftëtarëve tanë. Nganjëherë, ato që thuhën, harrohen, por mesazhi kryesor i një historie është i pavdekshëm. Atëherë, përse të mos përfitojmë prej historive?

Historia ka rol të madh në edukimin e njeriut. Tregimi i ngjarjeve që u kanë ndodhur njerëzve në të kaluarën dhe i shkaqeve të tyre, e udhëzon dhe i jep mësim edhe njeriut të sotëm, sepse njeriu është i njëjtë më të tjerët në aspektin e krijimit, prirjeve dhe dobësive.



KUSH PO NAJ EDUKON *fëmijet?*

Allahu (xh.sh.), thotë: ... **“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej zjarrit të xhehenemit”** (Tahrim, 6)

Mendimet e dijetarëve në lidhje me komentimin e këtij ajetit janë të shumta, por unë po citoj disa prej tyre: Aliu (r.a.), ka thënë: “Edukojeni dhe mësojeni familjen tuaj.” Ibn Abasi ka thënë: “Nënshtrojuni Allahut, distancohuni nga gjynahet dhe urdhërojeni familjen tuaj për dhikër; nëse veproni në këtë mënyrë, Allahu do t’ju shpëtojë nga zjarri i xhehenemit.” Muxhahidi ka thënë: “Kijeni frikë Allahun (xh.sh.) dhe urdhërojeni familjen tuaj të jetë e devotshme.” Dahak dhe Mukatil kanë thënë: “Myslimani duhet ta mësojë familjen dhe të afërmit e tij me atë që ka urdhëruar Allahu, që ata të largohen nga ato gjëra që Zoti (xh.sh.), i ka ndaluar.”¹

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Çdo fëmijë lind me natyrë të pastër (në fenë islame), prindërit janë ata që e bëjnë atë hebre, të krishterë ose adhurues të zjarrit...”²

Gjatë sundimit të Umerit (r.a.), babai i një djali shkoi tek Umeri dhe u ankua tek ai se i biri nuk e respektonte dhe sillej në mënyrë jodinjitoze me të. Umeri i dërgoi menjëherë fjalë djalit që të paraqitej. Kur djali erdhi, Umeri i tha se i ati ishte ankuar për sjelljet e tij. Djali i tha: “O Prijësi i besimtarëve! Si ankohet babai im, kur i ka shkelur me këmbë të gjitha të drejtat e mia? Kur linda, babai më vuri një emër jo të mirë. Ai nuk më ka mësuar asnjë pjesë nga Kurani famëlartë dhe as nga mësimet e Islamit...” Atëherë Umeri iu drejtua babait dhe i tha:

“Ti je sjellë padrejtësisht me djalin tënd, përpara se ai të sillej padrejtësisht me ty”.

Edukimi i fëmijëve, sidomos në kohën tonë dhe në vendin ku jetojmë, është një nga sfidat më të mëdha për prindërit.

Umer ibn Ebu Seleme (r.a.) thotë: “Si i ri që isha, një ditë isha ulur në prehrin e të Dërguarit (s.a.v.s.) dhe ushqehesha sa andej-këtej tek ushqimet që ishin në sofër. Profeti (a.s.), më tha: “O djalosh përmende emrin e Allahut, ha me dorën e djathtë dhe ushqehu me atë që ke para vetes”³

Surja Llukman, që ka 34 ajete, është surja e edukimit të fëmijëve dhe kjo demonstron në këshillat që Lukmani i jepte djalit të tij. Kushdo që e lexon këtë sure, do të dallojë butësinë dhe dhembshurinë e Lukmanit teksa ai këshillon dhe edukon djalin e tij. Këtë sure është mirë t’ua mësojmë fëmijëve tanë në shkolla, por t’ua mësojmë edhe prindërve, mësuesve dhe të gjithë atyre që merren me edukimin e fëmijëve.

Gjatë leximit të sures, vërejmë mënyrën si i drejtohet Lukmani djalit të tij. Fjalët me të cilat i drejtohet Lukmani djalit janë: “O biri im”.

“(Kujtoje) kur Lukmani i tha të birit, duke e këshilluar: “O biri im, mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe”.⁴

Fillimisht, ai e këshillon djalin që të mos adhurojë askënd tjetër përveç Zotit, të respektojë prindërit, të

1. Tefsiri i Ibn Kethirit.

2. Buhariu.

3. Buhariu, Muslimi.

4. Lukman, 13.



jetë i sjellshëm dhe i moralshëm, i flet mbi realitetin e kësaj bote, i flet mbi etikën, të mos bëjë asnjë hap pa pasur një qëllim dhe objektiv, të planifikojë dhe të jetë i suksesshëm në jetë.

Ne kemi nevojë t'i edukojmë fëmijët tanë ashtu siç e edukonte Lukmani djalin e tij. Ne duhet të ulemi me fëmijët tanë dhe t'i këshillojmë, t'u tregojmë mbi përvojën dhe gabimet tona në jetë, t'u flasim me dashuri dhe dhembshuri dhe në fund t'i këshillojmë. Në çdo hap, ne duhet të jemi të butë dhe të dashur me fëmijët tanë. Edukimi i fëmijës duhet të bëhet me kujdesin më të madh.

Lukmani ka thënë: "Kam takuar shumë profetë dhe prej tyre kam mësuar katër gjëra:

- 1- Kur të jesh në namaz, ruaje zemrën, se ajo është gjëja më e rëndësishme në namaz.
- 2- Kur të jesh mes njerëzish, ruaje gjuhën.
- 3- Kur të jesh në shtëpinë e tjetrit, ruaj shikimin dhe mos hidh sytë majtas-djathtas.
- 4- Kur të jesh duke ngrënë, ruaje stomakun tënd dhe mos e tepro.

Lukmani ka thënë gjithashtu: "Mos i përmend kurrë dy gjëra: Mos i përmend të këqijat që ju kanë bërë të tjerët dhe mos i përmend të mirat, që ti ua ke bërë njerëzve të tjerë".

Imam Gazaliu thotë: "Fëmija është amanet tek prindërit e tij, zemra e tij është perlë e pastër, ku asgjë nuk është e gdhendur, por është e gatshme për të pranuar çdo gjë që gdhendet në të. Pra, nëse mëson të mirën dhe adaptohet me të, ai do të rritet në të mirën dhe prindërit e tij do të jenë të lumtur me të në këtë botë

dhe në botën tjetër. Në qoftë se ai anashkalohet – ose lihet pas dore dhe mësohet me të keqen, do të jetë për të ardhur keq dhe do të shkatërrohet, e përgjegjësinë për këtë do ta mbajnë kujdestarët, prindërit apo kushdo qoftë tjetër."⁵

Profeti (a.s) ka thënë: Edukimi i fëmijës është më i vlefshëm sesa dhënia e sadakasë."⁶

Çdo minutë, orë dhe çast që prindi shpenzon për edukimin e fëmijës së tij, konsiderohet sadaka, madje edhe më e vlefshme dhe më e dobishme. Në një hadith tjetër, Profeti (a.s.), ka thënë: "Nuk ka gjë më të mirë që prindi mund t'i japë fëmijës, sesa një edukatë e mirë"⁷

Një ditë, Ibn Xhevzi ishte ulur dhe pranë tij kaloi një qen gare. Gjatë rrugës, qeni kaloi pranë disa qenve rrugaçë, të cilët me ta vënë re filluan t' i lehin. Qeni i garës, u hodhi një vështrim të shpejtë qenve rrugaçë dhe pa ua kthyer të lehurën, vazhdoi rrugën. Kjo sjellje, i bëri përshtypje Ibn Xhevziut dhe menjëherë shkroi diçka rreth rëndësisë së edukimit. Edhe pse ishte një qen, ai i garës nuk ua ktheu me të njëjtën monedhë qenve të rrugës. Sa rëndësi të madhe ka edukata edhe tek qeni.⁸

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Edukimi i mirë është trashëgimia më me vlerë të cilën mund t'ia lë pas prindi fëmijës së tij"⁹

E lusim Zotin (xh.sh.), që të na ndihmojë në misionin e edukimit të fëmijëve tanë.

5. Ihjau ulumid-din.

6. Tirmidhiu.

7. Tirmidhiu.

8. Në librin "Sajdul Hatir".


9. Tirmidhiu.

ZBULIM SHPRESËDHËNËS NGA SHKENCËTARËT TURQ

Në Universitetin e Ushakut duke përdorur perlitin, i cili është një gur me prejardhje vullkanike, është prodhuar një lloj stofi që filtron 98% të rrezatimeve të dëmshme diellore që shkaktojnë sëmundjen e kancerit. Ndihmës Doçentja, Doktoreshë Bahar Tiber, pedagoge në Degën e Inxhinierisë së Tekstilit pranë Fakultetit të Inxhinierisë, tha se duke përdorë perlitin, pra duke e kthyer gurin vullkanik në pluhur e kanë zbatuar atë në copën e pambukut. Tiber bën të ditur se ky është aplikimi i parë i tillë në botë ndërsa shton se pas studimeve në shtresën e ozonit janë vënë re se janë rritur problemet e lëkurës tek njerëzit. Pedagogia nënvizon se falë kësaj pëlhure njerëzit do të ndikohen në mënyrën më të ulët nga rrezet Ultra Violet. Ky lloj stofi do të përdoret në shumë fusha, duke filluar që nga çadrat, tendat e diellit e deri tek prodhimi i çadrave të zakonshme, po ashtu edhe në prodhimin e perdeve dhe rrobave.



ZEMRA NUK ËSHTË THJESHT NJË POMPË GJAKU



Ata theksojnë se çdonjëra nga qelizat e zemrës përbën një kuti informacioni për ngjarjet që përjeton njeriu, prandaj kanë filluar të flasin për kujtesën e zemrës si dhe rolin e madh që luan zemra në procesin e të kuptuarit dhe perceptimit të gjërave që na rrethojnë. Në zemër ka më shumë se 40000 qeliza nervore, të cilat punojnë me një saktësi të lartë për rregullimin e rrahjeve të zemrës, sekretimin e hormoneve dhe ruajtjen e informacionit, e më pas dërgimin e tij në tru. Informacioni shkon nga zemra deri në bulbin e trurit, pastaj penetron në tru dhe bën orientimin e qelizave të trurit, që të mund të kuptojnë dhe të përvetësojnë. Studiuesit zbuluan se procesi i të kuptuarit përshtatej me punën e zemrës. Sa herë që kjo punë ishe e dobët, edhe perceptimi ishte i dobët. Pra, ajo që ne e quajmë "mendje", gjendet në qendër të zemrës dhe është ajo që e orienton trurin për të kryer detyrat e tij. Në ajetin e mëposhtëm kuranor Allahu i lartësuar e ka përcaktuar më së miri këtë: Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër tokë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë?... (Haxh, 46)

PRO DHE KUNDËR ILAÇEVE ALTERNATIVE

Ilaçet në masë të madhe kanë përmirësuar jetëgjatësinë e njeriut mesatar gjatë viteve. Shkencëtarët nga e gjithë bota kanë zhvilluar mënyra të ndryshme për të trajtuar sëmundje të ndryshme. Sot lehtë mund të thuhet se ekzistojnë dy lloj mjekësish: mjekësia alternative dhe konvencionale. Një ndryshim i madh mund të vërehet në mentalitetin e masave teksa provojnë gjithnjë e më shumë terapi alternative. Sidoqoftë, efekti i mjekësisë komplementare është shumë i debatuar nga masa. Si shumë të tjerë, edhe ju duhet të pyeteni se a ia vlen të gjykohet një terapi e mjekësisë alternative e të lavdërohet ajo konvencionale. Ja disa pro dhe kundër terapive të mjekësisë alternative.

Mjekësia alternative: Pro Qasje holistike: Shumica e ilaçeve alternative marrin në konsideratë të gjitha simptomat si një dhe të vetme të shkaktarit, në vend të simptomave të sëmundjes. Ata përqendrohen në masat: trajtimi rrënjësor i gjendjes, jo i simptomave. Duke bërë kështu i tërë trupi është në shënjestër. Shumica e ilaçeve alternative përqendrohen në përkujdesje për gjithë trupin më parë se sa në pjesë të tij. Praktikuesit e mjekësisë alternative i drejtohen jo vetëm trupit fizik, por po ashtu shëndetit shpirtëror dhe emocional të pacientit. Vëmendje secilit: Derisa ilaçet tradicionale janë të prodhuara masivisht për konsumim global, terapitë alternative janë të personalizuar t'u përgjigjen kërkesave të pacientit. Terapitë alternative nuk mund të prodhohen pasivisht, sepse parim i tyre është të përqendrohen në trupin e pacientit, i cili është unik për secilin. Stres të zvogëluar: Stresi është një faktor thelbësor në dobësimin e imunitetit tuaj. Ilaçet modern nuk e llogarisin stresin gjatë shërimit të një sëmundjeje. Stresin e llogarit si një pjesë dhe ndarje të jetës moderne dhe e injoron tërësisht. Terapitë alternative si joga dhe meditimi, e identifikojnë stresin si një nga faktorët më të mëdhenj dhe përpiqen ta zvogëlojnë atë për të luftuar sëmundjet si shtypja e lartë e gjakut ose hipertensioni. Më e lirë: Shumica e terapive alternative janë më të lira se ato konvencionale. Shumë terapi përdorin bimët për të trajtuar sëmundjet. Pasi bimët nuk kanë nevojë të përpunohen ose të hulumtohen për t'i zhvilluar, ato kushtojnë shumë më lirë dhe

janë më të volitshme. Më pak dëme: Antibiotikët nuk mund të bëjnë dallim mes viruseve dhe baktereve që shkaktojnë dëme dhe asaj çka është e dobishme për trupin tuaj. Si pasojë, ato zhdukin florën dhe faunën "miqësore" bashkë me bakterin ose virusin, e kështu i shkaktojnë trupit dëm në një afat më të gjatë. Ilaçet alternative: Kundër Kohë e gjatë për shërim: Meqë shumica e terapive alternative veprojnë në çrrënjosjen e sëmundjes, ato nuk ofrojnë një shërim të shpejtë. Kështu që nëse jeni duke kërkuar një zgjidhje të përkohshme, mjekësi konvencionale është larg më e mirë. Kërkon dedikim nga përdoruesi: ilaçet konvencionale kryesisht janë tableta të cilat vetëm duhet futur në gojë. Ndërsa ilaçet alternative kërkojnë shumë ndryshime në stilin e jetës, në mënyrë që terapia të funksionojë. Ato kërkojnë përkushtim serioz dhe disiplinë nga ana e përdoruesit për të pasur efekt në të. Hulumtime të kufizuara: Për shkak të vëmendjes, shumë ilaçe alternative tash janë testuar në mënyrë shkencore dhe janë dëshmuar si efektive. Megjithatë, një pjesë e madhe e këtyre ilaçeve nuk janë testuar shkencërisht dhe nuk janë aprovuar nga ndonjë qeveri ose trup qeverisës. Për të përmbledhur, ka disa arsye si pro ashtu edhe kundër terapive alternative. Bëjeni hulumtimin tuaj të nevojshëm para se të vendosni për ndonjë në veçanti dhe përpiquni të jeni të vëmendshëm për të dy metodat para se vendosni.





DOBITË E KOSIT

Nuk është eliksir i jetëgjatësisë, por kërkime të ndryshme kanë treguar se kosi është një aleat shumë i mirë për shëndetin tonë. Në një studim të publikuar në "Neë England Journal of Medicine", kosi renditet mes ushqimeve që mund të frenojnë shtimin në peshë të lidhur me moshën.

Disa kërkues të "Harvard School of Public Health" në Boston, pasi ekzaminuan të dhënat relative të më shumë se 120 mijë personave, treguan se rritja në peshë mesatarisht 1.5 kg çdo katër vjet, rezulton të ishte inferiore kur rritej konsumi i disa ushqimeve të veçanta, e sidomos kosit. Për një sasi të caktuar të ngrënë çdo ditë në mënyrë të rregullt, rritja në peshë reduktohej me rreth 370 gramë çdo 4 vjet. E njëjta gjë ndodhte edhe për frutat e thata, për ato të freskëtat, për drithërat dhe perimet. Ndodhte krejtësisht e kundërta me patatet e skuqura (shtohet 760 gramë çdo 4 vjet), pijet e ëmbla apo llojet e ndryshme të mishit. Me pak fjalë, ndryshime të vogla në stilin e jetës, të lidhura mbi të gjitha me ushqimin, mund të ndikojnë në mënyrë thelbësore në rritjen në peshë për periudha afatgjata dhe ka shumë mundësi që për ta frenuar këtë tendencë duhet të përqendrohemi tek ushqimet e shëndetshme dhe të lëmë mënjanë ato që na dëmtojnë. Në një tjetër studim të publikuar nga "International Journal of Cancer" dhe të bërë tek 45 mijë persona të ndjekur për rreth 12 vjet me radhë, u pa se kush kishte konsumuar më shumë kos (85 gramë në ditë për burrat, 98 për gratë) kishte një rrezik për t'u prekur nga tumori në zorrën e trashë rreth 38 për qind më të ulët se ata që nuk konsumonin. Por lind pyetja, se përse kosi paska këtë efekt pozitiv mbi shëndetin? "Një ushqyerje korrekte dhe një stil jetese aktiv kanë një rëndësi të jashtëzakonshme në shfaqjen e tumorit në zorrën e trashë", - tregon Salvatore Panico, profesor i mjekësisë së brendshme në Universitetin "Federico II" të Napolit dhe një prej autorëve të studimit. Sipas tij, zakonet e këqija ushqimore dhe mungesa e lëvizjes janë shkaku i 70 për qind të tumoreve të këtij lloji. Pra, është e rëndësishme të dish se cilat ushqime janë më

të preferuara se të tjerët. "Bakteret që prodhojnë acid laktik, si ato që gjenden tek kosi, janë krejtësisht në gjendje të parandalojnë disa mutacione gjenetike të qelizave të zorrës së trashë. Po shpjegojmë më mirë: acidi laktik, duke ndryshuar pH e zorrëve, i bën më pak ofensive substancat që favorizojnë mutacionet, mutacione që mund t'i japin jetë qelizave kancerogjene. Për më tepër, acidi laktik redukton inflamacionin e zorrës, që gjithashtu luan rol në formimin e kancerit", - vazhdon Panico. "Gjithsesi, është mirë të kujtosh se sistemi i ushqyerjes është kompleks, ndaj duhet mbajtur gjithmonë parasysh ajo që kërkimet amerikane kanë evidentuar. Gjithashtu, duhet të evitojmë konsumin e pijeve dhe ushqimeve shumë të pasura me sheqer dhe densitet të madhe energjetik, edhe pse mund të kenë si bazë kosin. Gjithashtu, duhet t'i japim hapësira edhe produkteve me origjinë vegjetale, përfshi edhe drithërat dhe ushqimet e thjeshta, si kosi natyral". Në të vërtetë, është e pamundur të gjesh një tjetër ushqim kaq të pasur me kalcium, fosfor e vitamina dhe kaq të domosdoshëm për shëndetin. Përveçse mik i mirë i shëndetit, kosi është një ndër produktet që këshillohet për pastrimin e trupit, lëkurës, madje edhe flokut. Pavarësisht se sot mund të gjenden me qindra lloje e shije të tij, më i miri mbetet ai i përgatitur vetë në shtëpi, me qumësht të freskët. Kosi është cilësuar si simbol i ushqyerjes së shëndetshme në shkrimet e shenjta indiane të rreth 8 mijë viteve më parë. Madje, pija tradicionale indiane, "Lassi", përgatitet me kos, pak ujë, akull, erëza dhe fruta sipas dëshirës. Vitaminat e grupit B që ai përmban mbrojnë mëllçinë dhe zorrët; acidi laktik favorizon absorbimin e kalciumit dhe fosforit; laktobacilet favorizojnë punën e tëmthit, rrisin prodhimin e acidit folik dhe përmirësojnë mikroflorën e zorrëve. Fjala "jogurt" (kos), ashtu siç njihet në shumë gjuhë të botës, vjen nga turqishtja dhe përdoret për qumështin e fermentuar. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas ligjit, kosi duhet të ketë të paktën dy lloje bakteresh; laktobacil bulgarikus dhe streptokokus termofilus, për të fermentuar qumështin.